

PËRMBAJTJA



4 Nëntori i krenarisë kombëtare



10 Intervistë me Behar Selimin



13 Pse kosovarët e varfër bëjnë...



24 Profesori, pagat u rritën!...



28 Presheva ndër vite

Portreti i muajit: Njeriu i Kosovës.....	2
Editoriali: Kosova, model i Ballkanit.....	3
Mr. Milazim Mustafa: Nëntori i krenarisë kombëtare.....	4
Fillor Mersimi: Përvjetori i alfabetit.....	5-6
Avni Xhemajli: Ora e ndalur e njohjeve për Kosovën. 7-8	
Avni Avdiu: Ndërkombëtarët interesohen për problemet në USHT.....	9
Intervistë me Behar Selimin.....	10-12
Mevlude Zejnullahu: Pse kosovarët e varfër bëjnë shumë fëmijë?.....	13
Fatos Shala: Cilat janë gjasat për zbutjen e papunësisë?	14
Nexhmedin Shala: Vetëvrasja – ndër patologjitë më të rënda të shoqërisë.....	15-16
Shenasi Xheladini: Rënia e murit të paragjykimeve.17-18	
Prof. dr. Naser Ramadani: Simbolika e haxhit..	19-20
Senad Ramadani: Thirrje publike për dëshpërim .	20-21
Iljasa Salihu: Venitja e nocionit SHKOLLË!..	22-23
Dukagjin Avdyli: Profesorë, pagat u rritën! Hajdeni!!!.....	24
Dr. Hatixhe Ahmedi: Presheva ndër vite.....	25-26
Mirsad Kuteli: Ndërtimi i harmonisë familjare..	27-28
Blerina Rogova – Gaxha: Përse historia nuk ka njohur femra të mëdha shkrimtare?	28-29
Flamur Maloku: Variantet personale.....	30
Astrit Veliqi: 'Kultura' dhe fushata zgjedhore në Kosovë.....	31
Poezi	32
Aforizma.....	33
Agim Avdiu: Çudia e zbulimeve të reja.....	34-35
Artan N. Bejta: "Gripi Sezonal" po troket në dyertona! Si të mbrohemi nga ai?	36-37
Alban Bilalli: Takim historik.....	38-39
Fjalëkryqi	40



REVISTË MUJORE PËR AKTUALITET,
KULTURË, ARSIM, ETIKË
Viti IV / Nr. 36
19 nëntor - 19 dhjetor 2009
Botues
Zëri Ynë
O.J.Q. "Zëri Ynë"

Drejtor
Muhamed Jusufi - KAJOLLI
kajolli5@hotmail.com
Redaktor përgjegjës
Avni AVDIU
avni.avdiu@gmail.com

Redaktor i kulturës
Flamur MALOKU
flamurmalku@hotmail.com

Redaktor teknik/Grafika
Osman D. GASHI
osmangashi@msn.com

Redaktore gjuhësore
Mimoza SINANI

e-mail:
revistapaqja@gmail.com
revistapaqja@hotmail.com
http://www.zeri-yne.org

Adresa:
Rr. Xhavit Mitrovica, nr. 14,
përballë teatrit Dodona,
Prishtinë, Kosovë

Njoftojmë bashkëpunëtorët se do të merren në konsiderim për botim vetëm ato shkrime që arrijnë në redaksi deri me datën 8 të muajit!

Portreti i muajit

Në fillim të këtij muaji, qytetarët e Kosovës i bënë një pritje madhështore ish-presidentit të 42-të amerikan, Bill Klintonit, me rastin e zbulimit të shtatores së tij të shumëpërfolur. I entuziazmuar nga pritja, Klintoni u shpreh: "Kurrë nuk kam pritur se dikush do të më nderojë diku kaq shumë". Ai u përcolli qytetarëve mesazhe paqeje si dhe përsëhëndetjet e bashkëshortes së tij Hilari Klinton në mbështetje për popullin e Kosovës. Më 19 shtator 2003 Bill Klinton u nderua nga Universiteti i Prishtinës me titullin "Doktor Honoris Causa". Atëherë Klinton pat deklaruar: "Besoj në vetëvendosje dhe dëshiroj që ju të ardhëni ta nderoni mërinë tuaj".



Presidentit Klinton është ndër më meritoret

Njeriu i Kosovës

për vendosmërinë e treguar për t'i dëbuar forcat vrastare të Millosheviçit nga Kosova. Pas 78 ditë të fushatës ajrore, forcat serbe të sigurimit u larguan nga Kosova dhe afro 1 milionë

refugjatë shqiptarë, të dëbuar, u kthyen në shtëpitë e tyre. Ai vizitoi Kosovën pak muaj pas hyrjes së forcave të NATO-s dhe i porositi kosovarët që, siç pat thënë, "të falin, por të mos harrojnë". ■



Bill Klintoni u lind më 19 gusht, 1946 në Hope, Arkansas, si William Jefferson Blythe III. Babai i tij vdiq në një aksident me veturë, tre muaj



para lindjes së të birit. Nëna e la të birin me prindërit e saj, gjersa vetë punonte si infermiere. Kështu kur Billi mbushi tetë vjet, nëna e tij, Virxhinia Kelli u martua me Roxher Klintonin. Klinton u regjistrua në Universitetin Xhorxhtaun më 1964 dhe u diplomua në vitin 1968. Fitoi bursën Rodos në Universitetin e Oksfordit. Në vitin 1973 mori një diplomë për drejtësi në Universitetin Yale dhe menjëherë pas kësaj hyri në politikë në Arkansas. Si student kolegji, ai u angazhua në lëvizjen kundër Luftës së Vietnamit (1955-75) Klintoni u motivua për karrierë politike pas vizitës që i bëri Shtëpisë së Bardhë në kohën e presidentit Xhon Kenedi (1917-1963), kur ishte shtatëmbëdhjetë vjet. Ndërkohë ai u shqua si student i shkëlqyer në Universitetin e Oksfordit. Më 1974 u bë profesor i drejtësisë. Më 1978 u bë guvernatori më i ri i Arkansasit.

Ishte president i Shteteve të Bashkuara për dy mandate, 1993-2001. Si një demokrat i moderuar, në vitin 1992 mundi presidentin në detyrë Xhorxh Bushin. Ai u rizgjodh për mandatin e dytë më 1996.

Nën udhëheqjen e tij, Shtetet e Bashkuara gëzuan ekonominë më të fortë dhe zgjerimin më të gjerë ekonomik në historinë e SHBA-së (uljen e madhe të papunësisë dhe krijimin e 22 milionë të vendeve të punës, më shumë se cilado administratë e mëparshme). Klinton vazhdon të punojë për një sërë çështjesh që u bënë të rëndësishme për karrierën e tij politike.



Kosova, model i Ballkanit

Lgjedhjet lokale përfunduan. Ndonëse do të ketë balotazhe, prapëseprapë fituesit kryesisht dihen. Mirëpo e rëndësishme në këto zgjedhje është se fituese është e gjithë Kosova. Kur procesi zgjedhor përmbillet mirë, të gjithë duhet të ndihen fitues. Kjo dëshmoi se, gradualisht, koha e fërkimeve, e përplasjeve dhe e tensionimeve të panevojshme, po merr fund. Intuita politike e zgjedhëse në Kosovë po zhvillohet në raport me rrethanat e reja, në shtetin e pavarur, në ëndërrën e shumëpritur të tyre.

Procesi zgjedhor, edhe nga ndërkombëtarët, u vlerësua me notë pozitive, si normal, i rregullt dhe i organizuar mirë. Qytetarët me verdiktin e tyre të dhënë në zgjedhjet e së dielës dhanë provimin kryesor përballë demokracive perëndimore. Kosova mbetet model i disiplinës politike. Zaten ky është edhe thelbi i asaj për të cilën kanë nevojë të gjithë qytetarët, nevojë të brendshme për stabilitet të qëndrueshëm politik dhe nevojë të jashtme për t'u dëshmuar pjekuria politike përpara faktorit ndërkombëtar. Të dy këta komponentë janë sinjal i mirë që i përcillet BE se megjithatë Kosova meriton të jetë në familjen e madhe evropiane. Në veçanti, kjo rëndësi fiton peshë edhe më të madhe tashmë kur jepen sinjalet e para të liberalizimit të vizave për disa shtete.

Nga shumë analistë këto zgjedhje u konsideruan si test për zgjedhjet e ardhshme, edhe pse ato do të zhvillohen pas dy vjetësh. Mu për këtë, si në billborde, ashtu edhe në media u vërejt edhe një reklamim i liderëve partiakë.

Sado të ndryshme të jenë partitë në strukturat, organizimin dhe programet e tyre ato një gjë kishin të përbashkët: 'premtimet fantastike'. Secila parti ka përmendur shifra enorme në investime, punësime dhe ndërtime. 'Do ta bëjmë këtë e atë', u tha përplot një muaj nga kandidatët e ndryshëm, pa qenë edhe aq konkret nga, si dhe deri kur. Mirëfilli dihet se deri më tani kapacitetet e komunave nuk mund të përballojnë as dhjetë për qindëshin e realizimit të atyre premtimeve, prandaj arsyeshëm shtrohej pyetja se me çfarë guximi

kandidatët premtinin aq shumë. Thjesht ata ofronin lloj-lloj fontanë dëshirash që shkriheshin në zhurmën euforike të zërave dhe duartrokitjeve të masës simpatizuese. Janë edhe disa paradokse ekonomike që nuk përputhen me asnjë mundësi reale. Nga një anë u tha se do të hiqen taksat komunale, kurse nga ana tjetër se do të shtohen investimet, punësimet, të ardhurat, pa detajuar se me çfarë shkopi magjik mund të bëhet kjo. Mu për këtë mijëra vende pune të premtuara, pastaj miliona investime dhe ngritje e tillë infrastrukture çfarë u premtua, duken të pakapshme në këtë kohë krize e kufizimesh buxhetore.

Në këtë kontekst duhet parë edhe bumi i hatashëm mediatic i marketingut politik. Buxheti i ndarë nga kuvendi nuk është i mjaftueshëm për të përballuar diçka të tillë, çka hedh dyshime për lidhjen latente të bizneseve me politikën, gjë që mund t'i problematizojë lehtë proceset e mëvonshme në raport me kushtëzimet e detyrueshme të politikanëve ndaj biznesmenëve. Afërmendsh biznesmenët e dinë se investimi i tanishëm i tyre nëpërmjet klientelizmit politik mund t'u japë atyre siguri dhe imunitet për veprimtari të paligjshme, si kontrabandë ose evazion fiskal, pastaj për sigurimin e licencave, tenderëve etj. Përveç kësaj, e keqja e kësaj qëndron edhe në faktin se ekspozimi enorm i kandidatëve, është një reklamim pa shije që në disa raste shkakton edhe aversion te qytetarët. Pra mendohet diçka (e dëshiruara), e arrihet krejt diçka tjetër (e kundërta).

Vlen të përmendet edhe rënia e numrit të votuesve, që përkundër faktit se u tregua rëndësia e këtyre zgjedhjeve që ishin të parat në Republikën e Kosovës,

prapëseprapë nuk sensibilizoi një pjesë bukur të madhe të elektoratit. Kjo, në njëfarë mënyre, dëshmon se një pjesë e popullatës është e lodhur nga premtimet boshe, tashmë të dëshmuara nga zgjedhjet e kaluara, se koha e sensibilizimit për ideale e kauza të mëdha nuk është më në modë, se qytetarëve më shumë u interesojnë problemet jetike e konkrete. Prandaj politikanët duhet të punojnë më shumë, me qëllim që kjo pjesë e indinjuar e popullatës, pakënaqësinë e vet, të cilën tani e shpreh përmes mosvotimit, mos ta manifestojnë në të ardhmen me ndonjë revoltë eventuale sociale.

Ajo që ka mundur të bie në sy menjëherë pas mbylljes së vendotimeve, është edhe shpejtimi i shtabeve zgjedhore për të komunikuar rezultatet. Secila parti në mënyrën e vet shpallte fitore, pa çarë kokën se mund të demantohen hiç më shumë e më pak se dy orë më vonë. Shikuar moralisht kjo mund të konsiderohet si veprim i papërgjegjshëm, sepse qytetarët gënjen në mënyrë shumë të hapur, madje me një rrenë që nuk i hy në punë askujt, e as vetë partisë. Në njëfarë mënyre, zgjedhjet po përcillen sikurse ngjarjet sportive me eufori tifozërie. Harrohet se prej momentit të fitores së një kandidati, ai kandidat duhet të ndihet si i përzgjedhuri i gjithë qytetarëve, e jo vetëm i një subjekti të caktuar politik. Pra, me gjasë, duhet akoma kohë për t'u formuar pjekuria e racionalizimit të fitoreve zgjedhore.

Këto zgjedhje, megjithatë, shënuan pak mangësi e lëshime që janë të tolerueshme, por që duhet të shërbejnë si sinjal për t'u bërë më shumë në korigjimin e menaxhimit të zgjedhjeve të ardhshme në mënyrë që zgjedhjet parlamentare të jenë edhe më të mira. Mirëpo mbarëvajtja e këtyre zgjedhjeve ka qenë e kënaqshme, sa për të dëshmuar se Kosova është në rrugë të mbarë drejt integriteteve euroatlantike. Pra në këtë, edhe duhet të reflektojnë komuniteti ndërkombëtar, në momentet kur po bën liberalizimin e vizave për disa shtete ballkanike. Zgjedhjet ishin provë se Kosova ka qenë dashur ta meritojë këtë lehtësi ndërkombëtare më shumë sesa disa shtete të tjera tashmë veç të përmendura. ■



Nëntori i krenarisë kombëtare



Mr. Milazim MUSTAFA

Jemi ndër popujt më të vjetër në Ballkan. Lashtësia, krenaria, por edhe vuajtjet e shumta, na kanë lënë një histori të ngjeshur dhe shumë të pasur, edhe pse ndoshta një histori herë pas here e mjegulluar, por në të shumtën e rasteve e qartë dhe shumë e vlefshme.

Kemi pasur fatkeqësinë që në të shkruarin e historisë sonë, në të shumtën e rasteve, të fusin dorë të tjerët, si rezultat i parimit se gjithmonë më i forti e ka shkruar historinë. Ne kemi pasur caktim që gjithmonë të jemi të pushtuar, por kurrë të robëruar. Secili pushtues që kemi pasur mbi kokë na ka bërë më të fortë e asnjëri nuk ka arritur të na thyejë. Pushtues pas pushtuesi, ndoshta kemi dalë më të dëmtuar, por është e sigurt se kemi dalë më të fortë.

Si shqiptarë denbabaden në këto troje, nuk e mohojmë as edhe një çast të vetëm të së kaluarës sonë. Çdo çast i kaluar ka qenë, është dhe do të mbetet mësim për neve sot e për mot. Çdo germë të saj e marrim si mësim dhe urtësi pa marrë parasysh që e ëmbël apo e hidhur. Çdo çast të saj duam ta dimë ashtu siç ka qenë edhe po të që e hidhur, gjithmonë me tendencë për njohjen e heroit si hero, të trimit si trim, të luftës si luftë, të tradhtisë si tradhti dhe të tradhtarit si tradhtar.

Koha në të cilën jetojmë na ka dhënë një rast të volitshëm. Na ka mundësuar që fatin tonë ta përcaktojmë vetë ne.

Datat më të rëndësishme të historisë sonë ndodhen po në muajin nëntor; muaj ky që ngërthen dhe përfshin në vete shumë data të rëndësishme, data që na bëjnë të krenohemi dhe na paraqesin një dritë në tunelin e historisë sonë kombëtare, duke filluar në atë më madhoren,

pavarësinë e Shqipërisë. Është ky një akt që vendosi themelet e shtetit shqiptar, që për afër një shekull, të gjithë neve, pa marrë parasysh se ku jetojmë, na bëri ta ndjejmë ngrohtësinë e atdheut, dashurinë ndaj flamurit, emocioneve të himnit dhe krenarinë e të pasurit shtet. Deshi Zoti na u bë edhe Republika e Kosovës, shteti i dytë shqiptar në botë; shtet ky që kurorëzoi ëndrrat dhe shpresat e gjithë shqiptarëve anekënd botës; akt ky që qetësoi shpirtat e gjitha dëshmorëve që derdhën gjakun e tyre të shenjtë për liri të atdheut. Akt ky që lotin e dhimbjes në syrin e lokeve e shndërroi në lot gëzimi dhe fitoreje, dhimbjen e tyre për djemtë e tyre e shndërroi në lule dhe dritë, ardhmërinë e shndërroi në shpresë për nipat dhe mbesat e tyre, ëndrrën e shndërroi në realitet. Nëntori na përkujton gjakun e gjithë dëshmorëve të rënë për tokën e shtrenjtë të Kosovës. Nëntori na përkujton lindjen, rritjen dhe jetësimin e ëndrrave dhe realiteteve tona ndër shekuj. Nëntori na përkujton edhe ditëlindjen e komandantit legjendar Adem Jasharit, simbolit të qëndresës, sakrificës, guximit, personalitet që dha shembullin më të mirë se si duhet të mbrohet pragu i shtëpisë, si duhet të vdiset për lirinë e atdheut dhe si duhet të vendosen prioritetet në jetën e një njeriu.

Derisa moshë ime nuk më ka mundësuar ta jetësoj veprën madhore të komandantit legjendar, pishtarit të lirisë së Kosovës, kurbanit të pavarësisë së vatanit, vepra e tij madhështore ma mundëson ta jetësoj ëndrrën e tij për një Kosovë të lirë, për një Kosovë të pavarur, për një Kosovë që frymon lirshëm, për një Kosovë pjesë e ombrellës që bashkon gjithë bijtë e saj të gjuhës e gjakut në një vend.

Le të jetë ky shkrim një përkujtim për lindjen e tij në këtë "muaj të kuq". Le të jetë ky shkrim një përshëndetje për gjakun e tij prej dëshmori, le të jetë ky shkrim një akt nderimi për prindërit e tij bujarë që sollën në jetë djalin e tyre mu në ditën

e flamurit, që e rritën dhe e edukuan, e bashkë me të u bënë dëshmorë të lirisë së atdheut. Le të jetë ky shkrim një nderim për të gjithë dëshmorët e kësaj familje legjendare dhe të gjithë familjet shqiptare që lindën burra, rritën trima dhe falën dëshmorë. Le të jetë një lëvdatë për ata djepa të praruar, që mbjellin dashuri ndaj atdheut, që përkundën vullnetin për liri, që shkulën ndjenjën e robërisë dhe ngulitën gatishmërinë e sakrificës dhe flijimit.

Le të jetë edhe një përkujtim për të gjithë ata që ranë për liri dhe një të ardhme më të mirë. Le të jetë ky një përkujtim për gjakun e tyre të pastër që solli këtë ditë që na bëri ta dimë se kush jemi, ku jemi duke jetuar e ku do të jemi nesër. Falë Zotit, burrat e tillë, më të shtrenjtën e tyre ia dhanë nderit të atdheut dhe të ardhmes më të mirë për vëllezërit e tyre të gjakut e idealit.

Le të jetë ky një përkujtim për të gjithë ne. Të ndalemi së paku një çast të vetëm e t'i përkujtojmë shpirtat që sollën lirinë, ata shpirta që nuk janë më në mesin tonë derisa ne kënaqemi me lirinë, kënaqemi me të mirat e kësaj bote duke i shijuar frytet e lirisë.

Për udhëheqësit tanë, le të jetë ky shkrim një nxitje për përkujtim sa më të shpeshtë për bashkëmendimtarin dhe bashkëveprimtarin e tyre besnik, komandantin legjendar, e për gjithë komandantët dhe ushtarët e të gjitha ushtrive çlirimtare. Le të pyesim sa më shpesh kush ishin ata, pse ata morën pushkën, pse ata flijuan më të shtrenjtën e tyre, për çka ranë ata...? Duke i përkujtuar ata, ne e nderojmë së pari veten, qetësojmë shpirtat tanë, kthjellojmë të tashmen dhe të ardhmen, vizionin dhe misionin tonë dhe të atyre që ranë.

Çdo punë e mirë kërkon kurban e çdo kurban sjell bereqet. Kurban i Kosovës u bë komandanti legjendar Adem Jashari, familja e tij e ndershme dhe fisnike, si dhe të gjitha familjet shqiptare që dhanë bijtë dhe bijat e tyre për lirinë e atdheut, me të vetmin qëllim: për një të ardhme më të mirë. ■



Festimi i 28 Nëntorit 1946 në Manastir

NË KËTË SHTËPI, PREJ 14
DERI 22 NËNDOR 1908 -ËN U
MBAJT KONGRESI I MANAST-
IRIT I ATDHETARËVE SHOIP-
TARË NË TË CILIN U PRANUA
ALFABETI I TANISHËM SHOIP.

KËSHILLI PËR KREMT-
IMIN E GJASHTËDHJE
TË VJETORIT TË
ALFABETIT SHOIP

Përvjetori i alfabetit

Fillor **MERSIMI**

Manastiri është vendi ku siç thotë kënga nisën rrugën shkronjat e alfabetit tonë, nisën rrugën e gjatë e të mundimshme shekullore për t'u bërë margaritarë të identitetit tonë. Më 14 nëntor 1908, në Manastir, u mbledh Kongresi i Manastirit ose Kongresi i Alfabetit. Kongresi i vijoi punimet deri më 22 nëntor. Shoqëria e atëhershme më aktive "Bashkimi" në Manastir, thirri Kongresin e Parë të Përgjithshëm për diskutimin e një alfabeti të njësuar. Në këtë kongres ishin të pranishëm 150 delegatë, të ardhur nga të gjitha anët e Shqipërisë, si dhe nga komunitetet shqiptare në Rumani, Itali, Greqi, Turqi, Egjipt, Amerikë etj. 32 prej tyre kishin të drejtë vote. Ata përfaqësonin 26 qytete e shoqëri të ndryshme shqiptare brenda dhe jashtë atdheut. Gjatë dy ditëve të para të Kongresit u zhvilluan mbledhje të gjera e të hapura, ku morën pjesë, përveç delegatëve, edhe intelektualë e nxënës të shkollave të Manastirit, si edhe banorë të tjerë të këtij qyteti, rreth 400 veta. Megjithatë, qysh në orët e para të mëngjesit, para objektit ishin grumbulluar qindra shq-

iptarë e të tjerë, të cilët të ftohtin e përballonin përmes këngëve dhe valleve kombëtare, gjë që krijonte përshtypjen sikur aty bëhej ndonjë dasmë e madhe shqiptare. Para objektit, në të dy anët e Dragorit, ishin mbledhur edhe më tepër se 100 nxënës shqiptarë, të cilët mësonin në shkollat e mesme, sidomos në Gjimnazin turk të Manastirit që ndodhej pranë objektit të Kongresit. Këngët dhe vallet pushuan në momentin kur filluan të vijnë kongresmenët, të cilët ishin ajka e kombit shqiptar, siç ishin: Mitat Frashëri – kryetar i kongresit, kurse më vonë edhe i Ballit Kombëtar, Gjergj Fishta – "Homeri shqiptar", Luigj Gurakuqi, Shain Kolonja – dhëndri i Naim Frashërit, etj. Përqaftimet dhe lotët nga gëzimi nuk kishin fund. Interesant ishte fakti që midis kongresmenëve kishte muslimanë sunitë, bektashinj, krishterë, ortodoksë, katolikë, protestantë, toskë, gegë, çamër, lebër, etj. Prandaj edhe para objektit ishin të pranishëm njerëz, pothuajse, të të tëra konfesioneve në fjalë. Pas kësaj ceremonie madhështore, njerëzit u kthyen nëpër shtëpitë e veta duke pritur me padurim epilogun, kurse pjesëmarrësit e Kongresit hynë në sallën e madhe. Kongresi me vota unanime vendosi që alfabeti i gjuhës shqipe t'i ketë 36 shkro-

nja, të cilat përdoren deri në ditët tona. Kështu, pas shumë shekujsh përpjekje, u arrit jetësimi i ëndrrës shumëshekullore: një komb, një gjuhë, një abece.

Manastiri u bë qendër e shqiptarëve

Pas përfundimit të suksesshëm të Kongresit, Manastiri u bë qendër e rëndësishme kulturore shqiptare. Në Manastir u hap dhe shtypshkronja, e cila financohej nga një grup tregtarësh atdhetarë muslimanë shqiptarë. Shtypshkronja e Manastirit shpejt u bë e njohur në gjithë Shqipërinë si shpërndarëse e librave dhe gazetave në gjuhën shqipe. Në këtë punishte ishin të punësuar 17 vetë, të cilët punonin me një makinë të re elektrike, që vihej në lëvizje me dorë, për të shtypur gazetën e përjavshme "Bashkimi i Kombit", si dhe abetaret shqipe dhe tekstet shkollore. Kongresi i Manastirit nuk e përqendroi vëmendjen vetëm në problemin e zgjedhjes së alfabetit të gjuhës, por edhe në çështjet e rëndësishme politike. U vendos të shpallej si klub qendror klubi "Bashkimi" i Manastirit, ngase ai luajti një rol të rëndësishëm për shkrimin dhe shkollën shqipe, i shërbeu ngritjes së ndërgjegjes kombëtare të popullit shqiptar dhe unitetit të tij. Manastiri, si qendër

e rëndësishme ekonomike, iu mundësoi disa familjeve shqiptare, të pasurohen dhe një pjesë të pasurisë ta shfrytëzojnë në dobi të veprave kombëtare, siç ishte edhe Kongresi i Manastirit. E them këtë, sepse ky kongres zgjati rreth 10 ditë dhe kërkonte shpenzime të mëdha, të cilat ranë kryesisht në kurriz të familjeve të pasura, siç ishin ajo e Gërmenjëve, në hotelin e të cilëve – “Liria”, u mbajt kongresi në fjalë, si dhe ajo e Qiriazëve, familja më patriotike në mbarë kombin shqiptar dhe në të gjitha epokat pas asaj të Frashërve, prej të cilës fitoi frymëzimin e saj kombëtar dhe atdhetar. Rezultatet e Kongresit jehuan anekënd tokave shqiptare. Telegrame të shumta nga shoqëritë shqiptare të Selanikut, Shkupit e Manastirit u shprehën në mbrojtje të alfabetit shqip. Në mars të vitit 1910 u thirr edhe Kongresi i Dytë i Manastirit. Aty u vendos që të vazhdohet përdorimi i alfabetit kombëtar me shkronja latine. Në Manastir u formua edhe Klubi i Manastirit, i cili u caktua si qendër për krijimin e një Federate të klubeve shqiptare në Shqipëri dhe në kurbet.

Rëndësia e Kongresit

Qëllimi i klubeve ishte përhapja e gjuhës dhe arsimit shqip, pa u përzier me politikë. Kongresi i Manastirit ishte urë lidhëse midis Lidhjes së Prizrenit dhe Pavarësisë së Shqipërisë, për faktin se në Lidhjen e Prizrenit të vitit 1878 u ak- tualizua nevoja e aprovimit të alfabetit të përbashkët. Pran-


daj, jo rastësisht, vetëm disa muaj pas kësaj, gjegjësisht gjatë vitit 1879, u krijua Alfabeti i Stambollit, i njohur edhe si Alfabeti i Sami Frashrit, sepse ky me duart e veta i sajoi gërmat e atij alfabeti, i cili u vlerësua lart në Kongresin e Manastirit. Ndërsa, lidhja e Kongresit me Pavarësinë e Shqipërisë qëndron në faktin se para këtij kongresi, shqiptarët përdornin alfabetet të ndryshme, të cilat, jo vetëm që pengonin komunikimin normal midis tyre përmes letrave, por shkaktonin edhe grindje, sepse rrezikohej që shqiptarët të binin nën ndikimin e vendeve nga të cilat merrej alfabeti. Me aprovimin e Alfabetit të Manastirit, pengesat në fjalë morën fund, gjë që hapi rrugën e trasuar nga Lidhja e Prizrenit drejt Pavarësisë së Shqipërisë, e cila u realizua në të njëjtin muaj, pas 4 vitesh nga Kongresi i Manastirit, më 28 nëntor 1912.

Pushtimi i Manastirit

Megjithatë zhvillimi kulturor i shqiptarëve, fatkeqësisht, për një kohë u ndërpre. Ismail Bej Qemal Vlora shpalli mëvetësinë e Shqipërisë më 28 nëntor të 1912, në Vlorë. Pas pak muajsh filloi Lufta Ballkanike dhe Manastiri e Shkupi, dy qytete historikisht të banuara nga shumica me popullsi shqiptare, u pushtuan nga sllavët. Të gjitha dyqanet dhe librat shqip u dogjën dhe shumica e atdhetarëve shqiptarë u persekutuan nga serbët e disa burgosën. Popullata mus-

limane shqiptare u detyrua të braktiste qytetin e Shkupit dhe të Manastirit. Ato familje ortodokse shqiptare që mbetën aty, me kalimin e viteve dhe me dhunë, u nënshtruan duke humbur dinjitetin e tyre shqiptar. Është realitet kur themi se alfabeti na bashkoi kulturalisht e jo edhe territorialisht. Me themelimin e Alfabetit të Manastirit, shqiptarët treguan se janë popull i civilizuar, se i afroreshin botës së qytetërimit. Një alfabet i njësuar ishte fillimi i letërsisë mbarëshqiptare. Kongresi i Manastirit u mbajt në Manastir më 14 deri 22 nëntor 1908 dhe në nëntorin e këtij viti (2009) mbushen plot 101 vjet. Në historinë e vonë të Shqipërisë, Kongresi i Manastirit shënon një ngjarje të rëndësishme politike, kulturore, shkencore (gjuhësore) dhe arsimore për kombin shqiptar. Kongresi i Manastirit është kongresi i alfabetit kombëtar të shqipes, që u përpilua dhe u miratua prej tij, alfabeti që përdorin shqiptarët edhe sot. Alfabeti kombëtar i sotëm është kurorëzim i një pune disa shekujsh, një proces që zgjati afër katër shekuj dhe që u përfundua në nëntor 1908 me punën e Komisionit të Kongresit të Manastirit. Kongresi i Manastirit dhe vendimet e tij përbëjnë një nga ngjarjet më të rëndësishme në historinë e re të popullit shqiptar. Për herë të parë, pas kuvendeve që u mbajtën në periudhën e Lidhjes së Prizrenit (1878-1881) dhe të Lidhjes së Pejës (1899-1900), u mblodhën në këtë Kongres përfaqësues nga të gjitha krahinat e Shqipërisë dhe u morën vendime të rëndësishme për çështjen e alfabetit e për ato politike, që ndihmuan për ngritjen në një shkallë më të lartë të kulturës e të arsimit shqiptar, si edhe për bashkimin e tij të mëtejshëm në luftën për çlirimin kombëtar. ■





Ora e ndalur e njohjeve për Kosovën

Prandaj çelësi për rrotullimin e numrit 63 edhe më tej në numrin 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70... të njohjeve, në situatën në të cilën gjendemi tani, do të mund të arrihej përmes një bashkëpunimi edhe më të ngushtë me Turqinë dhe Arabinë Saudite, të cilat do të ndikonin në shtetet, si: Mauritania, Katari, Omani, Jemeni, Kuvajti, Pakistani, Siria, Bangladeshi, Indonezia...etj., të njohin më shpejt Kosovën, meqenëse edhe vetë e kanë njohur atë



Avni XHEMAJLI

Në fazën më të rëndësishme të konsolidimit të shtetit më të ri në botë dhe në kohën kur kanë mbetur edhe pak ditë deri në fillimin e seancave gjyqësore në GJND, kur Kosova do të përballet drejtpërsëdrejti me Serbinë në Hagë, ora e njohjeve e Kosovës që ndalur në numrin 62 për katër muaj rresht, që prej kohës kur më 11 korrik 2009 Republika Dominikane e kishte njohur Republikën e Kosovës e fundit si shtet. Mirëpo falë miqve ndërkombëtarë që e kanë mbështetur Kosovën që nga fillimi e deri më tani, edhe kësaj radhe, veçanërisht falë Britanisë së Madhe, Kosova para pak ditësh u njoh nga Zelanda e Re, e cila e lëvizi numrin e njohjeve prej 62 në 63.

Mirëpo, ngadalësimi i ritmit të njohjeve, sikurse i muajve më parë dhe vazhdimi i ngecjes eventuale i njohjeve në numrin 63 për një kohë edhe më të gjatë, duke mos arritur numrin e njohjeve në 100, si kusht për të fituar të drejtën e anëtarësimit në OKB dhe më pastaj edhe

në organizata të ndryshme ndërkombëtare të karakterit politik, ekonomik, kulturor, sportiv, etj., shtetit më të ri të botës po vazhdon edhe më tutje t'i shkaktojë shumë vështirësi.

Por, fatmirësisht, jo gjithçka duket se është ndalur. Pak më herët, para njohjes së shtetit më të ri të botës nga Zelanda e re, Kosova arriti ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit kufitar me Maqedoninë dhe tani realizimin e marrëveshjes për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike - që në sytë e botës është argument i pjekurisë shtetformuese dhe sinjal i mirë për paqen, normalizimin dhe stabilitetin në rajon - gjë që do të reflektojë pozitivisht për Kosovën në GJND, gjatë procesit të paraqitjes së argumenteve për shpalljen e pavarësisë së Kosovës dhe ligjshmërisë së saj.

Për kohën sa ende ka mbetur deri para fillimit të seancave dëgjimore në GJND, më 1 dhjetor 2009, Kosova me aleatët e saj do të mund të pozicionoheshin edhe më mirë në GJND përballë Serbisë dhe përkrahësve të saj. Arritja e njohjeve të reja në këto çaste, do të ishte pa dyshim e një rëndësie të veçantë, sepse padinë që ka ngritur Serbia ndaj Kosovës në GJND, ndër të tjerash, e ka ngritur edhe me qëllimin për ta frenu-

ar ritmin e shpejtë të njohjeve të Kosovës që kishte në fillim dhe për ta penguar në këtë mënyrë anëtarësimin e saj në OKB.

Ku dhe kush po e ndal orën e njohjeve për Kosovën?

Shtetet e mëdha si Rusia dhe Kina në kontinentin e Azisë; Argjentina dhe Brazili në kontinentin e Amerikës Latine, së bashku me Spanjën, të cilat do të paraqiten në favor të Serbisë dhe kundër pavarësisë së Kosovës në GJND, janë duke penguar një numër të madh shtetesh më të vogla, të cilat janë nën ndikimin e tyre, për të mos e njohur pavarësinë e Kosovës, të shpallur më 17 shkurt 2008.

Rusia, si përkrahëse e pazezervë e Serbisë në dëm të pavarësisë së Kosovës, është duke ushtruar ndikim në shtetet që ishin pjesë përbërëse të Bashkimit Sovjetik, si: Bjellorusia, Kazakistani, Moldavia, Ukraina, Azerbajxhani, Uzbekistani, Kirgistani, etj.

Shtetet që do të deklarohen në favor të pavarësisë së Kosovës: Shqipëria, SHBA-ja, Arabia Saudite, Franca, Bahrejni, Britania e Madhe, Jordania, Austria, Holanda, Gjermania, Kroacia, Bullgaria, Finlanda, Danimarka, Norvegjia.

Kina, e cila po ashtu është kundër pavarësisë së Kosovës në GJND, për shkak të problemeve të saj ende të pazgjidhura politike me Sinkjanin, Tibetin ose Tajvanin, e kundërshton pavarësinë e Kosovës dhe, përveç kësaj, si shtet në ekspansion ekonomik në këtë shekull, ajo gjithashtu po ushtron ndikimin e saj politik te shtetit e vogla aziatike, si Koreja Veriore, Kamboxhia, Laosi, Nepali, Vietnami...etj.

Një vend tjetër, nga i cili do të mund të vinin më shumë njohje, është edhe kontinenti i Amerikës Latine. Mirëpo derisa Argjentina dhe Brazili, si dy shtetet më të mëdha dhe me më ndikim të këtij kontinenti, qëndrojnë në favor të Serbisë dhe përkrah saj edhe në GJND, mbetet pak për të shpresuar se Kosova do të pranojë së shpejti ndonjë njohje nga ky kontinent. Dhe kur këtyre dy u shtohet edhe Spanja, si shtet me ndikim të madh gjuhësor, kulturor e politik ndaj shteteve më të vogla të Amerikës Latine, shpresa për arritjen e ndonjë njohjeje së shpejti nga kjo pjesë e botës zbehet edhe më shumë.

Në këtë rast, kësaj të fundit, diplomacia e Kosovës së bashku me atë të Shqipërisë, do të duhej t'i përkujtonin Spanjës në takimet e tyre se shqiptarët janë popull liridashës, se me dhjetëra mijëra shqiptarë para 60 vitesh patën marrë pjesë në luftë, duke e dhënë edhe jetën e tyre për mbrojtjen e lirisë dhe për mbrojtjen e Spanjës kundër regjimit të egër fashist të Frankos, të ngjashëm me atë të Millosheviqit që kishim ne; sundimi i të cilit e pati kthyer Spanjën një shekull mbrapa.

Kush, ku dhe si mund të vihet ora e njohjeve në lëvizje përsëri?

Për ta vënë në lëvizje më shpejt ritmin e ngadalësuar të njohjeve, diplomacia e Kosovës së bashku me atë të Shqipërisë duhet ta bëjnë të njëjtën gjë që e ka bërë dhe po e bën diplomacia e Serbisë: Ndërmarrjen e një ofensive diplomatike në mobilizimin e aleatëve dhe përkrahësve të pavarësisë së saj, si: SHBA-të, Arabia Saudite, Franca, Turqia, Britania e Madhe etj. që në koordinim dhe bashkëpunim, të hidhen në kërkim të njohjeve të reja, si dhe aktivitetin për ndaljen e ndikimit negativ të shteteve, si Brazili, Argjentina, Kina dhe Rusia, etj. që përditë po e dëmtojnë pavarësisë e Kosovës.

Në këtë sferë, Kosova duke bash-

këpunuar me SHBA-të, Francën, Britaninë e Madhe, etj., do të mund të realizonte një seri njohjesh të reja. SHBA-të do të mund të ndikonin në shumë shtete të vendeve të ndryshme të botës; Franca do të mund të ndikonte në ish-shtetet e saj koloniale, sidomos në shtetet e Afrikës Veriperëndimore dhe, gjithashtu, edhe Britania e Madhe do të mund të ndikonte në shumë vende të ndryshme, ish-koloni të saj.

Ndërkaq, diplomacia e Kosovës nuk do të duhej të ndalej vetëm këtu, por aktivitetin e saj lobues do të duhej të zhvillonte në një koordinim më të ngushtë edhe me shtetet mike, si Turqia dhe Arabia Saudite; shtete këto të cilat kanë ndikim të jashtëzakonshëm në hiç më pak se gati në një të tretën e botës për nga numri i shteteve. Turqia ka ndikim të madh në Konferencën Islamike, që gjithsej numëron 57 shtete, kurse Arabia Saudite ka ndikim të fuqishëm te 23 shtetet e Ligës Arabe dhe gjithashtu edhe te shtetet e Konferencës Islamike.

Prandaj çelësi për rrotullimin e numrit 63 edhe më tej në numrin 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70... të njohjeve, në situatën në të cilën gjendemi tani, do të mund të arrihej përmes një bashkëpunimi edhe më të ngushtë me Turqinë dhe Arabinë Saudite, të cilat do të ndikonin në shtetet, si: Mauritania, Katari, Omani, Jemeni, Kuvajti, Pakistani, Siria, Bangladeshi, Indonezia...etj., të njohin më shpejt Kosovën.

Mundësinë për arritjen e këtyre njohjeve nga këto shtete, e përforcon edhe vetë fakti i pjesëmarrjes së shtetit më të madh dhe me më ndikim në Ligën Arabe - pra Arabisë Saudite - e cila do të paraqesë argumentet e saj në favor të pavarësisë së Kosovës në GJND. Mirëpo, Arabia Saudite nuk është i vetmi shtet nga vendet islame që pritet të jetë në mbrojtje të pavarësisë së Kosovës përballë Serbisë; por krahas saj në mbrojtje të shpalljes së pavarësisë do të jenë edhe Jordania dhe Bahrejni, të cilat po ashtu do të flasin dhe do t'ia parashtronë GJND-së argumentet e tyre për të drejtën e popullit të Kosovës dhe të ligjshmërisë për shpalljen e pavarësisë së saj.

Sigurisht se kjo do të ishte një mundësi e mirë për Kosovën, që së bashku me këto shtete të vendeve islame, të jetë në GJND në mbrojtje të shpalljes së pavarësisë së saj. Diplomacia



Shtetet që do të deklarohen kundër pavarësisë së Kosovës: Bolivia, Rusia, Argjentina, Spanja, Qipro, Kina, Azerbajxhani, Rumania, Serbia, Brazili, Bjellorusia, Burundi, Venezuela, Vietnami, Laosi.

e Kosovës duhet të zhvillojë një aktivitet të ngjeshur lobues në vendet e Ligës Arabe dhe të Konferencës Islamike që ende së kanë njohur dhe ato që pritet ta njohin së shpejti, gjë që do t'i ndihmonte Kosovës të arrijë numrin e nevojshëm të njohjeve për t'u anëtarësuar në organizatat relevante. Kurse, fillimi i hapjes së ambasadave në këto vende, duke shtrirë rrjetin diplomatik edhe në këtë anë të botës, në shtetet që tanimë e kanë njohur Kosovën, si: Jordania, Bahrejni, Emiratet e Bashkuara Arabe, Malajzia,...etj. do t'i ndihmonte Kosovës gjithashtu në shtimin e numrit të njohjeve të saj.

Përndryshe, ndalja e orës së njohjeve dhe mosveprimi në praktikë për ta vënë atë në lëvizje më një ritëm të përshpejtuar, do ta ndalte edhe orën e zhvillimit për Kosovën, gjë që do të vazhdonte ta mbante atë ende larg dyerve të OKB-së, si organizata më e madhe dhe më e rëndësishme në glob. Po ashtu, do t'ia pamundësonte anëtarësimin në organizatat e ndryshme, si ato sportive, si UEFA e FIFA, dhe do t'ia pamundësonte gjithashtu të drejtën për marrjen e bar kodit shtetëror dhe numrin e prefiksit të telefonisë fikse, në mungesë të të cilit, Serbia, prej pasluftës e deri më tani, ka fituar nga qytetarët dhe shteti i Kosovës mbi 150 milionë euro.

Fat i mirë, nëse mund të quhet kështu, është se mendimi i GJND-ës nuk është detyrues në lidhje me shpalljen e pavarësisë së Kosovës. Mirëpo fat më pak i mirë është se si pasojë e këtij procesi që pritet të zgjasë deri kah mesi i vitit 2010, derisa GJND-ja ta japë mendimin e vet, është se deri atëherë Kosova rrezikohet të mbesë e izoluar politikisht dhe si rrjedhojë edhe ekonomikisht, duke e ngadalësuar në këtë mënyrë ritmin e zhvillimit të saj për një të ardhme dhe perspektivë më të mirë si shteti më i ri në botë. Prandaj për ta evituar këtë, formula e vetme mbetet: Lobim, lobim, lobim për Kosovën në katër anë e botës deri në anëtarësimin në Organizatën e Kombeve të Bashkuara. ■

Ndërkombëtarët interesohen për problemet në USHT




Avni AVDIU

Është folur e është shkruar mjaft rreth ndërhyrjeve arbitrare të partive shqiptare në pushtet edhe ndaj arsimit, në veçanti ndaj USHT. Qëkur ish-ministri i Arsimit Pero Stojanovski shkarkoi (më 2 korrik të këtij viti) anëtarët e senatit, si dhe rektorin Agim Vela, spekulimet dhe paqartësitë rreth Universitetit Shtetëror të Tetovës, s'kanë të ndalur. Mirëpo tani ky institucion është bërë objekt edhe i interesimit ndërkombëtar. Në këtë kontekst "Magna Karta Observatoria" e Bolonjës i është drejtuar me një letër ministrit aktual Nikolla Todorov për të kërkuar llogari rreth ndërhyrjes në USHT. Edhe pse kanë kaluar më se dy muaj që kur Baumann i ka adresuar një letër ministrit të arsimit, Todorov nuk i është përgjigjur kësaj letre. Baumann i ka kërkuar qeverisë që të jetë sa më transparente rreth ndërhyrjeve në USHT. Sekretari i përgjithshëm i "Magna Karta Observatorit", (trupi më i lartë i Procesit të Bolonjës), Bastian Baumann, ka theksuar se për ndodhitë në USHT është informuar edhe nga rektori i shkarkuar Agim Vela. "Magna Karta Observatorisë" iu ofruan informata të gjëra nga z. Vela për atë se çka ka ndodhur dhe kërkuar të ndërhyjmë. Bastian Baumann shton se nëse pohimet e rektorit të shkarkuar Vela janë të sakta, atëherë ky është një rast shumë i rëndë i ndërhyrjes së padrejtë të autoriteteve publike në çështjet e universitetit dhe në këtë mënyrë shkellet autonomia, e cila është e garantuar edhe me Kushtetutë dhe ligjet e tjera të Maqedonisë.

Ky akt paraqet shkeljen e parimeve të Magna Karta Universitatum, nënshkruese e së cilës është edhe Universiteti Shtetëror i Tetovës. Po ashtu, është në

kundërshtim edhe me parimet e Procesit të Bolonjës, që në mënyrë të qartë i referohet Universitatum Magna Kartës dhe autonomisë universitare. Sekretari i përgjithshëm i "Magna Kartës", Bastian Baumann thekson se në qoftë se akuzat kundër Ministrisë janë të vërteta reagimi do të jetë i menjëhershëm.

"Megjithatë, Komuniteti Evropian i Arsimit të Lartë, duke përfshirë ministrinë e tjera, por edhe universitetet marrin parasysh këto zhvillime dhe në qoftë se situata është me të vërtetë ashtu siç është paraqitur, kjo mund të ketë efekte praktike shumë të dëmshme mbi Universitetin në lidhje me njohjen e diplomave dhe marrëveshjet e bashkëpunimit", - thotë ai. ■



Ju shkruaj në emër të "Observatorit Magna Karta", organizatë që tubon bashkërisht rreth 650 universitete, nga më shumë se 80 vendet që kanë nënshkruar "Kartën Magna Universitatum" dhe që, në këtë mënyrë, angazhohet për respektimin e parimeve dhe vlerave të paraqitura aty. Magna Karta Universitatum paraqet formën bazë e të kuptuarit të parimeve themelore dhe vlerave universitare, lirisë akademike dhe autonomisë së veçantë institucionale. Ajon gjithashtu në dukje Deklaratën e Bolonjës, si bazë mbi të cilën duhet të ngrihet Zona Evropiane e Arsimit të Lartë. Nga Republika e Maqedonisë, universitetet nënshkruese të këtij dokumenti janë: Shën Cirili dhe Metodi në Shkup, Universiteti Shtetëror i Tetovës dhe Universiteti i Evropës Juglindore. Ne kemi qenë të informuar në lidhje me incidentet e fundit në Universitetin Shtetëror të Tetovës rreth vendimit të ish-ministrit Pero Stojanovski për të shkarkuar të gjithë anëtarët e Senatit dhe për të deklaruar të pavlefshme të gjitha vendimet e senatit, duke përfshirë

edhe shkarkimin e ish-rektorit Agim Vela (Vendimi 12-4847/1). Shpërbërja e Senatit dhe shpallja e vendimeve të tij si të pavlefshme nga ish-ministri, janë me interes për ne, pasi kjo prek çështjen e autonomisë universitare dhe në këtë mënyrë shkel një nga parimet themelore të akademisë. Autonomia institucionale është një element i rëndësishëm për organizimin e arsimit të lartë, pasi ajo garanton që universitetet të përmbushin përgjegjësitë e tyre ndaj shoqërisë në kushtet e mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve për komunitetin. Gjithashtu, në Republikën e Maqedonisë, rëndësia e autonomisë institucionale është e garantuar me nenin 46 të Kushtetutës. Prandaj, unë do të doja të pyes se çfarë kanë qenë arsyet për vendimin e ish-ministrit. Unë do të jem jashtëzakonisht mirënjohës nëse ju mund të ndaleni veçanërisht me argumente, nga këndvështrimi juaj, që sipas jush arsyetuan masat që bien në kundërshtim me autonominë institucionale dhe a keni ndërmend ta përkrahni këtë vendim.



Intervistë me Drejtorin e Policisë Kufitare dhe anëtarin e komisionit për demarkacion të kufirit me Maqedoninë

Demarkacioni me Maqedoninë

Intervistoi: Muhamet JAHIRI

PRISHTINË

Është njeriu, i cili ka marrë pjesë më për së afërmi në krijimin e kufirit shtetëror mes Kosovës dhe Maqedonisë. Ai tregon se sa është e rëndësishme që një shtet ta rregullojë vijën kufitare me shtetet fqinjë. Sipas tij, Kosova nuk ka humbur territor sa ishte në rrezik të humbte nga marrëveshja e vitit 2001, mes Serbisë dhe Maqedonisë.

Është i bindur se shumë shpejt do të fillojë demarkacioni edhe me shtetin e Malit të Zi, e në të ardhmen formalisht edhe me Shqipërinë. Tregon se si mund të fillohet demarkacioni edhe me shtetin e Serbisë. Ai thotë se banorët e Dabëlldes do ta punojnë tokën e tyre, pavarësisht nga mbetja e saj jashtë kufirit të Kosovës. Ai thotë se po bën përpjekje për ta vendosur policinë kufitare edhe në pikën 1 dhe 31 në veriun e Kosovës, ndërkaq deklarohet se në shumë aspekte Kosova është në hap më përpara sesa vendet e rajonit. Flet ekskluzivisht dhe tregon për gjithë çka ka ndodhur me demarkacionin e kufirit Kosovë-Maqedoni, Behar Selimi, anëtar i Komisionit për demarkacion dhe drejtor i Policisë Kufitare.

PAQJA: A mund të na thoni se çfarë ka ndodhur me të vërtetë me vijën kufitare me Republikën e Maqedonisë?

Selimi: Vija e dikurshme administrative e Kosovës me Maqedoninë u përcaktua dhe u bë vijë ndërshtetërore. Me këtë shtet ka ekzistuar edhe një marrëveshje e vitit 2001, e cila e ka obliguar Kosovën që për atë vijë t'i humbiste 2500 hektarë. Mirëpo komisioni për demarkacion i Kosovës, në bashkëpunim me atë të Maqedonisë, morën vendim që ta shqyrtojnë atë marrëveshje dhe të marrin parasysh edhe mendimin e banorëve dhe pretendimin e banorëve për pronat e tyre. Kjo solli si rezultat edhe devijimet e arsyeshme të nevojshme të vijës së kufirit, mbi bazën e interesave të banorëve, por edhe të dy shteteve. Kjo

do të thotë se vija kufitare e shtetit nuk është qind për qind vija e marrëveshjes së vitit 2001, por është vija për të cilën kanë rënë dakord dy qeveritë. Prandaj u arrit që të nënshkruhet një marrëveshje e re në mes dy qeverive dhe kjo çështje u mbyll.

PAQJA: Cila ishte në të vërtetë kjo marrëveshje e vitit 2001?

Selimi: Unë veç fola më parë. Sidoqoftë po jap edhe disa shpjegime. Ishte shumëfish detyruese: Ishte e përligjur në KS të OKB-ës, pastaj pjesë e Planit të Ahtisaarit, madje edhe e deklaratës se pavarësisë së Kosovës, këto të fundit me legjitimitetin e dhënë nga votimi i tyre në parlamentin tonë. Juridikisht na "lidhte këmbë e duar" për të bërë diçka që do të kënaqte interesat e banorëve dhe do t'i respektonte interesat e të dyja shteteve. Baraspeshë e pamundshme për t'u arritur vite me parë. Sidoqoftë, mënyra e re e të menduarit, interpretimi kreativ i saj, ndihma e vetë banorëve të fshatrave të brezit kufitar andej e këndej kufirit dhe, sidomos, ndihma e Zyrës Civile Ndërkombëtare dhe e miqve tanë amerikanë bëri që ne të jemi relativisht të kënaqur edhe si banorë, edhe si komisione, edhe si faktor ndërkombëtar, por, para se gjithash dhe mbi të gjitha edhe si shtete që synojnë integritet.

PAQJA: Kjo do të thotë se Kosova nuk ka humbur territor të saj, siç po pretendojnë disa?

Selimi: Kosova ka humbur 21.5 hektarë tokë të Dabëlldes, e cila dikur ka qenë pjesë e komunës së Vitisë. Tani ata hektarë ngelin në Republikën e Maqedonisë, me të drejtën e shfrytëzimit, por nuk janë në territorin tonë. Eventualisht, në ndonjë pjesë të kufirit është dashur që ta lëvizim kufirin në një metër ose dy metra, ose disa hektarë, siç ka qenë rasti sidomos në trekëndëshin Shqipëri-Maqedoni-Kosovë. Prandaj nuk mund të themi se nuk kemi humbur asnjë pëllëmbë, por një gjë është e sigurt. Ajo humbje që ka qenë nga marrëveshja e vitit 2001 nuk ekziston. Në marrëveshjen e vitit 2001ka qenë një numër shumëshifror i hektarëve për t'i humbur, por nuk është më.

PAQJA: Banorët kanë të drejtë ta shfrytëzojnë pronën e tyre të mbetur në territorin e Republikës së Maqedonisë. A do të thotë kjo se ata banorë duhet që të dalin me pasaporta për ta punuar tokën e tyre?

Selimi: Nuk mendoj këtë, kur kam parasysh praktikat e shtetit. Por banorët atje do t'i kenë lejet e veçanta për të qarkulluar në atë territor. Ata nuk do të kenë nevojë për pasaporta, aq më shumë



Behar Selimi

ne Maqedoninë, z. Behar Selimi

Maqedoninë i çon proceset përpara

kur tash është një rrethanë e re dhe nuk mund ta kufizosh njeriun për të lëvizur në një territor të vetëm. Ata do t'i shfrytëzojnë tokat dhe, po u ndien të pasigurt, në të ardhmen për ta do të kujdesen patrullat e përbashkëta të policisë së dy shteteve, bashkë me KFOR-in. Kjo është çështje e të ardhmes.

PAQJA: *Kodrën e Furrës e kanë konstatuar shumë se është një pikë strategjike. Dhe kanë hedhur akuza se, edhe përkundër që ka qenë pikë strategjike, i është dhënë Maqedonisë. Si qëndron e vërteta?*

Selimi: “Kodra e Furrës” nuk ka mbetur në Republikën e Maqedonisë. Nëntëdhjetë e nëntë për qind e asaj kodre ka mbetur në territorin e Kosovës, aty ku ka qenë. Në fundin e kësaj kodre është një pikë e përbashkët që shënon fillimin e atyre 21.5 hektarëve që kanë mbetur në Republikën e Maqedonisë. Kjo do të thotë se “Kodra e Furrës”, ka mbetur në Republikën e Kosovës, kurse maja në fundin e kodrës është pikë e përbashkët, që shërben në të ardhmen për patrulla.

Sa i përket pikës strategjike, mund të them me plot kompetencë se largësitë gjeografike që kanë shërbyer përpara për t'u mbrojtur, sot nuk e kanë këtë domethënie. Jemi dëshmitarë se ato lartësi më tepër janë bukuri të rralla për turizëm ose edhe për zhvillim të teknologjisë së komunikimit, për zhvillim të bujqësisë dhe blegtorisë gjithsesi, por nuk e kanë rëndësinë e dikurshme të mbrojtjes. Largësia që e siguron Kosovën dhe popullin e saj është largësia që quhet NATO. Sot me teknologjitë informative mund të shihet çfarëdo dhe kudo, madje edhe të lansosh mbrojtje nga zyra. Por edhe nëse dikush vazhdon ta konsiderojë pikë strategjike, ajo ka mbetur në territorin e Republikës së Kosovës.

PAQJA: *Ka pasur protesta për caktimin e vijës kufitare edhe në Republikën e Maqedonisë. Edhe atje ka pasur akuza se territori i shtetit të tyre i është falur Kosovës. A mund të na thoni se a ka marrë në të vërtetë Kosova ndonjë pëllëmbë territor të Maqedonisë?*

Selimi: Jo absolutisht, ne nuk kemi



Behar Selimi

marrë asnjë pëllëmbë toke maqedonase. I gjithë procesi ka qenë që ato hektarët që i ka nënkuptuar marrëveshja e vitit 2001, të përshtaten për nevojat e banorëve të Kosovës, sepse kur është nënshkruar ajo marrëveshje, Kosovën nuk e ka pyetur askush. Prandaj nuk është negociuar për asnjë metër tokë të shtetit maqedonas. Ajo çka ka ndodhur është një korigjim i një gabimi të madh, që është bërë dikur në vitin 2001 dhe korigjim që nuk ka ndodhur bash siç kemi pasur të drejtë dhe dëshirë ne.

PAQJA: *A mund të na thoni sa është i rëndësishëm për një shtet demarkacioni kufitar?*

Selimi: Është esencial, meqë territori dhe përkufizimi i tij është njeri nga tri kushtet themelore për ekzistimin e shtetit. Në kohën tonë ka edhe domethënien e gatishmërisë për integritet rajonale e ndërkombëtare.

Kosova doli nga shpërbërja e një federate, në rastin tonë, fatkeqësisht me gjak e luftë, por shumica e përvojave në botë na ka mësuar se shndërrimi i kufijve nga ata administrativë në ata shtetërorë është i domosdoshëm për stabilitet dhe juridiksion.

Në aspektin praktik, duhet ta dimë se deri ku shtrihet kontrolli, deri ku vlejné ligjet tona, deri ku duhet të jepet taksa për pronat dhe cila pjesë e territorit duhet të llogaritet si tërësi territoriale, e cila duhet të mbrohet nëse sulmohet. Prandaj është e domosdoshme që sa më parë të bëhet përkufizimi fizik i territorit tonë dhe, në këtë aspekt, nuk jemi keq në krahasim me shtetet në rajon. Mund të themi se edhe vendet e rajonit si Mali i Zi, Kroacia, Bosnja e Sllovenia, ende

nuk i kanë përcaktuar vijat kufitare. Jemi dëshmitarë të problemit kufitar mes sllovenëve dhe kroatëve.

Por ka edhe shtete në Afrikë, apo në ish-Bashkimin Sovjetik ku nuk janë rregulluar kufijtë. Por, për ne është me rëndësi që të bëhet një gjë e tillë, që të mos kemi probleme integruese.

PAQJA: *Akoma kemi probleme edhe te Karaqeva dhe te Kulla. Çfarë do të ndodhë, a do të jenë edhe ato vende pjesë e demarkacionit?*

Selimi: Me Serbinë nuk po parashikoj që demarkacioni të ndodhë së shpejti. Por një gjë është e sigurt. Ajo që konsiderohet sot si vijë e kufirit administrativ me Serbinë, ajo do të jetë vija që do të merret për bazë për delimitim, demarkacion dhe delinim.

Në praktikën e shënimit fizik të vijës kufitare, vija administrative nuk mbetet qind për qind vijë shtetërore. Pra, janë komisionet për caktimin e kufijve ato që bëjnë caktimin dhe shënimin e saktë të vijës kufitare. Të dhënat kadastrale nuk mjaftojnë, nevojiten hartat topografike, mendimet dhe dëshmitë e banorëve etj, por respektohet edhe vija e natyrshme kufitare. Në Karaqevë e Novoselë janë disa shenja të KFOR-it që krijojnë një paragjykim. E njëjta situatë është edhe me Malin e Zi, ku KFOR-i me marrëveshjen e Kumanovës i ka vendosur disa shenja që këto shtete po i quajnë kufijtë e Kosovës, por ato shenja nuk përcaktojnë vijën shtetërore. Ato kanë domethënien e ndarjes mes forcave. Ne e dimë se ato shenja të vendosura nga KFOR-i kanë shërbyer për të treguar se 5 kilometra ndalohet lëvizja e forcave



të armatosura. Sidoqoftë, deklaratat e mëhershme të zyrtareve policorë të Malit të Zi, janë jokompetente dhe të parakohshme, sepse policët nuk mund të thonë se kjo është ose s'është vijë kufitare përderisa komisionet për demarkacion të të dy shteteve nuk bëjnë shënimin fizik. Po të mos isha anëtar i komisionit, s'do të më lejohej as mua të flisja, e lëre më të konstatoja diçka të tillë.

Sidoqoftë, banorët nuk duhet të shqetësohen për humbjen e tokave, sepse e drejta për pronën është e drejtë e shenjtë dhe se procesi nuk ka filluar. Situata aktuale, të cilën e ka pranuar KFOR-i, është situatë oportune për nevoja të sigurisë dhe KFOR-i konsideron se ajo gjendje duhet të mbetet ashtu, deri në shënim fizik të vijës kufitare. Ndërkohë, shqetësimet e sigurisë së banorëve i kuptojmë drejt dhe, së këndejmi, aq sa është në mandatin tonë territorial, po përpiqemi të jemi sa më pranë banorëve dhe bashkë me KFOR-in të ofrojmë siguri.

PAQJA: Kur pritet që të bëhet përcaktimi i vijës kufitare edhe me Malin e Zi?

Selimi: Besoj që ka një disponim të mirë edhe nga qeveria malazeze, që shihet së paku nga deklaratat e tyre publike, se janë të gatshëm dhe nuk shohin asnjë kontest territorial me ne. Pritet krijimi i një komisioni kompetent ndërqeveritar dhe ky komision do të negociojë një lloj marrëveshje. Është krijuar një bindje në opinion, sikur për shënimin e vijës kufitare nuk ka nevojë për një kohë të gjatë dhe se ai nuk është proces i vështirë, por megjithatë praktikata e shndërrimit të vijave administrative në vija kufitare ndërshtetërore nuk janë të lehta. Për shënimin e vijës kufitare duhet kaluar nëpër katër faza, pra, fillimisht, duhet një komision ndërshtetëror që negocion një marrëveshje për delimitim, i cili e ka kuptimin e shënitimit në letër të vijës kufitare tekstualisht dhe vizatimi në harta. Faza e dytë është faza e demarkacionit, e cila nënkupton shënimin fizik të vijës kufitare, vendosjen e piramidave, shenjave të ndryshme nëpër gjithë vijën e gjelbër. Faza e tretë është faza e dokumentimit me procesverbale, aerofotografi, orto-

fotografi e të dhëna koordinatash etj; dhe faza e katërt është faza e mirëmbajtjes së vijës kufitare. Të gjitha këto faza nënkuptojnë marrëveshjen ndërshtetërore. Pra, duhet kohë për t'u bërë mirë kufijtë. Sa do që në të ardhmen do ta humbasin rëndësinë në kuptimin politik e fizik, në kuptimin juridik e ekonomik do të kenë rëndësi të përhershme për vendin tonë.

PAQJA: Kosova ka probleme edhe me pikat doganore të saj, sidomos në veri të vendit. Çfarë jeni duke bërë që të funksionalizohen pikat 1 dhe 31 në veri të vendit?

Selimi: Problemi kryesor është mungesa e kontrollit tonë të plotë dhe të mbikëqyrjes së pikave të kalimit në veri. Atje nuk ka kontroll dhe menaxhim të plotë të kufirit, mbi bazën e ligjit për menaxhim të integruar dhe kontroll të kufirit të shtetit, madje as sipas strat-



egjisë që kemi miratuar, për arsye që dihen botërisht. Atje ka kolegë ndërkom-bëtarë të EULX-it, të cilët përpiqen t'i parandalojnë kalimet ilegale e sidomos kontrabandën. Por atje vazhdon të mos ketë doganier, të cilët natyrisht janë përgjegjës kryesorë për kontrollimin e futjes së mallrave dhe kjo do të jetë sfida e parë. Sfida e dytë është vija e gjelbër. Vijën e gjelbër prej 743.556 kilometrave vijë kufitare që i ka Republika e Kosovës, policia e Kosovës akoma nuk e ka mandatin për ta mbikëqyrë këtë pikë. Pra, ne akoma nuk kemi mandat, burime njerëzore, teknike për ta marrë këtë përgjegjësi nga KFOR-i. Është vështirë për faktin se KFOR-i është shumë kompetent për ta mbrojtur integritetin e Kosovës, por nuk është kompetent për ta parandaluar kontrabandën, e cila zhvillohet në vijën e gjelbër, përkatësisht në disa pjesë të Kosovës. Kuadrot që ne

po shpresojmë se do t'i marrim nga një riorganizim i brendshëm, diku rreth 500 oficerë, duhet t'i trajnojmë dhe t'i pajisim me pajisje përkatëse, sepse vija e gjelbër kërkon edhe pajisje dhe trajnime të veçanta, në mënyrë që KFOR-i të na i besojë përgjegjësitë nëpër faza. Ne besojmë se në vitin e ardhshëm do ta bindin KFOR-in, aq më shumë kur këta të fundit po paralajmërojnë edhe vetë reduktim, që një pjesë e kufirit tonë të kalojë nën përgjegjësinë tonë. Këtu mendoj para së gjithash në vijën e gjelbër të Republikës së Shqipërisë dhe me Republikën e Maqedonisë, ndërkohë që nëse procesi do të shkojë mirë edhe me Malin e Zi, atëherë biem dakord që ne të fillojmë me patrullime të autorizuara në vijën e gjelbër gjithandëj ku ekziston kufiri mes këtyre tri shteteve.

Administrata e mëhershme ndërkom-bëtare e ka lënë Kosovën pa polici kufitare të trajnuar dhe të përgatitur për të ruajtur kufijtë, sepse kjo administratë nuk e ka menduar Kosovën shtet.

PAQJA: Për fund, a mund të na thoni se sa është Kosova në hap me vendet e tjera të rajonit sa i përket këtyre çështjeve?

Selimi: Mendoj se me infrastrukturë jemi më keq se disa vende të rajonit. Kjo nënkupton se neve na duhet teknologjia përkatëse informative, e cila na krijon mundësinë për t'u përgatitur për liberalizimin e vizave. Na nevojitet personeli i mjaftueshëm. Si polici kufitare kemi vetëm procedura më të avancuara të punës. Në kuptimin e menaxhimit të integruar jemi shumë më përpara. Jemi shumë më të avancuar sesa shtetet në rajon. Këtë ua them me kompetencë të plotë, sepse jam drejtues i bordit ekzekutiv për menaxhim të integruar, që nënkupton bashkëveprim dhe bashkëpunim me të gjithë agjencitë që ofrojnë shërbime kufitare. Pra, me një fjalë, në këtë drejtim, jemi më të mirët në rajon sepse punojmë bashkë. Kemi shembull Vermicën dhe Hanin e Elezit, ku shihet se policia edhe doganierët punojnë bashkë, gjë që nuk ndodh në vendet e tjera. Bashkimi Evropian për kufij na ka ndarë rreth 7 milionë euro dhe, deri nga fundi i viti të ardhshëm, do ta vendosim sistemin e teknologjisë nëpër pikat tona kufitare. ■

Pse kosovarët e varfër bëjnë shumë fëmijë?



Mevlude ZEJNULLAHU

Idea e varfërisë së skajshme në Kosovën e pasluftës është një temë që meriton analizë dhe objektivitet të shpjegimit çdo ditë. Në këtë kontekst, vëmë re se ia vlen të analizohet edhe më tej fenomeni i rritjes së varfërisë së skajshme (sipas parametrave të UNDP-së, ka të ngjarë që kjo dukuri është duke u rritur) në shoqërinë kosovare. Natyrisht, shkaqet janë të shumta, por, ndër këta faktorë të kësaj gjendje, janë edhe ata socialë, që për shoqëritë e zhvilluara janë parametra që dinë të përmbysin edhe qeveri të tëra, kurse te ne vetëm alarmohen si të tilla dhe nuk ndërmerret asgjë më tej. Pra, varfëria e skajshme, që në rastin e Kosovës është në rritje e sipër, riprodhon edhe shtim të natalitetit, që është një absurd i llojit të vet edhe për shkak se nataliteti i lartë, pra jo planifikimi i familjes, ka reperkusione jo vetëm sociale e ekonomike, por edhe politike e, para së gjithash, do të thosha morale e etnopsikologjike.

Në një familje mesatare kosovare (edhe pse nuk ka të dhëna të sakta, mesatarja është rreth 6 deri në 7 anëtarë), e me një buxhet tejet të limituar, mbijetesa është një aventurë e llojit të vet, që vetëm te ne mund ta gjesh!

Thuajse në çdo familje moderne, t'i quaj kështu familjet e sotme çfarë janë në përgjithësi në botë e që shumë më pak janë prezente te ne, planifikohet familja, e cila llogaritet: sa shpenzime mesatare bëhen, p.sh., për një fëmijë deri në moshën 7-vjeçare, sa kushton shkollimi cilësor për të, sa e sa para duhen për të e për vetë prindërit e saj. Por, fatkeqësisht, sot nuk kemi asnjë studim për kushtet tona, që na bënë të fillojmë të mendojmë edhe për planifikimin familjar.

Me planifikim familjar nuk do të thotë të kufizohet numri i fëmijëve, por të planifikohet se ku, dhe sa fëmijë

do të kesh gjatë jetës. Ky planifikim ka shumë ndikime pozitive në jetën psikike të familjes, posaçërisht në atë të çifteve bashkëshortore, duke përfshirë këtu edhe marrëdhëniet më të mira seksuale. Kurse, tek ato çifte që nuk ka planifikim familjar, pas një periudhe kohe humb edhe dëshira për gjënë e njëjtë, sidomos nga femrat, nga frika e ngeljes shtatzënë. Po ashtu, planifikimi familjar parandalon edhe shtatzënitë e padëshiruara duke parandaluar në mënyrë të drejtpërdrejtë abortet.

Në emisione të ndryshme në televizionet tona, është tmerruese kur shohim familje në gjendje të mjeruar ekonomike, sociale e shëndetësore, të rrethuar me pesë, gjashtë e shtatë fëmijë prej moshës 7 deri 1-vjeçare, po ashtu edhe një "rrugës". Është ky një tjetër fenomen që i habit edhe ndërkombëtarët, se si mund të mbijetojnë këto familje që, përveç asistencës sociale, marrin edhe ndonjë beneficion tjetër nga shteti ynë ende foshnje!

Se familjet e varfra çuditërisht bëjnë më shumë fëmijë se ato të pasurat, kjo tani më dihet, por ekziston ajo dilema e madhe: Pse?

Kjo dukuri ekziston për shumë arsye, në disa raste mosarsimimi i çiftit, problemet e ndryshme mentale, mosgjetyja e mënyrave të tjera për qetësim. Çiftet në fjalë nuk kanë privilegje nga shoqëria, injorohen; në përgjithësi mungesa e kushteve ekonomike e "shkakton" këtë fenomen. Kurse të çiftet e pasura, arsyeja e mosbërjes së shumë fëmijëve është e kundërta e rastit

të parë. Studimet tregojnë se arsyeja pse të pasurit hezitojnë të bëjnë fëmijë janë kryesisht angazhimet e shumta profesionale dhe përkujdesja ndaj vetvetes. Po ashtu, nëse i adresohemi ndonjë përgjigjeje të mundshme, kujtoj, pa ndonjë analizë empirike, se do të duhej t'i adresohemi logjikës, e jo parametrave moralë. Është një thënie e njohur në popull se: "Kur të pasurit në mbrëmje numërojnë para, të varfrit bëjnë fëmijë". Mbijetesa e kësaj thënie popullore, në një farë mënyre, është jo një alibi, por më tepër një arsyetim moral sesa ekonomik e social. Arsyeja e vetme është se, tanimë, në kushtet dhe rrethanat e një procesi dinamik të ndryshimeve, logjika e "bërjes fëmijë" nuk është (ose të paktën nuk është duke u treguar në rastin e Kosovës) edhe aq profitabile?! Skamja po vazhdon edhe më tej. Për çudi, për dikë duket se është sukses! Ata që kanë pozita e privilegje po vazhdojnë të pasurohen, kurse ne si shoqëri, me parametrat ekonomikë që kemi, s'po mund të ecim me kohën, ose procesin e ndryshimeve marramendëse që po ndodhin në shoqërinë kosovare. Thënë më thjesht, ne nuk jemi të vetëdijshëm që, ata që na qeverisin nuk mendojnë ose mendojnë vetëm për vete, se pasuri e vërtetë nuk janë vetëm "paratë e numëruar në mbrëmje", por edhe "bërja e fëmijëve" është një domosdoshmëri që i duhet Kosovës në periudhën e ardhshme.

*(Autorja është gazetare e diplomuar.
Tash i vijon edhe studimet bachelor
në Sociologji në UP)*



Papunësia, sfidë për institucionet e Kosovës

Cilat janë gjasat për zbutjen e papunësisë?

Sipas statistikave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në Kosovë llogaritet se mbi 43 për qind e popullsisë është e papunë



Fatos SHALA

Gjendja sociale në Kosovë vazhdon të jetë një nga shqetësimet më të mëdha. Zhvillimi i ulët i ekonomisë po ndikon edhe në shkaljen e lartë të papunësisë. Autoritetet thonë se është shqetësues fakti se papunësia në Kosovë ka karakter afatgjatë, pasi të regjistruarit në zyrat e punësimit presin më shumë se një vit për një vend të lirë pune.

Statistikat e papunësisë

Mbi 330 mijë të papunë janë të regjistruar në zyrat e punësimit në mbarë Kosovën, ndërkaq mbi 25 mijë të papunë çdo vit hyjnë në tregun e punës, - thonë zyrtarë qeveritarë. Sipas shifrave zyrtare, 48 për qind e të regjistruarve janë femra, ndërkaq mbi 60 për qind e të regjistruarve si të papunë, i referohen nivelit të pakualifikuar.

Hafiz Leka, kryesues i divizionit të punësimit në kuadër të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, thotë se problem në këtë segment mbetet fakti se mbi 90 për qind e të regjistruarve presin më tepër se një vit për të gjetur një vend të lirë pune.

“Kohëzgjatja, kohë-pritja, mbi 12 muaj të këta persona është mbi 90 për qind, që është brengosëse edhe për ne. Ne, si ministri, jemi duke bërë përpjekje që përmes projekteve vendore, edhe nga donacionet ndërkombëtare dhe organizatat që na mbështesin, ta zbusim dhe ta shkurtojmë këtë kohëzgjatje të pritjes”, - thotë Leka.

Edhe ekspertët për çështje ekonomike, vlerësojnë se, në këtë aspekt, është shqetësues fakti që papunësia në Kosovë ka karakter afatgjatë.

Papunësisë i duhet dhënë zgjidhje

Muhamet Sadiku, profesor në

Fakultetin Ekonomik në Universitetin e Prishtinës, thotë se për këtë problem duhet gjetur një zgjidhje të shpejtë.

“Kosova ka trashëguar një nivel të papunësisë edhe nga e kaluara, mirëpo edhe brenda këtyre 10 vjetëve, do të thotë pas vitit 1999, situata ka mbetur e njëjtë”. “Vështruar nga situata dhe aspekte të ndryshme, papunësia në Kosovë ka karakter të theksuar afatgjatë, sepse 85 për qind e të gjithë të papunëve presin më shumë se një vit në zyrat e regjistrimit”, - pohon Sadiku.

Por, Hafiz Leka, thotë se karshi mundësive ekzistuese, angazhimet për zbutjen e këtij problemi janë të mëdha. Sipas tij, brenda një viti kjo ministri arin të punësojë deri në 6 mijë persona. Ndryshe, gjatë vitit të kaluar për një vend të lirë pune brenda muajit kanë konkurruar 581 të papunë.

“Ne arrijmë që brenda vitit t'i ndër-mjetësojmë për punësim 6 deri në 6.500 persona dhe t'i aftësojmë për treg pune mbi 3.500 punëkërkuar. Mirëpo, edhe e para, edhe e dyta nuk mjaftojnë. E para, nuk mjafton se brenda një viti mbi 25 mijë persona neve na hyjnë në treg të punës si punëkërkuar të rinj” - shpjegon Leka.

- Shkalla e papunësisë mund të zbutet vetëm me rritje të përgjithshme ekonomike, - thotë eksperti i ekonomisë, Muhamet Sadiku. Por, cila normë e rritjes ekonomike, sipas tij, duhet të jetë përgjigje për fillimin e zbutjes së

Kërkojnë punë në vende evropiane

Shumë të rinj po lënë gjithashtu vendet e tyre për të gjetur arsim të mirë, punë të paguar mjaftueshëm e për t'i hyrë një karriere. Kjo "ikje truri" në rajon po bëhet një problem pothuajse aq serioz sa vetë faktori i papunësisë. Në Kosovë, më tepër se gjysma e popullsisë së re po kërkon të emigrojë në Evropën Perëndimore, Shtetet e Bashkuara ose Kanada, me shpresën e gjetjes së një karriere. Studimet e Bankës Botërore gjetën se problemi i papunësisë së të rinjve mund të zgjidhet duke krijuar më shumë vende pune, të cilat kërkojnë një klimë më të mirë investimi. Pengesat kryesore ndaj investimit dhe rrjedhimisht krijimit të punës, janë rregullat e tepërta të tregut, pengesat administrative dhe taksat e larta. Në qoftë se vazhdojnë këto norma të larta papunësie, ato do të prekin dinamikën sociale e ekonomike në mënyra të mbrapshta, gjë që mund ta pengojnë hyrjen e rajonit në binarët e qëndrueshëm të zhvillimit ekonomik.

këtij problemi? “Kjo normë duhet të jetë mbi 6 për qind, që ky problem të fillojë të zbutet. Sepse çdo vit në treg të punës kemi rreth 30 mijë njerëz, të cilët kërkojnë punë për herë të parë”. “Ndërsa, në anën tjetër, ekonomia mezi mund t'i punësojë në vit 5 deri në 6 mijë persona. Kjo tregon se vetëm normat e larta të rritjes ekonomike mund të jenë përgjigje për fillimin e zbutjes së problemit të papunësisë”, - vlerëson Sadiku.

Rritja ekonomike 4.4%

Sipas parashikimeve të Qeverisë së Kosovës, deri në fund të këtij viti, Kosova do të ketë rritje ekonomike 4.4 për qind, përqindje kjo që për ekspertët e ekonomisë është e paralizueshme. Sidoqoftë, sipas statistikave të Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, në Kosovë llogaritet se mbi 43 për qind e popullsisë është e papunë. Krahas papunësisë, rrjedhimisht po rritet edhe shkalla e varfërisë. ■





Vetëvrasja – ndër patologjitë më të rënda të shoqërisë



Nexhmedin SHALA

Aktet e vetëvrasjes, pa dyshim, që janë ndër patologjitë më të rëndat të shoqërisë. Rastet e vetëvrasjes pas luftës, e sidomos kohëve të fundit, janë shumë të mëdha dhe si të tilla janë për t'u alarmuar.

Disa nga shkaqet që ndikojnë në një gjë të tillë janë të identifikuar. Ato janë: gjendja e vështirë socio-ekonomike, depresioni, gjendja shëndetësore, droga, paaftësia për t'i kaluar sfidat e jetës, etj. Por ka edhe faktorë të tjerë që i nxitin njerëzit për të bërë vetëvrasje. Faktor tjetër që nxit vetëvrasjen është edhe rasti kur njeriu dëbohet nga rrethi familjar dhe shoqëria, apo kur ka marrëdhënie tejet të ngushta me të tjerët, pra, kur është i lidhur fort me dikë dhe ajo lidhje i dështon, apo edhe kur nuk gjen asnjë rrugëdalje, as në vete e as te të tjerët, sepse gjithçka i duket e pamundur. Ka edhe shumë nxitës të tjerë që ndikojnë direkt deri te kjo patologji shoqërore.

Por çështja është se ka edhe faktorë të tjerë që, në mënyrë indirekte, i kontribuojnë fenomenit të vetëvrasjes.

Media si faktor indirekt që nxit vetëvrasjen!

Në mediet tona ky fenomen është mjaft i theksuar dhe shpeshherë marrim informacione për rastet e vetëvrasjeve e tentimvetëvrasjeve. Por problemi është se këto informacione nuk plasohen siç duhet dhe ngërthejnë në vete një problem që mund të rezultojë me pasoja në shtimin e vetëvrasjeve. Them kështu sepse informacionet që marrim janë shumë të detajizuara. P.sh. në shtypin tonë ditor, por edhe atë revyjal, japin informacione me të gjitha detajet se si ka ndodhur vetëvrasja, në ç'rrethana, me çfarë mjete është kryer, etj. Çështje më e keqja këto shkrime ilustrohen edhe me fotografi ku mund të shihet mjete me të cilin është kryer akti, p.sh. litari në vendin ku është kryer vetëvrasja, ose arma e drejtuar në kokë, foto me medikamente më të cilat viktima është vetëvrasë etj.

Akoma më problematik dhe më ndikues është televizori, që i jep sensacion shumë më të fuqishëm kësaj dukurie.

Sigurisht që kjo i ndihmon vetëvrasjeve, sepse tek personat që kanë probleme, depresione të mëdha, njerëzit që janë të mërzhitur nga realiteti i hidhur që jetojnë, nga gjendja e vështirë ekonomike, sociale etj., kjo mund të ndikojë dhe ata e marrin si të pranueshme, se njerëzit po i zgjidhkan problemet edhe në këtë mënyrë. Nga kjo, tërthorazi,

mund të themi se kjo u jep guxim atyre që luftojnë me veten, duke i shtyrë ata drejt fatkeqësisë! Pra, nga kjo del se akti i vetëvrasje është i mësuar (por sigurisht që media nuk është faktori i vetëm që ndikon në një mësim të tillë).

Si duhet ta trajtojnë mediat këtë fenomen?

Televizionet, radiot, gazetatat dhe të gjitha mjetet e informimit publik duhet t'u shmangen informacioneve të detajizuara. Duhet të kenë një vlerësim të mirëfilltë në mënyrë që mos të ketë protagonizëm negativ. Këto informacione doemos duhet të zëvendësohen me informacione që ngërthejnë në vete këshilla edukuese për tejkalimin e një situatë që çon te vetëvrasja.

Mediat duhet të kenë parasysh faktin se kur shkruajnë dhe japin informacione për vetëvrasjen, medoemos duhet të kenë të implikuar mendimin e ekspertëve që e nuhasin këtë problematikë, siç janë: sociologët, psikologët, psikiatrit etj., në mënyrë që të jepen mësim se si duhet tejkaluar kriza të tilla, e që të mos vihej deri te vetëvrasja. Dhe mendimi i tyre duhet të ngërthejë këshilla që japin sqarime se si të tejkalohet situata e vështirë, e jo vetëm në përshkrimin e shkaqeve se si ka ndodhur vetëvrasja.

Pra, këtu qëndron esenca e çështjes se mediat duhet t'i luftojnë dukuritë



negative, e jo vetëm t'i plasojnë informatat që janë shumë të dëmshme.

Si të parandalohet vetëvrasja?

Nga ana tjetër, rolin kryesor për parandalimin e kësaj dukurie duhet ta luajë qeveria e Kosovës. Ajo duhet të përpilojë plane dhe programe për parandalimin në mënyrë efektive të kësaj dukurie.

Duhet krijuar një bazë e qëndrueshme, ku duhet të përfshihen të gjitha të dhënat lidhur me sjelljet e vetëvrasjes. Në kuadër të këtij plani duhet të shërbejnë grupe shumëdisiplinare, duke i përfshirë në radhë të parë ekspertët që e nuhasin mirë këtë problematikë, si vendorët ashtu edhe ndërkombëtarët, organizatat joqeveritare, institucionet qeveritare, ministritë dhe institucionet publike.

Këta duhet të kontaktojnë me të gjitha rastet e tentimvetëvrasjeve ose edhe vetëdëmtimit. Duhet të bëhet vlerësimi dhe monitorimi i rregullt në suaza vjetore të të dhënave mbi sjelljet vetëvrasëse, pra statistikave, aspektit social, psikologjik të viktimave etj, të cilat do të ndihmonin në identifikimin e rasteve. Të organizohen mekanizma preventivë të shëndetit mendor. Duhet të hapen qendra trajnuese për mjekimin e këtyre rasteve.

Në këtë mënyrë mund të bëhet një studim i mirëfillt shkencor dhe të krijohen mekanizma preventivë për personat e rrezikuar.

Edhe një mënyrë tjetër që konsiderohet e dobishme për parandalimin e vetëvrasjes është vendosja e linjave telefonike për këshillime urgjente në qendra të punonjësve sociale. Por qendra të tilla,


fatkeqësisht, tek ne nuk ka fare.

Në qoftë se vazhdohet kështu, pa ndërmarrë kurrfarë masash, atëherë kjo dukuri do të mbetet vërtet një ndër më

shqetësueset.

(Autori është i diplomuar në fushën e Sociologjisë & Filozofisë dhe student i masterit në Gazetari dhe Komunikime Mediale)

FOTOLAJM



Armenda Tani, një 22-vjeçare nga fshati Rreth Greth (Kavajë), mbahet prej vitesh e lidhur me zinxhir në qafë nga prindërit, një dhomë të zhveshur dhe pa asnjë ndihmë ekonomiko-sociale

Rënia e murit të paragjykimeve

Shenasi XHELADINI

Më 8 dhjetor 1945, Gjermania e Adolf Hitlerit kapitulloi pa kushte. Pas përfundimit të luftës, fuqitë e mëdha vendosën ta ndajnë Gjermaninë në katër zona të veçanta pushtimi. Në po aq zona u nda edhe kryeqyteti. Demokracitë perëndimore: Shtetet e Bashkuara, Britania e Madhe dhe Franca i bashkuan tri zonat e tyre si dhe të tri pjesët e kryeqytetit, duke mundësuar kështu krijimin e Republikës Federale Gjermane me kryeqytet Berlinin Perëndimor. Nga ana tjetër, në zonën sovjetike të pushtimit, u formua Republika Demokratike Gjermane, në përbërje të të cilit ishte edhe Berlina Lindor. Bashkimi Sovjetik tregoi në pjesën e vet ashpërsinë e një shteti tipik bolshevik, duke u orvatur të bllokojë pjesën tjetër të qytetit, e cila nuk kishte komunikim përmes rrugëve tokësore me Republikën Federale Gjermane. Perëndimorët, më 7 tetor 1949, nxorën ligjin themelor për krijimin e Republikës Federale të Gjermanisë, i konceptuar si shtet kapitalist i një rendi demokratik. Si kundërveprim ndaj saj, sovjetikët krijuan më 7 tetor 1949 Republikën Demokratike Gjermane. Në orët e para të së dielës, 13 gusht 1961, policia e Gjermanisë Lindore dhe njësi të ushtrisë mbyllën kufirin, duke e ndarë Berlinin në dy sektorë. Ata shkatërruan rrugët përgjatë pjesës lindore të kufirit, duke i bërë ato të pakalueshme për makinat dhe vendosën tela me gjemba dhe gard-

torëve të Berlinit Perëndimor si dhe përgjatë 43 kilometrave që e ndanë qytetin dhe popullsinë e tij përgjysmë. Me kohë, ata i zëvendësuan telat me gjemba me një mur betoni 3.6 metra të lartë dhe 1.2 metra të gjerë; duke krijuar gati një perde të hekurt që për 28 vjet të ekzistencës së tij, ishte simboli më i dukshëm i Luftës së Ftohtë.

Bashkimi Sovjetik kishte mundur, në vitin 1945, të zotëronte gjysmën e shteteve të Evropës Lindore, duke vendosur në këto vende sistemin komunist, që bazohej në udhëheqjen e jetës politike nga një parti e vetme komuniste, privimin e lirive dhe të drejtave të njeriut, etj.

Evropa Lindore ishte socialiste dhe revolucioni kishte triumfuar në Vietnam, Kubë, Nikaragua, Grenadë dhe siç dukej edhe në Afganistan. Fitorja botërore e socializmit dukej vetëm çështje kohe. Por, në vitin 1983, SHBA-ja rrëzoi regjimin komunist në Grenadë, një ishull me 100,000 banorë. Ky veprim ishte përcjellë me përqeshje, por ai përfaqësoi herën e parë të zëvendësimit të një regjimi komunist. Kjo ishte pasuar me tërheqjen e BRSS-së nga Afganistani.

Marrëdhëniet midis dy blloqeve patën si pikë përleshjeje të afërt midis tyre pikërisht Berlinin. Baza e CIA-s për operacione në Berlin, në atë kohë, i trafikonte agjentët e vet në pjesën lindore të qytetit me një lehtësi relative, ndërsa KGB-ja përdorte si mbulesë refugjatët që kalonin në pjesën perëndimore të qytetit për të infiltruar spiunët e vet.

Për një kohë jo të vogël, i vetmi komunikim i Berlinit perëndimor me RFGJ-në ishte rruga ajrore. Ndërsa gjermanolindorët vërshonin në Berlinin Perëndimor mes

teve të përkeqësuar dhe frikës se kufiri do të mbyllej një ditë, lideri komunist në Gjermaninë Lindore, Walter Ulbricht deklaroi ngritjen e murit të famshëm, ku për vite të tëra u shkrua eksodi i mijëra njerëzve të plagosur dhe të vrarë që ngelën viktime në muret e tij. Dhe si rezultat, deri në vitin 1961, 3.5 milionë gjermano-lindorë, shumë prej tyre, njerëzit më të arsimuar të vendit, ikën për në Gjermaninë Perëndimore.

Pas fjalimit të Gorbaçovit në Bruksel, më 6 korrik 1989, ku përfshiheshin propozimet mbi çarmatosjen, nxitjen e idesë së një shtëpie të përbashkët evropiane dhe për të diskutuar për të drejtat e njeriut, më 9 nëntor 1989, muri ra. Viti 1989 i dha fund pjesës më të keqe të historisë evropiane. Ishte një rënie paqësore e "keqbërësve" të perandorisë sovjetike. Askush nuk e kishte parashikuar shembjen aq drastike. Pavarësisht se Muri i Berlinit binte në Berlin, ai u bë sinonim me përmasa botërore i shënimit të shembjes së tiranisë dhe të triumfit të demokracisë. Pas 11 muajsh, Gjermania Lindore dhe ajo Perëndimore u bashkuan në një shtet të vetëm. Ishte ky një moment dramatik.

Kështu njëherësh ra edhe muri i mosbesimit, muri i ndarjes e i izolimit. Dalëngadalë barriera që kishte mbajtur të ndara dy botë nisi të shkrejhej e zhdukej.

Shkatërrimi i muri të Berlinit vazhdon të mbetet edhe sot momenti më i rëndësishëm i jetës për shumë njerëz në mbarë botën. Ai u dha lirinë miliona njerëzve dhe i dha fund një epoke të rrezikshme konflikti, që e kërcënoi botën për vite me radhë me rrezikun e asgjësimit bërthamor.

Krahas liderit të atëhershëm sovjetik Mihajl Gorbaçov, edhe politikanët e mëdhenj gjermanë si



kancelari Helmut Kol si dhe zëvendës-kancelari dhe ministri i Punëve të Jashtme Hans Diritih Gensher, kanë meritën e madhe të këtij transformimi historik.

Mirëpo kjo ndodhi ishte befasi dhe surprizë edhe për optimistët më të mëdhenj. Kancelari i Gjermanisë Perëndimore, Helmut Khol, ishte aq i papërgatitur për këtë ngjarje, sa në ato orë vendimtare për gjithë Evropën ndodhej në një vizitë jashtë vendit.

Rënia e murit përveç fashitjes së luftës së ftohtë, solli edhe fundin e ideologjive. Përfundimi i Bashkimit Sovjetik, siç thotë edhe studimi i politologut amerikan Francis Fukuyama bëri të mundur "Fundin e historisë". Liberalizmi fitoi, pa u ndeshur me armë ushtarake, por veç me armë ekonomike e kulturore. Historia post-ideologjike kishte hapur një kapitull të ri në botën e qytetëruar.

Arsyet se përse u shemb komunizmi sovjetik ishin të shumta. Midis tyre, ishte edhe mosefikasiteti ekonomik që nxori në pah vetëm uri dhe njerëz pa veshmbathje, pastaj ishte propaganda përndjekëse dhe gënjeshtare, që oscilonte në një hendek midis teorisë dhe praktikës, midis të thënës në premtime dhe realizimit të saj.

Disa muaj para rënies së Murit të Berlinit, shkencëtari politik amerikan **Fransis Fukajama** kishte parashikuar jo vetëm fundin e Luftës së Ftohtë, por edhe të historisë si të tillë: d.m.th fundin e qëllimit të evolucionit ideologjik njerëzor. Sipas tij universalizimi i demokracisë perëndimore liberale del si formë përfundimtare e qeverisjes njerëzore.

Megjithatë doli se ai e kishte gabim, sikurse edhe të gjithë parashikuesit 'historicistë' para tij.

Rënia e murit i dha fund trans-

formimit të rëndësishëm të Kontinentit të vjetër. Është e vërtetë se ngjarja e 20 viteve më parë jo vetëm ndryshoi jetën e rreth 500 milionë njerëzve që ishin zhytur për dhjetëvjeçarë me radhë në varfëri, por ndihmoi në formësimin e situatave të tjera në botë. Muri i Berlinit dhe shembja e tij ishin edhe një nxitje e jashtëzakonshme për një botë më të integruar. Mirëpo,

konceptit 'terrorizëm', ose më mirë thënë atribuimin e pavend të tij. Prandaj është e nevojshme që krahas shembjes së mureve materiale, të shemben edhe muret ideore të stereotipeve e paragjytimeve.

Pas shembjes së murit të Berlinit, botën e kapluan konflikte të natyrave të ndryshme. Shpërthyen luftërat më

vdekjeprurëse botërore, duke u vlarë me dhjetëra miliona njerëz. Nga ana tjetër, "globalizmi", termi që nënkupton lëvizjen e lirë të mallrave, kapitalit, njerëzve në të gjithë globin, është shndërruar në parimin qeverisës të tregtisë. Madje-madje edhe globalizmi nuk është i zhveshur ideologjikisht, përkundrazi është ideologji e re 'pasideologjike'. Mirëpo duke u bazuar në përvojat nga komunizmi, bota do të duhej të nxirrte një përfitim, nëse janë kuptuar pasojat e tij. Evropa është në rrugë të mbarë të vazhdojë frymën që motivoi rrëzimin e murit të Berlinit. Ajo gradualisht po bashkohet. Më 1960, Bashkimi Evropian kishte vetëm 6 shtete, që kaluan në 15, më 2003 dhe sot në plot 27 vende. Pa rënien e atij muri s'do të mund të imagjinohej çlirimi i Kosovës, inkuadrimi i Shqipërisë në NATO dhe shumë procese të tjera demokratike. Procesi i liberalizimit të vizave, nga përfitojnë tani për tani Maqedonia, Serbia dhe Mali i Zi, me gjasë

së shpejti do t'i përfshijë edhe vendet e tjera. Parlamenti Evropian ka bërë thirrje që komisioni Evropian të nisë edhe me Kosovën një proces të ngjashëm të vizave, sikur e kanë shtetet e tjera të rajonit, duke kërkuar definimin e udhërrëfyesit, i cili do çonte fillimisht në lehtësimin e regjimit të vizave, e më pas edhe liberalizimin e plotë. Pra, Evropa e bashkuar mbetet një synim i vazhdueshëm për të cilin është duke u punuar. ■



bota, prapëseprapë, vazhdon të jetë e polarizuar. Studiuesi tjetër

Samuel H. Huntington paralajmëroi se pas periudhës pas-ideologjike, qytetërimet do të përplasen kryesisht për motive fetare. Ndarjet e reja që kanë dalë në pah kanë të bëjnë me nacionalizmin, fenë ose edhe thjesht "frikën nga tjetri". Duket se në këtë kontekst është tepruar me keqinterpretimin dhe vampirizmin e



Prof.dr. Naser RAMADANI

Simbolika e haxhit

konsiston te riti si rit, por te qëllimi që ngulitet në zemër.

Pastrimi i trupit para veshjes së ihramit na kujton larjen e kufomës. Urtësia nuk është vetëm për të qenë i pastër, por edhe për t'u përgatitur për një botë të përtejme. Parfumimi nuk do të thotë vetëm që të kemi aromë të mirë për ata që janë afër nesh, por që përzierja e llojeve të ndryshme të tyre, të na kujtojë erërat e këndshme të xhennetit. Pra, gjithçka bëhet për ta vendosur njeriun në tehtë të kësaj bote dhe botës së ardhshme.

Veshja e të gjithëve në ihram simbolizon gjithashtu edhe faktin se para Zotit të gjithë janë të barabartë. Kjo është thënë e stërthënë me mijëra herë, por, praktikisht, ky është i vetmi moment praktik që kjo dëshmohet në vepër. Askush nuk mund të dallojë të pasurin nga i varfri. Tavafi rreth Qabes nuk është vetëm një sjellje mekanike rutinore, por ai nënkupton përkushtimin për t'u afruar afër Shtëpisë së Zotit. Qabeja është epiqendra rreth së cilës rrotullohet bota e të devotshmëve.


Ecja e shpejtuar mes Safas dhe Mervas kujton vuajtjet e nënës së Ismailit për të gjetur ujë për vete dhe fëmijën e saj të sapolindur. Vrapimi nuk është vrapim maratone, por vrapim shpirtëror, sepse duke vrapuar, haxhiu metidon, mediton

për kthimin e vuajtjes në sublimim, në krenari.

Qëndrimi në Arafat është një pushim për meditim. Tërë ditën njeriu ka kohë t'i sjellë ndër mend të metat, mangësitë dhe dobësitë e tij, ashtu që të mendojë se si duhet t'i përmirësojë gradualisht të gjitha, një nga një. Aty haxhiu në vete duhet të zotohet për një fillim të ri. Ai tashmë e di rëndësinë e haxhit të pranuar që e kthen në tabula rasa, prandaj në atë pllakë të bardhë ai s'duhet të lejojë të shkruhen mëkatet e zeza. Për të shtohen përgjegjësitë dhe detyrat, sepse ai bëhet gati ta gjuajë gurin në vendin e quajtur Xhemarat në Mina. Është kjo simbolikë e dorëzimit të djallit përpara njeriut. Haxhiu duhet të dijë se qëndrimi në Arafat nënkupton pastrimin shpirtëror pas gjithë atyre riteve të kryera. Gjuajtja vjen në fund, sepse vetëm ai që është plotësisht i pastër, ashtu siç precizohet në hadith, ka të drejtë ta gjuajë atë që është më i fëlliqur. Vetëm në këtë mënyrë efekti do të ishte tamam me vend. Nuk ka të drejtë ai që vetë është i papastër ta gjuajë të papastrin, prandaj lypset kaluar nëpër të gjitha ritet e tjera për të ardhur te e fundit, në Mina. Aty derdhet lumi i haxhilerëve për t'u përballur më djallin, i cili ka zënë pritë. Haxhilerët mobilizohen. Mbledhin gurët, të cilët metaforikisht mund të

Haxhi shënohet si një ndër momentet më të rëndësishme në kalendarin islam. Përpos se është obligim fetar, haxhi karakterizohet edhe nga rëndësia e tij e veçantë në përcjelljen e mesazheve edhe për ata që nuk e konsiderojnë si të tillë, pra, edhe për botën joislame. Domethënia e haxhit si ceremoni religjioze shtrihet në simbolikat e tij. Për t'i trajtuar secilën veç e veç, është një tematikë e gjerë, por ne do të ndalemi vetëm në disa prej tyre. Është fakt se disa simbolika të haxhit mund të keqkuptohen, të keqinterpretohen dhe bile-bile edhe të duken paradoksale për ata që nuk kanë njohuri elementare islame.

Ihrami si obligim i parë për haxhin, që kur e vesh, e paralajmëron haxhiun në mënyrë implicite se ka hyrë në një botë tjetër, në një botë e cila ngjason me atë të të vdekurit. Në këtë rast, dallimi është se i gjalli me mendje e zemër i afrohet të vdekurit. Po ashtu, haxhiut i ndalohen disa gjëra, të cilat po të mos ishte në ihram, do t'i kishte të lejuara. E bardha bëhet kufi që jo vetëm përkujton, por edhe ndal. Duke parafrazuar Ibën Tejmijen themi se thelbi i ndalesave nuk



jenë edhe më të tmerrshme për djallin sesa bombat e dorës. Xhemarat në Mina simbolizon pritën e djallit. Ai mundohet që t'ua bëjë njerëzve jetën ferr. Të gjitha përpjekjet që bëjnë në jetën e përditshme mundohet t'ua hedhë në ujë, duke i catur në gabime e mëkate. Simbolika flet se edhe në Mina ka dalë në pritë për t'i mashtruar haxhilerët me dredhitë e tij. Aty, metaforikisht, zhvillohet luftë, lufta përfundimtare ndërmjet të mirës dhe të keqes. Haxhilerët mobilizohen (marrin gurët), kurse djalli ndodhet i mbështetur e i lidhur, s'ka nga t'ia mbajë. Ai del për të realizuar qëllimin e tij, por e pret ushtria e madhe e Zotit. Përballë kësaj ushtrie ai ndihet i vetmuar, i përburzur, i vogël dhe i shkatërruar. Haxhilerët i hakmerren djallit për të gjitha të zezat e tij, duke filluar prej mashtrimit të njeriut të parë Ademit (alejhi selam). Gurët e godasin si granatat, kurse nënçmimi i tij shënon këtu kulmin deri në Ditën e Gjykimit. Haxhilerët gjuajnë duke ia bërë me dije djallit se Zoti është më i madhi....

Pastaj fillon festa. Haxhilerët përqafohen mes vete. Ata urojnë njëri-tjetrit për fitoren e madhe: mposhtjen e djallit dhe përfundimin e një obligimi ndaj Zotit. Haxhi për haxhiun është simbol i përkushtimit ndaj Zotit. Niset për të kryer një obligim, por ndeshet me të keqen dhe atë duhet ta luftojë. Prandaj në njëfarë mënyre haxhi ngjason me xhihadin.

Shikuar në tërësi, haxhi është simbolikë. Ai flet dhe demonstron përmes simboleve. Simbolet kanë domethënie, prandaj ato duhen kuptuar si shenja të Zotit për t'u afruar tek Ai. ■

Thirrje publike për

Senad RAMADANI


Vërtet njerëzit janë të ngutshëm, pastaj edhe të dobët... Të dobësuar i bën momenti i pakëndshëm, ndonjë rast kur ua prish diçka terezinë... Mendojnë se gjithçka duhet të shkojë sipas planifikimeve të tyre... dhe...kur rastësisht s'bëhet ashtu, atëherë ata tendosen dhe tërhiqen... Përgatisin reagime...herë të forta e herë të buta. Realisht besoj se fshehja pas formulimeve metaforike për të demonstruar pakënaqësitë individuale dhe të ngushta publikisht, është një tentativë për të mbjellë defetizëm. Ideja se e mira afërsisht absolute qenka rrëkatur vetëm diku në skaje të disa zemrave të sinqerta, se të tjerët që në këtë rast janë shumica i janë ekspozuar formaliteteve etj., është mendim me të cilin nuk ia vlen të merresh.

Njerëzit janë të obliguar për mirësi,

por mirësia nuk është një kategori për të cilën vetëm dikush mund të ketë kritere për ta vlerësuar. Në një shkrim patetik të publikuar është thënë se të disa muslimanë kanë mbetur vetëm disa formalitete, të cilat nuk ndikojnë në përmirësimin e shpirtërores. Kjo vret për faktin se e vë gjithkënd përballë dilemave hipotetike: edhe atë me pa të drejtë, sepse dikush merr guximin për të gjeneralizuar një fenomen të caktuar që për më tepër mund të jetë i izoluar. Një rast, çfarëdo që të jetë ai, s'mund të merret për model, por vetëm si përjashtim dhe si i tillë duhet trajtuar e vlerësuar.

Së këtëjmi, optika prej ku gjërat vihen për t'u vështruar më me refleksion duhet paraprakisht t'i ndriçojë mendjet, ashtu që ato të mos jenë të eklipsuara përpara se të hidhen shkronjat në letër... për t'u bërë më pastaj zi mendimi... kuptimi dhe në tërësi i gjithë diskursi mbi realen dhe jorealën.

Mu për këtë e rëndësishme është që pas çdo



dëshpërim

pezmatimi, që mund të pësojmë si qenie njerëzore, t'i lëmë pak emocionet të pushojnë, të kthjellohemi dhe t'i vëmë gjërat në peshojë.

Dëshira për ta manifestuar me çdo kusht pezmin sa më shpejt që të jetë e mundshme është në kundërshtim me arsyen e shëndoshë. Madje harrohet se të shkruarit është akt më i zorshëm se të shtënit me armë... Në rastin e parë fjala vret me shumë se ç'mund të mbysë plumbi... E çështje më e keqja vret mendje...shpirtra...vret ideale...

Pikërisht, për këtë, çdonjëri duhet ta ketë parasysh ...se mesazhet nuk përcillen në forma dëshpëruese, sepse ato veçqë pushojnë të bartin peshën e mesazhit... Në fakt, ato bëhen thirrje publike për dëshpërim...

E di se me stil mjeshhtërie është synuar që një situatë e caktuar të hidhet në një rrafsh alegorik, duke u treguar herë konkret e herë abstrakt,

por anonimi është dashur ta dijë se gjithçka që vlerësohet si ok nga një individ, nuk

është OK e madhe për të gjithë, prandaj paraprakisht lypset konsultuar... Dhe kur një i vetëm thotë se diçka nuk është në rregull, atëherë gjithçka duhet të fillojë të shqyrtohet nga e para.

Megjithatë, si duket, vetëpreferenca për t'i mbivlerësuar afektet momentale si vërtetësi absolute është kriter mbi të gjitha.

Dhe kur veprohet në këtë mënyrë gabimet janë të pashmangshme.

Sado sublim të jetë një rast, që njeriu mendon se dikush i ka hyrë në hak, ose i ka hipur mbi qafë, prapëseprapë nuk e justifikon shkaktimin e një paranoje të përgjithshme obsesive se 'krisi' Kiameti, në stilin e përrallës 'kur iu dogj dhelprës bishti'. Muslimani duhet të mësohet edhe të gëlltisë për hir të së mirës së përgjithshme, e jo atë të mirë ta vërë nën interesin e tij të ngushtë. Kjo përkon me hadithin ku porositemi që të metat e vëllait t'i mbajmë në vete, e jo t'i publikojmë. Publikimi i atij lloji, duke përfshirë edhe përgjithësimin si tipar të veçantë, s'është veçse thirrje publike për dëshpërim dhe asgjë tjetër. Zaten kjo është edhe në frymën e asaj që pretendohet se është thelbi i shkrimit 'Forma dhe Përmbajtja': përsosja e shpirtërores sa më shumë që të jetë e mundshme. E kjo nuk mund të arrihet nga ata njerëz që nxisin situata që pashmangshmërisht janë të dëmshme. ■



Venitja e nocionit SHK



Iljasa SALIHU

Kur shkruajmë dhe lexojmë për shkollën, si një institucion arsimor ku mësohen dhe edukohen në mënyrë të organizuar brezat e rinj, pa dyshim se ndihemi të emocionuar, aq më keq kur nga domosdoshmëria detyrohemi të kritikojmë veprime që ndodhin brenda shkollës. Ndhemi të emocionuar, sepse me ndihmën e shkollës dhe mësuesve, unë dhe ju lexues, kemi arritur të shkruajmë dhe lexojmë. Prej kohësh, sidomos ne shqiptarët kemi qenë të diskriminuar për ta shijuar oazën ku merret dituria dhe ku promovohen vlerat morale. U flijuan shumë shqiptarë për krijim e mundësive për shkolim, për mësimin në gjuhën shqipe dhe pastaj për kushte infrastrukturore më të mira në objektet ku mbahet mësimi. Stërgjyshërit, gjyshërit, baballarët tanë e arritën me mund e sakrificë këtë ëndërr të kamotshme, duke e dhënë edhe jetën si shkëmbim të kësaj begatie. Kurse ne pasardhësit e tyre, për një kohë


shumë të shkurtër, fare pa përgjegjësi filluam ta rrënojmë këtë begati. Por, ky rrënim po bëhet me ndihmën e të "dëshpëruarve" nga rrogat mjaft të ulëta. Epiteti ose domethënia e shkollës si institucion edukativo-arsimor, ka filluar të zbehet dhe ta humbasë kuptimin e saj natyral. Rrënimi i këtij institucioni, filloi prej themeleve. Pra, ata të cilët, të ashtuquajtur "mësues të rinj" që po e marrin mësimin prej disa fakulteteve të dyshimta pedagogjike, dukshëm janë duke e rrezikuar ardhmërinë e pasardhësve dhe të shkollave. Të ashtuquajturit "mësuesit e vjetër" shprehin një brengë serioze dhe një dyshim për edukimin e gjeneratave të ardhshme nga produkti i këtyre "fakulteteve", të cilët në analogjinë e tyre manifestojnë një helmim të gjeneratave, por kësaj radhe me metoda mjaft perfide. Pse e përmenda konkretisht, Fakultetin Pedagogjik? Sepse, fati i gjeneratave të mëtutjeshme varet pikërisht nga këta. Fëmija, si letër e bardhë, gërvishtjet, ngjyrosjet dhe mbushjet e para do t'i përjetojë prej mësuesit. Aktualisht, nuk bënë të habitemi se pse një nxënës i klasës së tetë ende nuk e ka të qartë se kush është kryeqyteti i Shqipërisë dhe me kënd kufizohet Kosova! Fatkeqësisht edhe më keq, aktualisht dëgjojmë nga

prindërit fjalë mjaft dëshpëruese. Ja njëri prej prindërve çka na rrëfen: "Djali im ishte mjaft i edukuar dhe i kulturuar. Kjo zgjati derisa doli në klasën e pestë. Në shkollë filloi të çoroditet, ta marrë të mbrapshtën dhe me daljen në shkollë të mesme përfundimisht, nuk mbeti djali im, por djali i kafeve, i bandave, i duhanit, e i të gjitha veseve të këqija, të cilat nuk i takojnë një njeriu të thjeshtë". Me të vërtetë ky rrëfim është tejet rrëqethës, tejet dëshpërues, është rrëfim vaji, është rrëfim absurditeti. Në vend se fëmija të edukohet dhe arsimohet në shkollë, këtu te ne po ndodh e kundërta. Në shkollat e mesme shqipe shohim një anarki totale. Në njërin anë, probleme me lokalet e zhvillimit të mësimin, në anën tjetër arroganca e nxënësve dhe, një anë tjetër jo aq e dukshme, dëshpërimi i profesorëve i fshehur nën vellon e kualifikimit dhe përgatitjes mjaft të dobët (të disa profesorëve). Gjenerata të tëra dalin me probleme të shumta. Diskutimet vazhdojnë për zgjidhjen e problemeve që tangojnë arsimin shqip. Paralelisht me diskutimet vazhdojnë edhe degradimet e nxënësve. Ministri i Arsimit ndihet i rehabilituar dhe i arsyetuar nga ky problem, sepse sikur



KOLLË!

dëshiron të na thotë: po ju shqiptarët i patët dy ministra të arsimit shqiptar! Por, tash ne sikur dëshirojmë t'i themi këtij ministri, dy ministrat shqiptarë veç sa e thelluan problemin, sepse zgjidhja e problemit mbështetet në formula partiake. Kurse ju shiheni qartë, se zgjidhjen e këtij problemi të trashëguar dëshironi ta zgjidhni me anë të formulave nacionaliste (edhe më keq se ato partiake). Aq më keq, edhe mësimbesimi fetar u anulua në këto shkolla, që ishte e vetmja shpresë për rimëkëmbjen e vlerave të mirëfillta morale. Dëmtimi i interesave vitale nga ana e shtetit ende vazhdon. Në të kaluarën shteti u kundërvijej me dhunë atyre të cilët kërkonin shkolla. Kurse tash, për hir të epitetit "shtet demokratik", shteti këtë dëmtim po e bën në mënyrë demokratike, në bashkëpunim me disa përgjegjës shqiptarë, duke i lënë nxënësit shqiptarë, tashmë të "përdhosur" në mëshirë të kohës, buzë asfaltit, në konflikt ndërmjet vete, në mos intervenim të policisë në rast përleshje, përzierjen e partive politike



Shkolla dikur

nëpër shkolla, si dhe gjithçka tjetër, përpos mësimin dhe edukimit. Ne do të ishim pak më rehat, sikur problemet në fjalë t'i kishin pushtuar vetëm hapësirat tona, por prej një sëmundje të këtyllë, vuan edhe shteti i posabërë, pra, Kosova. Tek ne e anuluan mësimbesimin fetar, por në Kosovë as që lejohet të bëhet fjalë për një gjë të tillë. Hajde pastaj, e të mos kukasim për de-

gradim të tërësishëm të vlerave morale!

Pra, për aq kohë sa do të vazhdojë të mbretërojë kjo gjendje kaotike nëpër këto institucione, atëherë ky institucion nuk do të quhet institucion edukativo-arsimor, por prishje e brezit të ri në mënyrë institucionale. ■





Profesorët po dëshmojnë papërgjegjësi ndaj ardhmërisë së Kosovës

Profesorë, pagat u rritën! Hajdeni!!!



Dukagjin AVDYLI

Ubënë dhjetë vite që prej pasluftës dhe që atëherë e deri tani profesorët kanë pasur mbështetje nga të gjitha shtresat popullore dhe nga studentët, të cilët gjithmonë kanë qenë për një trajtim më të dinjitetshëm të mësimit, e në sajë të kësaj edhe për rritjen e pagave të tyre. Sa herë që flitej për këtë temë, automatikisht, na ngriheshin nervat dhe fillonim të shprehnim indignatën tonë për qeveritë që shkuan dhe asaj që është tani se pse nuk po ua jepnin “hakun” profesorëve dhe nuk po ia dinë vlerën arsimit.

Mendonim se rritja e pagave të profesorëve ishte formula për daljen nga kjo amulli në fushën e dijes dhe çelësi i prosperitetit dhe zhvillimit të këtij vendi. Dhe si rrjedhojë e kësaj, Kosova do të ngrihej në një nivel më të kënaqshëm të dijes. Pas kësaj ngritjeje, do të na jepet mundësia t’i plasonim vlerat tona në rajon dhe botë; vlera të cilat akoma nuk ka kush t’i shfaqë jashtë kufijve tanë, për shkak të nivelit të ulët të dijes në vendin tonë.

Ishte kjo pengesa, ndoshta kryesore, që ne e perceptonim si të tillë, duke menduar që me rritjen e pagave profesorët do të motivoheshin më shumë për mësimit ose së paku do të vinin në ligjëratat, për të cilat tani po i marrin 1.000 euro. Pagat u rritën dhe kur them u rritën e kam fjalën në veçanti për pagat e profesorëve universitarë, por rezultatet nuk po shihen. Dhe në vend të ndryshimeve për të mirë po del në pah një problem tjetër, për të cilin nuk mund t’ia hedhim prapë fajin qeverisë aktuale. Paraprakisht, dua të kërkoj falje ndaj atyre profesorëve që kanë qenë dhe janë korrektë ndaj studentëve, si para ashtu edhe pas rritjes së pagave. Por, disa profesorë, edhe përkundër rritjes së pagave, sikur nuk e kanë vërejtur që në llogarinë e tyre bankare janë shtuar edhe 500 euro të tjera dhe po vazhdojnë avazin e vjetër të mosrespektimit dhe mospërgjegjshmërisë ndaj studentëve dhe mospërgatitjes së nevojshme të tyre për mësimit. Me këtë “mospërgjegjshmëri” ndaj të ardhmës së Kosovës, ata po shkelin mbi dinjitetin e studentëve dhe të këtij vendi dhe me këtë po manifestojnë një grykësi gllabëruese. Këtë mund ta argumentojmë me faktin që këta profesorë kanë uzurpuar 5 a 6 funksione, e që asnjërit nuk po i dalin zot si duhet. Tanimë edhe fëmijët po e

dinë që këtu nuk bëhet fjalë për drejtësi e as patriotizëm, por janë në pyetje deri në dhjetë mijë euro në muaj. Çfarë patriotizmi e atdhedashurie është kjo, kur një njeri ka pesë vende pune, ndërkaq një tjetër nuk ka asnjë të vetëm. Po na shqyhen gojë nga “atdhedashuria” dhe “patriotizmi” e nga fjalët e mëdha çdonjërit prej nesh që po i jepet mundësia të dalë para mikrofonit.

Por disa profesorë nuk po përmirësohen dhe nuk po skuqen fare nga ne, e sidomos ata të Fakultetit Juridik, programi master, edhe pas ngritjes së pagave. Vetëm brenda këtyre dy javëve nuk janë mbajtur as gjysma e ligjëratave të parapara me orar, në Fakultetin Juridik-Master në drejtimin ndërkombëtar. Prandaj do të donim që të ketë ndryshim rrënjësor të qasjes ndaj studentëve. Në të kundërt, për ta nxjerrë veten faqebardhë, Rektorati duhet t’ua kushtëzojë atyre ose të japin mësim në UP ose t’i mbajnë postet e tjera, në mënyrë që studenti të mbetet mos gjysmak për “hatër” të interesave vetjake të atyre që nuk po lodhen për asgjë tjetër, përveçse për xhepat e tyre të majmë. ■

(Autori është në studimet postdiplomike në Fakultetin Juridik - Master, drejtimi ndërkombëtar.)



Dr. Hatixhe AHMEDI

Komuna e Preshevës ka një sipërfaqe prej 264 km². Në aspektin demografik, Lugina e Preshevës banohet nga shqiptarë të besimit islam (Presheva 95%, Bujanoci 63% dhe Medvegja 22%). Në të jetojnë 35-40.000 banorë. Shumica e tyre - mbi 90% - janë shqiptarë. Të tjerët janë serbë, romë dhe turq. Në këto regjistrime, Lugina e Preshevës është pjesë e Vilajetit të Kosovës.

Në periudhat e luftërave ballkanike, popullsia e Preshevës përjetoj të njëjtin fat si çdo pjesë tjetër e popullatës shqiptare-islame. Ajo vazhdimisht ishte e përndjekur, e shtypur dhe e asgjësuar fizikisht nga sllavët.

Presheva ka një të kaluar të lashtë dhe të bujshme. Në bazë të burimeve të shumta historike, nëpër këtë Luginë kanë kaluar kultura dhe civilizime të

Presheva ndër vite



ndryshme nga periudha antike, romake, Perandoria Osmane, mbretëria serbe etj.

Nëpër etapa të ndryshme, qyteti është quajtur varësisht prej sunduesve. Kur ishin serbët dhe bullgarët quhej *Prešovo*, ndërsa gjatë Perandorisë Osmane *Prešova*. Profesor dr. Skënder Rizaj shpjegon burimin e emrit të

Preshevës që formohet nga dy emra *PRESH-Purri* në gjuhën shqipe dhe *OVA-fushë* në gjuhën turke, që në përkthim të saktë del *Fushë Purrinjsh*. Në periudhën e sundimit osman, Kazaja e Preshevës ishte pjesë e Kadillukut të Vranjës, bile në territorin e saj jetoi mbesa e sulltan Pajazitit, e quajtur Ajnishah "Mulk". Emri i Preshevës

Presheva



gjer më tani është gjetur në regjistrimet turke si p.sh. në dokumentet e viteve 1518-1528, e kështu me radhë.

Në Preshevë aktualisht ndodhen tri xhami: xhamia e "Ibrahim Pashës", ose ajo e quajtur "Atik Xhamii", të cilën e ndërtoi Ibrahim Pasha, pastaj xhamia tjetër "Xhamiul xhedidë" që do të thotë "Xhamia e re". Po ashtu, në Preshevë gjendej edhe hani, hamami i Preshevës, pastaj gjendeshin një numër i madh çezmash duke filluar nga "Çeshmja e Alimetëve", pastaj "Çeshmeja e Dodallarëve". Ajo posedonte edhe një urë... dhe Tyrben- Teqen e quajtur "Teqeja e Sheh Maksudit", e cila gjendet edhe tani në afërsi, ose në oborrin e xhamisë "Ibrahim Pasha". Në pllakatin hyrës të xhamisë, në gjuhën osmane, shkruhet kështu:

Presheva



“İBRAHİM PAŞA İSKENDER MEQİN
YAPTİ BU CAMİYİ GAYETTE METİN
KILA BARİ ANİ DAREJN DE AZİZ
OLA MEKAMİ E’LAİ İLLİYYİN
OKUYUP TARİHİ YA MU’MİNİN
FED’HULUHA Bİ SELAMİN AMİNİN”

“İBRAHİM PASHA I SHKODRËS
E NDËRTOI KËTË XHAMI SHUMË TË QËNDRUESHME (SHUMË
TË FORTË)
ALLAHU LE TA BËJË NË TË DY BOTËT TË SHENJTË
VENDI I TIJ LE TË JETË NË VENDET ME TË LARTA TË XHENETIT
(MEKAMI ILLIYYINË)

DUKE E LEXUAR KËTË HISTORI- O BESIMTARË!
HYNI NË TË, TË SHPËTUAR (PREJ ÇDO TË KEQEJE) TË SIGURU-
AR (NGA VDEKJA).”

Presheva, po ashtu, njihet edhe si një vend në të cilin kanë jetuar dijetarë (alimë), të cilët kanë punuar shumë për ruajtjen e vlerave islame dhe shqiptare, andaj edhe falë lutjeve (duave) dhe veprave të tyre ky vend gjithëherë ka qenë i mbrojtur nga mizoritë që përjetuan. Presheva njihet edhe me sloganin "Sherri i Preshevës në derë të Stambollit". Sikurse në çdo vend tjetër edhe në këtë vend ekzistojnë besëtytni të shumta si p.sh: "nuk bën të hash bukë në kohën e ezanit të akshamit sepse të vdes nëna" ose "nuk lejohet të priten thonjtë e duarve dhe të këmbëve menjëherë se ndodhin dy vdekje", etj. Po ashtu, për këtë qytet janë thurur edhe shumë këngë, si p.sh:

"Yandi Kumanova, tutshti Preshova". Po ashtu, ky qytet ka edhe llogape të ndryshme si: "sallata Presheva". Në Preshevë çmohet shumë folklori dhe lojërat e ndryshme të këtij vendi. Këto janë lojërat ose horat e Preshevës: "hora Llojani". Gjithashtu, në popullatë dëgjohej kënga në gjuhën turke "Yandi Kumanova, tutşti Preşova". Kjo këngë këndohej edhe nëpër hora të ndryshme. Në Preshevë kanë dalë edhe shumë njerëz të shquar si p.sh.: Myftiu Mulla Ejub ef. Mustafa, Hafëz Ali Rexhai Ahmedi, Myderris Hafëz Nexhati ef. Ahmedi, diplomatin Imam- Hafëz Lutfi ef. Ahmedi, Abdulla Krashnica, Qenan Evren, ish kryetar i Republikës së Turqisë, Shaip Mustafa, Selami Hal-

laçi, Tefik Selimi, Qemal Shehu, Hafëz Jusuf Haliti ".....". Presheva dikur shtrihej nga kisha e qytetit deri te fusha e Llapincës, por tani ka një zgjerim shumë të madh. Në të kaluarën, në këtë qytet ishin prezent shtëpi me stil osman si shtëpia e "Alush Shehut, pastaj ajo e "Esat Agës". Këto shtëpi ishin ndërtuar me tavane të zbukuruar me dërrasa, ishin të shtruara me minder dhe hasra, ishin me mure të ndërtuara me tulla dhe shavar, po ashtu ato posedonin edhe jahat dhe banja (hamamllëk), aneks (izbe) dhe kuzhinë (oxhakun) ku përgatitej gjella. Ballkoni dhe çardaku ishin të rrethuara me gilinderë prej druri. Oborret e tyre ishin të shtruara me gurë të mëdhenj, ndërsa në hyrje ishte çezma. Vërtet ato ishin shtëpi antike. Sikurse e cituam edhe më parë, këto shtëpi kishin dhoma të veçanta për verë dhe dimër. Në mesin e këtij qyteti rrjedh lumi i Moravicës. Dikur, në pjesën malore të qytetit, ishte edhe një pishinë ku freskoheshin qytetarët gjatë verës. Po ashtu, qytetarët kishin edhe kasollet e tyre në malet e Karadakut, në të cilat shkonin për gjueti dhe për mbledhjen e drunjve. Nëse dikush do ta kishte vizituar, para pesëmbëdhjetë vitesh, shtëpinë antike të Haxhi Alush Shehut, do të kishte një përshtypje më të mirë për përshtypjen e një shtëpie antike me stil osman. Por edhe shumica e qytetarëve të këtij qyteti posedonin dhe kishin jetuar në një rregull dhe rend të tillë shtëpiak. ■

Ndërtimi i harmonisë familjare



Mirsad KUTELI

Ne në jetën tonë kryejmë aktivitete të ndryshme, si puna, udhëtimet, vizita të ndryshme, por së fundi kthehemi dhe gjejmë prehje në shtëpi. Andaj, shtëpia është një pushim si fizik ashtu edhe psikik për njeriun. Mirëpo se sa relaksuese është ajo, në një masë të madhe, varet nga raportet që kemi krijuar përbrenda familjes. Ngase, nëse nuk ekziston harmonia familjare, njeriu edhe pas angazhimeve të mëdha, nuk do të dëshironte të kthehej në shtëpi, nëse nuk gjen kënaqësi aty.

Për martesën shpeshherë është thënë se është si një kafaz i artë, ku dëshirojnë të hyjnë të gjithë ata që janë jashtë, por që njëkohësisht dëshirojnë të dalin ata, të cilët gjenden brenda tij. Edhe në jetën tonë të përditshme kemi momente të caktuara kur duam të largohemi nga një

realitet që na rrethon, por nuk mund të ikim nga vetvetja. Nganjëherë jeta jonë nuk shkon ashtu siç bëjmë plane ne. Para ca kohësh, një mik i imi që ishte në kohën e pjekurisë dhe kishte pasuri të mjaftueshme më tha se nuk dëshironte të martohej para se t'i përmbushte planet e tij në karrierë dhe ta shijonte jetën e tij, ndërsa për martesën thoshte sa ka kohë. Përgjigja ime ishte e shkurtër: çdo gjë duhet bërë në kohën e duhur dhe në vendin e duhur.

T'i hysh një rruge, duhet t'i dalësh deri në fund, për shkak se vetë jeta jonë është një rrugëtim që e kemi trashëguar dhe që duhet të krijojmë një vijimësi për brezat që vijnë. Andaj, nëse ne e braktisim këtë rrugë, kjo nënkupton papërgjegjësi shoqërore dhe krijimin e një vesi perfid të egoizmit. Prandaj, jeta do të ketë premisa shqetësuese dhe shturëse.

Martesa të bën të mendosh mbase edhe për gjërat e vogla, të cilat nuk ke mundur t'i vëresh më përpara. Andaj duhet të jemi mirënjohës qoftë edhe për gjërat e vockla që mund të kenë kup-

tim të madh. Duhet një përkushtim, si fizik ashtu edhe shpirtëror ndaj familjes, duke ndarë koha me ta, si gjëja më e çmueshme dhe e pakthyeshme.

Përderisa nuk ka njeri të përkryer, nuk mund të ketë as edhe lidhje martesore të përkryer, ngase edhe martesa, sikurse shoqëria njerëzore përbëhet nga individët. Andaj, ajo është e tillë ashtu sikurse karakteret, sjelljet dhe morali i personave.

Shoqëria njerëzore është strukturë e përbërë nga individët dhe realiteti i një vendi është konsekuencë e veprimeve të individëve të asaj shoqërie

Ne shpeshherë dorëzohemi para problemeve pa provuar të ballafaqohemi dhe të përpiqemi që t'i zgjidhim ato, me arsyetimin se si individ nuk mund të arrijmë të bëjmë ndryshime. Mirëpo, realiteti duhet të jetë kontravers. Shoqëria njerëzore është strukturë e përbërë nga individët dhe realiteti i një vendi është konsekuencë e veprimeve të





individëve të asaj shoqërie. Një filozof thoshte: “Nuk ka asgjë të zorshme sa të mos gjendet me të kërkuar”.

Na ka ndodhur që ne nuk u kushtojmë vëmendje ndjenjave të tjerëve dhe veprojmë bazuar vetëm në gjendjen tonë momentale. Po ashtu, dëshirojmë që t'i shpalojmë vetëm çështjet tona dhe harrojmë fare ta dëgjojmë tjetrin dhe madje nuk kemi durim ta dëgjojmë deri në fund. Atëherë, shtrohet pyetja, si do të arrijmë ta kuptojmë tjetrin, qoftë partnerin/partneren, fëmijën, mikun dhe të tjerët? Me këtë nuk dua të vë në pikëpyetje veten tonë, por dua të theksoj se nuk ecët vetëm rrugës së jetës, ngase vetë jeta, e sidomos ajo familjare është e organizuar mbi baza reciproke. Problemet, që në shikim të parë duken të vogla, i kanë konsekuencat e tyre negative. Këtu vlen të theksohet se para luftës së fundit në Kosovë, numri i divorceve ishte minimal, ndërkaq në kohën e pasluftës numri i divorceve është tepër alarmant. Atëherë, duhet ta pyesim vetveten se ku qëndron problemi? Kur dihet mirëfilli se lidhja martesore në strukturën familjare është shtylla kryesore për mbajtjen gjallë të shoqërisë njerëzore.

Duhen ndihmuar të tjerët dhe duhet të kërkosh ndihmë nga tjerët. Kjo na

duket interesante. Merrni vetëm një shembull: sa e sa përpjekje bëjnë prindërit që t'i ndihmojnë fëmijët e tyre, madje edhe që t'u mësojnë se si të hanë, të pinë, të ecin, e shumë gjëra të tjera. Mirëpo, kur ata të plaken, ndoshta, do të kenë nevojën e po atyre fëmijëve që t'i ndihmojnë pothuajse për të njëjtat gjëra. Kështu, ndajeni një pjesë të kohës suaj për përkushtimin ndaj të tjerëve dhe atë bëjeni me dashuri dhe besim. Pa dyshim, se e mira do t'u kthehet në një mënyrë a tjetër. Vetëm në këtë mënyrë do t'i ruajmë, si shoqëri, vlerat tona të mirëfillta. Kjo për faktin se ne po marrim pa seleksionim çdo gjë që po na servohet. Mënyra e jetës moderne është shumë e hapur dhe me qasje mbase në tërë globin përmes rrjetit ndërkombëtar të quajtur ‘internet’. Interneti tashmë ka kapluar edhe shoqëritë më konservative dhe po shkakton ndryshime të mëdha. Andaj, në këtë drejtim, duhet të jemi të kujdesshëm që t'i ruajmë traditat, edukatën dhe kulturën autentike të familjes shqiptare, ta pasurojmë atë me kulturë më të mirë aty ku ka mungesa, t'i largojmë vetitë e këqija dhe të mos lejojmë të futen elemente negative që do ta prishin rrënjën dhe strukturën e saj. ■

Përse historia

Pavarësisht se femrat i kanë intriguar artistët e mëdhenj të artit, një kthim prapa, para shekullit të njëzetë, do të na jepte një mungesë totale të gjinisë femërore në krijimtarinë artistike

Blerina ROGOVA - GAXHA

Rrëfimtaria më e madhe në historinë e letrave të përbotshme quhet Shehrezade. Ju kujtohen librat e trashë të përrallave të 1001 netëve? Është pikërisht ajo, rrëfimtaria e gjithë këtyre përrallave. Shehrezadeja nuk ka shkruar, ka folur, më mirë thënë ka rrëfyer. Ka rrëfyer aq bukur sa që e ka trullësuar mbretin. Mbreti i zënë në kurthin e fjalëve e të mijëra karaktereve ia lejoji vetes të mos e vrasë, siç bëri me qindra vajza të tjera. Të gjitha ato qenë të virgjëra, së paku kështu thotë rrëfimi. Shehrezaden e shpëtoi goja. Sipas Sokratit, që konsiderohet si mësues i njerëzimit, fjala e folur është fjalë e gjallë e dijes, fjalë që ka shpirt – ndaj edhe është superiore ndaj fjalës së shkruar, e cila s'është asgjë tjetër pos imazh i saj. Për ne, kjo vlen vetëm si ide e antikëve për librin dhe, pa dashur të hyj në teori, e përmenda për rëndësinë që ka fjala, qoftë e shkruar, qoftë e thënë dhe për



Nuk ka njohur femra të mëdha shkrimtare?

fuqinë mistike që i ndihmoi Sherhezades së famshme të shpëtojë e gjallë, e neve lexuesve na mundësoi përrallat më të bukura të dëguara ndonjëherë.

Tregimi

Kam lexuar diku një shkrim interesant për fatin e femrave krijuese, i cili përmbylej me një pyetje të dhimbshme: Përse historia nuk ka njohur femra të mëdha artiste? Sekuencat e shpejta që do të mund t'i hidhnim së kaluarës, ose edhe mendimet e gjata mbi të, nuk do na jepnin kushedi se çfarë përgjigje. Megjithëse, çdo kryevepër e artit botëror ka pasur për muzë femrën dhe janë po ato që i kanë dhënë mitologjive madhështinë, është goxha më i vogël, shumë më i vogël, gati në zero, numri i krijueseve femra në krahasim me atë të meshkujve. Me përjashtim të shekullit të njëzetë, po të kërkojmë në shekujt e tjerë, vështirë se do të mund të gjejmë disa emra krijuesesh. Dhe s'ka se si të jetë ndryshe, mjafton të kujtojmë historinë. Rrethanat socio-kulturore kanë imponuar fatin e tyre. Paragjykimet dhe kufizimet ua kanë shuar spontanisht interesimin për të synuar përtej familjes, burrit, fëmijëve dhe shtëpisë. Shtëpia, si qendër e botës, që e vetmja skenë e mundësisë performuese, përbrenda së cilës edhe ata të paktë spektatorë që

ishin kishin vetëm funksion dekorativ. Ka qenë gati i paimagjinueshëm kalimi prej rolit të gruas në një rol tjetër, e aq më pak në rol artisteje. Shtoja kësaj përvojën e njohjes, kontekstin e formimit dhe predispozitat e mundshme. Përgjigjet sosin menjëherë. Tregimi mbi historinë e tyre jep shenja të njëjta që nuk e ndryshojnë rrjedhën e një historie të përsëritur jo me vite, por me shekuj.

Femra mes meshkujve

Në retrospektivë, si femër e madhe krijuese njihet Safoja (shek.VII p.e.r), poetesha greke dhe e vetmja krijuese e kohëve antike. Safo është femra që bëri gjurmë të tjera dhe që me përvojën e vet poetike i vodhi historisë vendin e burrave. Në traditën e Aleksandrisë, vepra e saj u sistemua në nëntë libra. Në kohët e mëvonshme, veprat e saj shkuan duke e harruar dhe ngatërruar deri aty sa humbi pjesa më e madhe e shkrimeve të saj, për të na lënë neve vetëm disa fragmente të përmbledhura në një libër të vetëm. Poetesha e dashurisë, që i thuri himne perëndeshës Afërditë dhe figurave femra përreth vetes, u bë përfaqësuesja më e denjë e diskurseve poetike klasike dhe më e veçanta në tekstet e këtij lloji. Sot, poezia e saj mbetet e pashmangshme në letrat botërore. Po, duke menduar më tutje, ngec... Në fillim Safo, më vonë kush? Nuk ka përgjigje që të mos jetë arbitrare. Prapë, arsyeja është shumë e thjeshtë: nuk dimë emra të tjerë (kjo gjithnjë vlen deri para shekullit të XX-të).

Pavarësisht nga e vërteta që sugjeron historia dhe e fakteve që duhet t'u besojmë, ekzistojnë autore të panjohura femra mbi autorësinë e të cilave janë vënë emra burrash, herë për t'i ruajtur nga inkuizicioni, e herë që nga askushi të nxjerrin dikushin. Kështu thonë dokumente dhe burime të ndryshme, që



ende sot nuk kanë arritur të hetohen me saktësi. Ne do të donim të kishim emra në shumës, shumë emra në një shumës madhështie, por dëshira mbetet e vetmja, pa pasur një vulë historie.

Me një fjalë, trishtimi që përcjellë ky rrëfim i vërtetë, ndryshe nga ai për Shehezaden që mashtroi mbretin Shehrijar, është çelësi për në botën e ndrydhur të historisë femërore, të çmuara dhe të ndrydhura në të njëjtën kohë, pa u dhënë asnjëherë mundësinë për t'u sprovuar. Situatat demotivuese në psikologjinë e personazheve femra qenë plotësisht të ndërvarura nga konteksti socio-psikologjik. Sido që të interpretohet ky fakt, argumentet për të janë të bollshme. Metaforën për mendjen si njëfarë teatri ku perceptimet shfaqen, zhduken, kthehen dhe ndërthuren në mënyrë të pafundme (J. L. Borhes), mund ta reflektojmë më së miri në kohën tonë, kur femra falë ndryshimeve e zhvillimeve (falë Zotit) ka një hapësirë absolute, të cilën dikur s'do të kishte mundur ta imagjinonte as në mënyrën më paradoksale. ■



Hyrje në tekst



Flamur MALOKU

Libri studimor i Muhamed Çitaku *Mythos dhe Eidos* shtreson, në tërësinë e kërkimit, çështjen e mitit në veprën personale të Ernest Koliqit *Pasqyrat e Narçizit*. Vetë titulli i tekstit hap shenjën e komunikimit, komunikim ky edhe i dyfishtë, siç thotë edhe vetë studiuesi, por jo duke përcaktuar metodë të veçantë studimi. Çitaku këtë e bën me vetëdije të plotë, duke u nisur nga ajo, se teksti letrar është përherë i konotushëm, aq më shumë kur tani Çitaku në vënimin e tij e ka përballë mitin e Narcisit në shtatë novelat e Koliqit.

Variante

Teksti letrar është i konotushëm, duke ndërtuar e rindërtuar ide jeton në kohë, bëhet universal e çdoherë i prekshëm e personal. Andaj, studimi i Muhamed Çitaku *Mythos dhe Eidos* ecën nëpër esencat e kërkimeve të ndërtimeve e rindërtimeve të ideve e të mitit personal që del në shtatë variante në veprën e Koliqit, e cila tani në kritikën e Çitaku bëhet kërkim e analizim i fuqishëm, duke prekur e hetuar shkrimin personal të vetë mitit koliqian. Miti personal i Koliqit bëhet ide e kërkim. Idetë e vënitimit e të kërkimit shkojnë e thellohen, duke gjetur e hulumtuar nëpër literaturë arkimitin. Arkiminti preket e strukturohet, duke i dhënë studiuesit mundësi të mëdha për një kategorizim, e për një identifikim




Variantet personale

Studimi i Muhamed Çitaku 'Mythos dhe Eidos' ecën nëpër esencat e kërkimeve të ndërtimeve e rindërtimeve të ideve e të mitit personal që del në shtatë variante në veprën e Koliqit

të plotë. Shenjat e analizimit sa vijnë e shtresohen, duke u bërë edhe shkrim përjetimi gjatë hetimit të mitit të Narcisit në shtatë novelat e Koliqit. Shtatë novelat e Koliqit bëhen nga analizim i shenjave të brendshme, shenja nëpër të cilat bëhet edhe sintetizim-strukturim, duke ardhur gjithnjë te statusi tematik e ai final i vetë novelave. Rrallëkush i lexon shenjat e brendshme të tekstit letrar, aq më pak ku këto shenja janë derivat i mitit, e që dalin tani në shkrimin personal, siç është rasti te Koliqit. Kërkimi i shenjave të brendshme në shtatë novelat e Koliqit, te studimi i Çitaku, bëhen interpretim e aplikim. Vija personale e shkrimit të Koliqit nuk shmanget përgjatë ecurisë së kërkimit e të teorizimit të këtyre shenjave. Semantika e kërkimit përgjatë shtatë novelave të Koliqit e japin vetë esencat e leximit të shenjave. Studiuesi-Çitaku duke i lexuar shenjat i lexon edhe shtatë variantet e novelave-shtatë kërkime të identitetit koliqian.

Identiteti personal

Pra, variantet lexohen nëpërmjet simbolikës-figurshmërisë së tekstit-novelave. Prandaj, mund të hetohet se edhe është një hetim e analizim, gjithnjë mbi simbolikën e shkrimit të novelave, nëpër të cilat Koliqi kërkon identitetin personal. Kërkimi i identitet personal i Koliqit, tani të Çitaku bëhet sprovë identifikimi në kërkimin e shtatë novelave. Hetimi i identitetit të Koliqit bëhet fenomen, gjithnjë duke pasur parasysh idetë e tekstit. Çitaku e vënon dhe identifikon përgjatë strukturimit të shkrimit, duke gjetur edhe anën tragjike të kërkimit të identitetit të Koliqit: "Tragjikja është e madhe me kërkimet e mëparshme në lashtësi, kjo sipas Koliqit, ka ndodhur për shkak të ndërrimit të pozicioneve të kërkimit, i cili ka dërguar kërkimet e identitetit rrugëve të tjera". Andaj, filozofia e kërkimit bëhet mjeshtërisht, me një model të pëlqyeshëm



hetimi e analizimi. Hyrja në shenjat e novelave, argumentohet dukshëm. Pra, nuk shtrihen hipoteza pa e pasur argumentimin. Shtrirja e ngadalshme në kërkim, bëhet deri te hulumtimi i variacioneve tematike të novelave. Kodi tematik i novelave të Koliqit për Çitaku është gjithmonë i hapur. Kjo hapje kërkon thellim të hulumtimit, duke qëndruar çdoherë larg evidencave-historike. Thellimi e përshkrimi i të gjitha esencave të shkrimit të novelave bëhet shumëfish, nga një pozicion meditimi e reflektimi, siç pohon edhe vetë Çitaku kur hyn në strukturat e brendshme, për të hetuar lëvizshmërinë tematike të novelave. Lëvizshmëri e kodit tematik të Koliqi ndodh në ikjen e së kaluarës, për t'u rikthyer në të tashmen personale, por çdoherë me kujtimin e përvojës së ikjes. Të gjitha këto, analizohen deri në detaje të imëta, përmes një sistemi të mundshëm letrar. Sistemi letrar bëhet komunikim më afër personale me tekstin, pra gjithnjë pranohet e analizohet vlëra. Kjo paraqet edhe një hetim të suksesshëm, sidomos kur kihet parasysh natyra e një studiuesi tanimë të modeluar e të strukturuar. ■

'Kultura' dhe politika



Astrit VELIQU

Tashmë jemi mësuar të zgjohemi thuajse çdo ditë me reklamën dhe sloganet e fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale në Kosovë.

Çdo subjekt politik dhe udhëheqësit e tyre, duke përdorur retorikën e tyre blofe, para syrit dhe veshit të qytetarit lavdëron imazhin e subjektit të vet dhe kritikon rivalin e subjektit tjetër politik.

...Do bëjmë që Kosova të duket ndryshe, ... do ta bëjmë Prishtinën qytet që funksionon, ... qytetet metropolitane..., e shumë mrekulli të tjera elektorale, - të gjitha këto tani më janë bërë pjesë e përditshmërisë sonë, që me pamjet dhe ngjyrat që po marrin në të shumtën e kohës po bëhen të pabesueshme dhe herë të bezdisshme.

Andaj po që se i bëjmë një elaborim të shpejtë secilit subjekt politik, pothuaj të gjithë, një nga një, premtojnë më shumë zhvillim ekonomik, arsim cilësor, administratë moderne, mirëqenie më të mirë sociale etj, por në realitet ajo që është haruar krejtësisht nga këta të fundit është kultura dhe shpirti i saj nacional.

Kultura jashtë listës së prioriteteve

Anashkalimi i sektorit kulturor në Kosovë, nga ata që tanimë janë duke e kërkuar votën e qytetarit para elektoratit të gjerë kosovar, është treguesi më faktik se kultura si pasuri nacionale do të mbetet, edhe për shumë kohë, pjesë e parëndësishme për institucionet e vendit.

Gjatë fushatës zgjedhore për zgjedhjet lokale në Kosovë, ende nuk më ka rënë të dëgjoj ose të shoh nga asnjë subjekt politik, ose i kandiduar për kryetar në nivelin lokal, që së paku kulturën dhe sferën e saj ta këtë futur në listën e parë të prioriteteve në Kosovë.

Pikërisht, ky tregues, fatkeqësisht, është shumë i dhimbshëm ngase kultura si sferë nacionale dhe pasuri e trashëgimisë sonë, meriton një vend dhe imazh më ndryshe në këtë deçenie pas luftës në Kosovë.

Duke e ditur gjendjen e brishtë kulturore në Kosovë dhe veçanërisht sektorët e saj shumë të rëndësishëm si filmi, teatri, muzika, libri, arti, sporti etj, duket se është nevojë imediate e kohës për të ndryshuar, ose, së paku, kjo e fundit duhet futur në listën e prioriteteve institucionale.

A thua pse po ndodh kështu? Pse shpirti dhe bota kulturore nuk manifeston as interesimin më të vogël të subjektet e shumta politike në Kosovë?

Për të arritur së paku te një vlerësim më real, në këtë koncept, duket se është mjaft e vështirë, megjithatë një gjë është më se e sigurt. Tanimë subjektet tona politike, e veçmas liderët e tyre lokalë, si duket ende nuk e dinë se sa e rëndësishme është realisht performanca e shëndoshë kulturore në raport me vendet e tjera simotra, ku imazhi i tyre sendërtohet mbi këto vlera dhe refleksione të shenjta kulturore.

Vlerat kulturore te ne janë të shumta, por, në realitet, e keqja më e madhe në këtë mes qëndron se nuk u ofrohet hapësira dhe vlerësimi i duhur.

Është shumë e rëndësishme që i mazhi kulturor të jetë stabil dhe i shëndoshë, ngase kultura është pasuri. Ajo duhet ruajtur dhe kultivuar brez pas brezi.

Andaj, si pasuri nacionale, ajo duhet të mbështetet fuqishëm nga institucionet legjitime të vendit e veçmas nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit.

Edhe mesazhet dhe premtimet 'boshë' që po dëgjojmë nga politikanët tanë, në

shumë raste duken denigruese karshi të tjerëve dhe në të shumtën e rasteve po e shëmtojnë edhe sharmin e kulturës, sikurse edhe të demokracisë në Kosovë.

Duke u nisur nga ky pikëshikim, pa një ndryshim rrënjësor të politikave kulturore në Kosovë dhe pa i dhënë hapësirë dhe mbështetje të fuqishme sferave kulturore në Kosovë, ky imazh nuk do të ndryshojë as edhe për një çast, andaj nevojitet një intervenim më kategorik karshi këtij fenomeni tashmë të 'shëmtuar' te ne.

Kultura duhet bërë prioritet nacional

Andaj konsideroj se kultura dhe sfera e saj artistike, pa mëdyshje, duhet të bëhen prioritet nacional i Qeverisë se Kosovës, ngase vetëm në këtë formë mund të kemi progres më të madh kulturor në Kosovë.

Mendoj se gabimi më i madh në këtë mes është se politikave dhe projekteve kulturore në Kosovë u janë dhënë shumë pak rëndësi, andaj me këtë hapësirë, interesimi për kulturën dhe sferat e saj është duke rënë gjithnjë e më shumë.

Dhe në këtë rënie e sipër, edhe imazhi ynë kulturor, si vend i pavarur karshi botës demokratike, do të mbetet edhe për shumë kohë i brishtë, ngase siç thotë një fjalë e urtë popullore "çka të mbjellësh, do të korrësh". Farën e mbjellë tashmë e kemi, por jo të shëndoshë, jo të fortë...





Poezi

Keze (Kozeta) ZYLO

Fëshfërimë

Fëshfërima e gjetheve luan serenatë

Si një flutur kraleshkruar fluturoj rreth teje,
Papritur ndaloj mbi gjoksin tënd,
Digjem flakë e tëra nga puthjet e tua,
Në dridhjet e zërit, shikimi tënd më çmend.
Te gugitem si bebe, ne krahet e tua,
E zgjohen ndjesitë, pasqyrat e shpirtit,
Puthjet e ëmbla, si valë të nënujshme,
Japin mërmërrimën dhe kodin e mitit.
Nëpër fijëza dritash zgjedh buzët e tua,
Ku fëshfërima e gjetheve luan një serenatë,
Por si dallgë zemre, prush dashuria,
Seç pikon nektarin, në mallim të zjarrtë!

Mjelmat po të vijne!

Nuk e di,
Në më ke harruar liqeni i bukur i Tiranës,
Nuk e di?
Fëshfërimën e mëndafshit tim, ecur dikur,
Dhe fërshëllimën e te dashurit tim,
Nga kënaqësia e puthjes,
Kur lozdim kukamfshehtësi,
Dhe në gjethet e bardha,
Të lule deleve, kërkonim fatin,
Më do apo s'më do?
Nën ëmbëlsinë e cicërrimes së zogjve,
Ne ecnim te dy të përqaftuar,
Rreth trungut të pishave,
Aty ku lulet bënin pjalmimin.
Unë nuk e kam harruar liqenin tim,
Prapë dua të vij pas kaq vitesh,
Edhe pse mund të jesh zemëruar,
Nga mosardhja ime aty,
Por druhem se mos pishat janë tharë,
Dhe liqenit po i humbet shtrati,
Oh, nuk dua ta besoj kurrë këtë marrëzi,
Pritmë liqeni i bukur, pritme si dikur...
Se mjelmat po të vijnë!

Eja!

Eja i dashuri im eja,
Pyjeve të dendura le të shkojmë,
Larg botës me fjalë çmendurake,
Nën puthjet e zjarra te humbasim,
Dhe me melodi cicërrimash te vallezojme!
Le të vemë buzët mbi sythet që buisin,
Të harbuara me lëng mbi degëza pemësh,
E në marrëzine tonë askush mos të na shoh,
Vetëm fijëzat e diellit, që trupat ngrojnë!
Gjethet e lehta mbi kokat tona te lodrojnë,
Një burie me brirë papritur te dëgjoj,
Nga ëngjëjt e shumtë që nga qielli vijnë,
Per Shen Valentinin si roje te rinë.

Le te pime verën e dashurisë

Puthjen e dua në violinë dashurie,
Me krehjen e flokëve nga gishtat e tu,
Të duroj shumë dhe peshën e lotit,
Që si ngjyrë ylberi piklon këtu.

Si kopsht magjik, në këtë ditë,
Në ballona Valentini, më puth mua,
Me valsën e Dashurisë dehem e tëra,
E në krahet e tu pëshpëris të dua.

Mjalti i shpirtit, vesh qënien tënde,
Duke me ëmbëlsuar gjithcka brenda meje,
Në natën e mëndafshit, butësisht bie,
Mbështjellur e tëra si zog rreth teje.

Une të ndjej ty gjer në imtësi,
Dhe në fotot e bukura në cdo kënd,
Në rezonancë hyjnë drithërimat e shpirtit
E tremem e tëra në vështrimin tënd.

Në dehje pimë verën e dashurisë,
Me ngjyrën e kuqe si zemrat zjarr,
Nën tingujt e ëmbël, pa frymë mbetur,
Dhe borën mund të shkrijmë, në thellim e acar.

Unë luaj e ndjej puhizën e lehtë,
Që butësisht vjen ne lëmim puthjesh,
Në dashurinë e freskët, thellësi e ndjenjave,
Si rit i perjetshëm, në ditë lutjesh.

Me ëndrrat e purpurta rreth shpirtit tim,
U zgjova nga rrezja e porsa ndritur,
Agu i mëngjesit ma flladiste zemrën,
Me arome petalesh ne buze puthitur

Çudia e zbulimeve të reja



Agim AVDIU

Sipas një studimi të BE dhe Bankës Botërore, rreth 30 përqind e planetit është e paarrishme nga njerëzit dhe çdo vit zbulohen 18 mijë specie të reja.

Gjatë një ekspedite të bërë në fillim të këtij viti, në malin Bosavi, një ekip kërkuesish zbuloi një botë të re, të pa eksploruar më parë dhe specie të papara nga syri i njeriut: një mi të madh sa një mace, bretkosa me ngjyra të ndritshme dhe një peshk që hungërinte. Për pesë javë ata qëndruan në lagështi, mes milingonave, merimangave helmuese, shushunjave dhe bombave vullkanike. Në rrjetën e tyre përfunduan specie të papara më parë nga syri i njeriut. Megjithatë, sakrificat që bënë duke jetuar si "kafshë", ia vlejten. Në afërsi të kraterit vullkanik në Papua, Guinea e Re, ekipi i kërkuesve të Universitetit të Oksfordit në Britani dhe kameramanët e BBC-së zbuluan një botë të re, të çuditshme e të mahnitshme. Dukej si një skenë nga "Bota e humbur", romani i Arthur Conan Doyle, ku protagonistët u gjendën në Amerikën e Jugut në një botë parahistorike me kafshë monstruoze. Nga ana tjetër, prej shekujsh zbulimi i botëve të

reja ka ngjallur kuriozitet të jashtëzakonshëm. Precedentët nuk mungojnë, duke nisur që nga arkeologjia. I rëndësishëm ishte zbulimi në xhunglën kamboxhiane të tempujve të Angkorit, pothuajse të braktisur plotësisht që nga shekulli i 16-të. Kur i pa, pas një udhëtimit aventurier në vitin 1860, francezi Henri Mouhot, e krahasoi madhësinë e tyre me tempullin e profetit Sulejman. Gaboi vetëm për datën, kur tha se ishin ndërtuar në kohën e romakëve, por tregoi se ato ekzistonin diku në botë. Për të zbuluar një tjetër thesar të mrekullueshëm arkeologjik, Petrën në Jordani, përveç kurajës, eksploruesi zviceran, Johann Ludwing Burckhardt, duhej të përdorte edhe mashtrimin. Duke studiuar arabisht mori informacion për një qytet antik të fshehur maleve, por i paprekshëm për një perëndimor "tradhtar". Kështu, duke u shtirur si mysliman, i kërkoi një udhërrëfyese që ta shoqëronte në kodrën Gebel Haroun, për të bërë një sakrificë për nder të një profeti. Përgjatë rrugës duhej të kalonin përmes Petrës, kryeqyteti antik i Nabateit (popullsi nomade) i themeluar në shekullin e VI-të para Krishtit dhe i braktisur në shekullin e VIII-të pas Krishtit. Pas një dite udhëtimit, mbërriti në hyrjen e një kanoni, të gjatë një kilometër e gjysmë, para se të shihte përpara vetes ndërtesat e mrekullueshme shkëmbore. Tregimi i udhëtimit të tij në vitin 1812, revolucionoi arkeologjinë.

Ishte thujtë i rastësishëm zbulimi i të famshmit Maçu Piçu në Peru, një qytet i rëndësishëm inkas i shekullit të XV-të pas Krishtit. Në vitin 1911, antropologu amerikan, Hiram Bingham, kishte mësuar nga një indigjen për ekzistencën e një qyteze të vendosur mbi një mal përgjatë luginës së lumit Urubamaba. Nën shoqërinë e tij, gjeti disa familje që shfrytëzonin tarracat për të kultivuar tokën. Një fëmijë, Pablito Alvarez, 11 vjeç, në këmbim të ushqimit, i tregoi rrugën deri te mali ku gjendej Maçu Piçu. Pavarësisht se bimësia kishte mbuluar pjesën më të madhe të qytezës, antropologu mbeti i habitur nga bukuria e atyre gërmadhëve, që sot konsiderohen një ndër shtatë mrekullitë e botës. Por, zbulimet e mëdha arkeologjike nuk përfundojnë këtu: më revolucionari i takon pak viteve më parë, kur në shkretëtirën e vendosur mes rrafshnaltës iraniane, pjesë e Afganistanit dhe Turkmenistanit, kanë përfunduar luftërat shekullore. Historianët mendonin se ishte një zonë që nuk ishte banuar kurrë nga asnjë qytetërim. Por pas disa gërmimeve, bashkë me sende të vlefshme, doli edhe një e vërtetë tronditëse: "Qytetet e rajonit të Sistanit zhvillonin tregti me Indinë dhe Mesopotaminë që 3000 dhe 2000 vjet para Krishtit", - shpjegon Massimo Vidale, arkeolog i Universitetit të Bolonjës, që punon për llogari të Iranit. Pak më në jug të Jirofit, në Iran, u zbulua një piramidë me shkallë gjigante, që zinte një sipërfaqe prej 70 mijë metrash katrorë: ndërtesa më e madhe religjioze e së shkuarës pas piramidave egjiptiane. Përveç "Indiana Jons"-ve të arkeologjisë, të shumtë në numër dhe aktiv janë ata të zoologjisë, në gjurmët e Charles Darwin-it. Në vitin 1835, biologu i famshëm shkoi në Galapagos, një ambient që mbahej i izoluar nga kontinenti amerikan, ku ishin zhvilluar bimë dhe kafshë shumë të veçanta. Duke u mbështetur edhe te këto vëzhgime, formuloi më pas teorinë e evolucionit: d.m.th që përballë ndryshimeve të ambientit mbijetonin speciet që përshatëshin më mirë me të. Pikërisht specie të reja (një lakuriq, një shushunjë dhe një karkalec) u gjetën vitin e shkuar nga një ekspeditë e BBC në një nga vendet



Miu në malin Bosavi

Qyteti Maçu Piçunë Peru



më të virgjëra të planetit: “White Water Cave” në Mageni në “East new Britanin”, një ishull në Papua Guinea e Re. Një pus i thellë 80 metra, në fund plot me ujë, që dilte nga muret, formonte një shtjellë të frikshme shkume dhe rrëkesh që shërbenin si shtëpi për këto gjallesa. Por jo vetëm vende të tilla janë të mbushura me surpriza. Këtë vit, për herë të parë, u arrit të shkohej në malin Mabu në Mozambik. Zona u gjet me “Google earth” nga kërkues vendas në bashkëpunim me “Royal Botanic Gardens” në Britani. E rrethuar nga rrugë të shkatërruara nga lufta civile e viteve ‘80, maja e malit nuk ishte shkelur kurrë nga perëndimorët dhe shumë rrallë edhe nga mozambikasit. Rreth 70 vetë, mes të cilëve udhëheqës lokalë, drejtuan 28 shkencëtarë: emocioni ishte shumë i madh kur grupi arriti majën në një lartësi prej 1700 metrash, pikërisht në kohën kur mijëra flutura meshkuj kishin lënë “takim” atje lart me femrat për t’u çiftëzuar. Eksplorimet e David Livingstone-s lejuan gjetjen e burimeve të lumit Nil dhe Rios së Amazonës. Në vitin 2007, tre eksplo-

ruet nga Zelanda e Re, pasi kaluan rreth 5 shtete afrikane, për 80 ditë përshkruan 6700 kilometrat e Nilit me gomone mes krokodilëve, sulmeve të rebelëve të armatosur dhe vdekjes së një anëtari të ekspeditës në një aksident. Burimet nuk gjendeshin, ashtu siç mendohej, në një zonë rreth liqenit Viktoria mes Kongos dhe Ruandës, por në thellësinë e pyllit ruandez të Nyungwe. Po ashtu burimi i lumit Rio i Amazonës, gjendej në Perunë Jugore dhe Veriore ashtu siç mendohej.



Ujëvarë në malin Nyungwe

Me një gjatësi prej 6800 kilometrash, Rio i Amazonës është konsideruar si lumi më i gjatë në botë. E gjitha kjo është meritë e eksploratorit Jacek Palkiewicz i “Royal Geographical Society” të Londrës që e përshkroi lumin herë me anije dhe herë këmbë. Por, përveç sipërfaqeve tokësore, miniera e vërtetë e surprizave janë fundet e oqeaneve, shumë herë më pak të eksploruar në krahasim me Hënë. Jeta në të vërtetë shpërthen edhe në ambientet më të ashpra: si për shembull nga fundi i liqeneve dhe lumenjve të varrosur poshtë 3-4 mijë metrave akull në Antarktidë. Një shembull konkret është lumi Vostok, i zbuluar në vitin 1996 me radarë, i cili është ende i pa eksploruar për shkak të rrezikut të kontaminimit të një ambienti të izoluar prej një milion vjetësh. Edhe në këto zona ekstreme janë gjetur gjurmë jete: mikroorganizma, që shkencëtarët nuk përjashtojnë mundësinë t’i gjejnë edhe në planetë të tjerë, në dukje jo mikpritës për gjallesat. Për më tepër, pavarësisht shpyllëzimit dhe zgjerimit të qyteteve, Toka është ende e pasur me vende të pazbuluara. ■

“Gripi Sezonal” po troket në dy

Tanimë në vendin tonë thuajse të gjitha qendrat e mjekësisë familjare janë të stërngarkuara me pacientë të sëmurë nga gripi sezonal. Dihet mirë se nuk janë të rralla epidemitë e shkaktuara nga gripi. Kjo ndodh sidomos në sezonin e dimrit, duke paraqitur një problematikë për shëndetin publik të vendit, prandaj Ministria e Shëndetësisë e Republikës së Kosovës për vitin 2009 ka siguruar 20 mijë vaksina kundër gripit sezonal



Artan N. BEJTA

Shumë shpesh kemi vënë re të përdoret fjala grip, e sidomos në sezonin kur kjo sëmundje është më e shpeshtë (vjeshtë-dimër), po çka në të vërtetë është gripi? Gripi është një sëmundje virale e rrugëve të frymëmarrjes, që shkaktohet nga mikroorganizmat e njohur me emrin viruse. Sëmundja fillon me një rrjedhë akute (të vrullshme), përhapet në mënyrë dhe rrugë të lehtë nga një person në tjetrin. Po ashtu, prek të gjithë njerëzit pa dallim moshe e gjinie. Nuk janë të rralla epidemitë e shkaktuara nga gripi. Kjo ndodh sidomos në sezonin e dimrit duke paraqitur një problematikë për shëndetin publik të vendit.

Kush e shkakton gripin?

Shkaktar i gripit është vërtetuar jetë virusi, i cili bënë pjesë në familjen e viruseve të quajtur orthomyxoviridae. Orthomyxoviridae është familje që bënë pjesë në ARN virus që në vete përfshinë virusin e gripit A, virusin e gripit B dhe virusin e gripit C. Virusi A shkakton epidemi dhe pandemi; ai i tipi B shkakton

epidemi të kufizuar dhe raste sporadike, ndërsa virusi C shkakton infeksione të padukshme dhe epidemi të vogla.


Simptomatologjia (shenjat e sëmundjes)

Gripi është një sëmundje që ka një dinamikë të shfaqjes së simptomave. Atë më së shpeshti e shoqëron një temperaturë e lartë (në formë të etheve), kollë (zakonisht e thatë), dhembje koke, dhembje muskujsh dhe artikulacionesh, dobësi dhe rrjedhje të hundëve. Nëse nuk merret terapia simptomatike atëherë gripi mund të ë komplikacione të ndryshme e sidomos te personat e rrezikuar siç janë fëmijët, të moshuarit dhe te pacientët që janë të sëmurë nga ndonjë sëmundje kronike (që vuajnë gjatë nga ndonjë sëmundje p.sh. TBC), si edhe tek ata që kanë imunitet të dobët.

Si ta parandalojmë gripin?

Gjithmonë pastrojini duart

Pasi që shumica e viruseve të gripit shpërndahen me kontakt të drejtpërdrejtë, i sëmuri me grip teshtin në duart e tij dhe më pas prek gjësendet që ka afër dhe i nevojiten (si telefonin, tastaturën, dorezën e derës e kështu me radhë). Mikroorganizmat jetojnë me orë të tëra, shpesh edhe me javë derisa të kalojnë në personin e radhës, i cili prek



objektet e njëjta. Kjo është arsyeja pse duhet t'i pastroni duart shpesh, e nëse nuk ke ku t'i pastrosh duart (sidomos pas teshtimës dhe kollës) atëherë fërkoj me njëra-tjetrën shumë për një minutë ose më shumë në mënyrë që kjo të pamundësojë përhapjen e mikroorganizmave te të tjerët.

Kurrë mos e mbulo me duar gojën dhe hundën gjatë teshtitjes dhe kollës

Pasi që gjatë teshtitjes dhe kollës viruset ngjiten në duar, të mbulosh gojën me duar rezulton në shpërndarjen e viruseve tuaj te të tjerët. Kur të vjen për t'u kollitur ose për të teshtirë përdor një façoletë dhe hidhe menjëherë. Nëse nuk ke façoletë, ktheje kokën në një anë tjetër, ku nuk ka njerëz dhe kollitu ose teshtij në ajër.

Mos e prek fytyrën!

Rrugët më të shpeshta të përhapjes së viruseve të ftohjes e të gripit janë përmes hundës dhe gojës. Fëmijët kryesisht i kap ftohja ose gripi, duke prekur fytyrën e tyre dhe kjo është e njëjta mënyrë që e pasojnë ftohjen ose gripin te prindërit e tyre.

Konsumoni shumë lëngje

Efekti i përdorimit të lëngjeve te gripi është pasi që uji ndikon në pastrim, duke larguar helmimet dhe rehidron organizmin



ert tona! Si të mbrohemi nga ai?

tënd. Një të rrituri mesatar i duhen 8 gota ujë në ditë. Nëse dëshiron ta dish se ke pirë mjaft ujë atëherë, këtë mund ta dish nëse shikon se ngjyra e urinës tënde është afër së kthjellëtës, e nëse ngjyra e urinës është e verdhë kjo tregon se ju nuk pini ujë të mjaftueshëm dhe duhet të pini më shumë ujë.

Thith ajër të freskët

Ajri i freskët është shumë i rëndësishëm e veçanërisht në mot të ftohtë ku nxehja qendrore të thanë dhe të bën më të dobët ndaj viruseve të ftohjes dhe gripit. Po ashtu, gjatë motit të ftohtë, shumica e mikroorganizmave rrinë brenda që d.m.th se ata më shumë qarkullojnë në tubime, në dhoma ku ajri është i thatë. E keqja e së keqes është kur duhanxhinjtë pinë duhan sa munden dhe nuk dalin jashtë e as nuk e hapin derën nga frika se ata ftohen e në fakt brenda është rreziku edhe më i madh, sepse sëmurën nga gripit, e po ashtu edhe ftohen.

Merru gjithmonë me aktivitete sportive

Gjatë aktiviteteve sportive shpejtohet puna e zemrës në këtë mënyrë: ajo pompon sasi të mëdha të gjakut, të bën të marrësh frymë më shpejt për të transferuar oksigjenin nga mushkëritë te gjaku dhe të bën të djersitesh pasi trupi nxehet. Këto ushtrime ndihmojnë në rritjen e forcës vrasëse, të natyrshme ndaj qelizave virusale në trup.



Elimino përdorimin e alkoolit

Përdorimi i alkoolit dobëson sistemin imunitar (mbrojtës) në shumë mënyra. Ata që konsumojnë shumë alkool (pjanecët) janë më të rrezikuarit në infektive dhe komplikime sekondare që vijnë më pas. Alkooli, gjithashtu, lehtëson dehidrimin e trupit. Thënë më thjesht, ai merr më shumë lëngje nga trupi sesa që sjell në të.

Vaksinohu për gripin sezonal

Metoda më efikase për t'u mbrojtur nga gripit sezonal është vaksinimi. Përmes kësaj mund të zvogëlohet rreziku nga gripit dhe të ulët shumë rreziku nga komplikimet e mundshme te grupet e rrezikuara. Vaksinimi kundër gripit u preferohet të gjithë personave të grupit të rrezikuar dhe të gjithë atyre që nuk duan të sëmuren nga gripit. Vaksinimi mund të bëhet që nga moshë gjashtëmuajshe.

Pasi që vaksina çdo vit është e domosdoshme t'u përshtatet viruseve që qarkullojnë rishitazi, atëherë edhe vaksinimi kundër gripit sezonal duhet të përsëritet, po ashtu, çdo vit ndërmjet mesit të tetorit dhe mesit të nëntorit.

Mjekimi

Gripit zakonisht nuk kërkon ndonjë trajtim special. Varësisht nga simptomat dhe nga shkalla e sëmundjes mund të merren medikamente që e ulin temperaturën dhe zbusin dhimbjet (terapi simptomatike).

Veç kësaj, ekzistojnë edhe medikamente speciale kundër viruseve të gripit (medikamente antivirale), të cilat pas konsultimit me mjekun mund të përdoren para së gjithash te pacientët me rrezik të madh, mirëpo ato duhet të merren më së voni deri 48 orë pas fillimit të simptomave.

Përdor më tepër pemë dhe perime


Përdorimi i pemëve dhe perimeve, mundëson që njeriu të marrë shumë vitamina të llojllojshme dhe, në këtë mënyrë, e ngre imunitetin e organizmit dhe krijon kushte të mira për të tejkaluar sëmundjen. Kështu që konsumoni sa më tepër perime të gjelbra dhe frute të ndryshme.

Përdor jogurt (kos)

Disa studime tregojnë se ngrënia e kosit me yndyrë të ulët mund ta zvogëlojë rrezikun tuaj ndaj ftohjeve dhe gripit. Hulumtuesit mendojnë se mikroorganizmat mirëbërës në jogurt stimulojnë prodhimin e substancave të sistemit imunitar dhe, në këtë mënyrë, luftojnë sëmundjet e ndryshme.

Mos pi duhan!

Statistikat tregojnë se duhanpirësit ftohen më shpesh dhe më mundimshëm. Edhe të qenit rreth tymit të duhanit bllokton denjësisht sistemin imunitar. Tymit than kanalet hundore dhe paralizon ciliet. Ciliet janë qimet që mbështjellin membranën e mukozës në hundë dhe rrugët e frymëmarrjes dhe me lëvizjet e tyre valore nxjerrin viruset e gripit dhe ftohjes jashtë nga kanalet hundore. Ekspertët pajtohen se vetëm një cigare në ditë paralizon këto qime (ciliet) për 30 deri 40 minuta, kohë kjo e mjaftueshme për futjen e viruseve të ftohjes dhe gripit.



Takim historik

Më 5 nëntor, krerët e Federatës së Futbollit të Kosovës u takuan me krerët më të lartë të FIFA-s, për të biseduar për futbollin në Kosovës




Alban BILALLI

Në fillim të këtij muaji, në selinë e FIFA-s u zhvillua takimi i paraparë ndërmjet krerëve të FIFA-s dhe krerëve të FFK-së. Kryetari i FIFA-s, Sep Blatter, bashkë me nënkryetarin e FIFA-s, Geofreu Thompson që njëkohësisht është kryetar i Asociacioneve të Federatave, sekretarin e përgjithshëm Jerome Walcke, drejtorin ligjor Marco Vilinger dhe drejtorin për marrëdhënie ndërkombëtare Jerome Champagne, kanë pritur delegacionin e FFK-së të prirë nga kryetari i FFK-së Fadil Vokrri, bashkë me nënkryetarët Agim Ademi e Bekim Haxhiu, sekretarin i përgjithshëm Eroll Salihu dhe zëdhënësin Fazli Berisha. Qëllimi i këtij takimi ka qenë gjetja e një zgjidhjeje për futbollin e Kosovës. Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri u parashtrori katër kërkesa kryesore krerëve të FIFA-s. Kërkesa krye-

sore ka qenë pranimi i FFK-së në FIFA, pastaj kërkesën për mbrojtjen e lojtarëve dhe klubeve, si dhe lejitimin e zhvillimit të ndeshjeve ndërkombëtare për Përfaqësuesen e Kosovës. Po ashtu, Vokrri i informoi krerët e FIFA-s për zanafillën dhe autonominë e FFK-së që nga

ish-Jugosllavia



FIFA

e deri me sot, si dhe për sistemin e garave që aplikon FFK-ja, që janë të njëjta me ato që aplikon UEFA.

Kryetari i FIFA-s, Blatter, duke iu dëshiruar mirëseardhje delegacionit të FFK-së ka thënë se futbollin e Kosovës gëzon një kujdes dhe simpati të veçantë në FIFA, ndaj edhe pritja e sotme është që të gjejmë rrugët për ta ndihmuar futbollin e Kosovës. Blatter ka thënë se për të vërtetuar dhe treguar kujdesin e veçantë për futbollin e Kosovës, sot është mbledhur këtu niveli më i lartë i futbollit botëror, përkatësisht i FIFA-s dhe për të përgatitur materialin për mbledhjen e radhës së KE të FIFA-s që do të mbahet më 1 dhjetor dhe ku do të shtrohet çështja e kërkesave të FFK-së. Presidenti Blatter ka thënë se do të jem avokat i juaji dhe kjo do të thotë shumë për ne, pasi kjo tash e tutje do t'i çojë gjërat përpara", - ka theksuar Fadil Vokrri, pas takimit me krerët e FIFA-s.

Kërkesa e parë që do të shqyrtohet nga FIFA, sipas sekretarit të përgjithshëm Jerome Walcke, do të jetë kërkesa që klubet e huaja t'u paguajnë dëmshpërblim ekuive kosovare në rast se përforcohen me ndonjë futbollist nga Kosova. "Një zgjidhje të shpejtë kërkon çështja e kalimit të futbollistëve, e cila do të jetë në agjendën e FIFA-s, më 1 dhjetor në Mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv të FIFA-s që do të mbahet në Kejpotaun të Afrikës së Jugut, ndërsa për çështjet e tjera do të diskutohet në vazhdimësi dhe besoj që, hap pas hapi, për secilën çështje do të gjejmë zgjidhjen përkatëse". Kërkesat e tjera, veçmas ajo për pranimin e Kosovës me të drejta të plota në FIFA dhe UEFA, priten të shqyrtohet në kongresin e ardhshëm të FIFA-s.

Në këtë takim janë ftuar edhe kryetari i Federatës së Futbollit të Serbisë, Tomislav Karaxhiq dhe sekretari i përgjithshëm Zoran Llaković. Këta të fundit kanë refuzuar ftesën me arsyetimin se FFK-ja është federatë jolegjitime.

Federata e Futbollit të Kosovës është përpjekur edhe më herët që të pranohet në Federatat Ndërkombëtare të Futbollit FIFA dhe UEFA. Shumë shkresa me vulë të FFK-s dhe të kryetarit të saj janë dërguar në adresë të këtyre dy shtëpive të futbollit, që FFK-ja të pranohet në këto institucione. FIFA ka refuzuar aplikacionin e FFK-së me arsyetimin se aplikacioni nuk është në përputhje me artikullin e dhjetë të statutit të FIFA-s. Në këtë artikull thuhet se në FIFA mund të pranohen vetëm federatat e shteteve që janë të pranuar nga komuniteti ndërkombëtar. Për pranim në OKB, Kosovën duhet ta njohin dy të tretat e shteteve anëtare të OKB-s, 124 shtete, kurse OKB-ja ka 190 shtete. Kosovës i duhen dy vite të jetë anëtare e përkohshme e FIFA-s, para se të bëhet anëtare me të drejta të plota dhe për të gjitha këto çështje do të diskutohet në mbledhjen e ardhshme të Komitetit Ekzekutiv të FIFA-s, që do të mbahet në dhjetor në Keyp Toun".

Pasoja e mospranimit

Shtyrja e pranimit ndërkombëtar po lë pasoja në futbollin e Kosovës.



K l u - b e t p o h u m b i n shumë nga mospjesëmarrja në gara ndërkombëtare. Kjo po ndikon që edhe transferimet e lojtarëve të jenë të pakta dhe që klubet të mos përfitojnë nga ato pak transferime. Edhe lojtarët janë duke humbur shumë. Vlera e tyre në treg do të ishte shumë më e madhe në rast se ata do të luanin për Përfaqësuesen e Kosovës.


Ikja e talenteve është një pasojë tjetër. Shumë futbollistë që kanë gjak shqiptari po pranojnë të luajnë për

përfaqësuese të tjera, në pamundësi që të luajnë me Përfaqësuesen e Kosovës. Izolimi i futbollit po i detyron shumë futbollistë të luajnë për përfaqësuese të tjera. Kështu Kosova po humb shumë futbollistë cilësorë që në të ardhmen do të bartnin barrën kryesore. Rregulloret e FIFA-s thonë se një futbollist mund ta ndërrojë përfaqësuesen vetëm deri në moshën 21 vjeçare, nëse paraprakisht ka luajtur për Përfaqësuesen A të një vendi tjetër. Ndërrimi i përfaqësueses mund të bëhet edhe pas moshës 21 vjeçare, nëse futbollisti nuk ka paraqitur në Përfaqësuesen A. Njazi Kuçi dhe Fatos Beqiraj ishin futbollistët e parë që luajtën për një përfaqësuese tjetër, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës. Kuçi luajti për Finlandën kundër Gjermanisë, kurse Beqiraj luajti për Malin e Zi kundër Italisë.

Për Përfaqësuesen A të vendeve tjera kanë luajtur edhe: Arian Beqaj, Lorik Cana, Armend Dallku, Debatic Curri, Besart Berisha, Bekim Kasrati, Samir Ujkani, Blerim Rrustemi e Mehmet Dragusha për Shqipërinë, pastaj Valon Behrami për Zvicrën, Shefki e Njazi Kuçi për Finlandën, Ardian Gashi për Norvegjinë etj. Mirëpo falë rregullit të ri të miratuar nga FIFA, në qershor të këtij viti, Shqipëria dhe Kosova mund të përfitojnë lojtarë të rinj në Kombëtare, të cilët për motive nga më të ndryshmet në të kaluarën janë aktivizuar me përfaqësueset U-21 të vendeve të tjera. Janë të shumtë lojtarët shqiptarë nga Shqipëria dhe Kosova që gjatë viteve të fundit kanë provuar shanset e tyre për të luajtur me kombëtare të tjera. Ndërkohë, përzgjedhësi i Përfaqësueses së Kosovës, Albert Bunjaku, ka grumbulluar 22 futbollistë. "Testimi final do të jetë në grumbullimin e ardhshëm në janar, ku do të kemi një test fizik, në të cilin do të përfshihen edhe futbollistë që nuk kanë qenë pjesë e dy grumbullimeve të para. Pas atij grumbullimi, do të bëjmë seleksionimin e lojtarëve që do të jenë pjesë e Përfaqësueses. Po ashtu, shumë shpejt do të fillojë edhe grumbullimi i talenteve në Diasporë." ■



FJALËKRYQ KLASIK



HORIZONTALISHT:

1. Këngëtari në foto.
11. Plani i përgjithshëm i një loje për të arritur fitoren mbi kundërshtarin.
18. Kryeqyteti i Turqisë.
19. Shkëlqimi që i japim një sendi.
21. Aktori francez, Delon.
22. Shkronja XXIV dhe VIII.
23. Aparat televiziv.
25. Biseda e gjatë dhe patetike.
27. Thur.
28. Zezak, arap.
30. Sëmundje eshtrash te fëmijët.
32. Koha, epoka (vjet.).
34. Iridi.
35. Regjisroti shqiptar, Çashku (shq.).
37. Bëra sportin e ujit.
39. I biri i Posedidonit nga mitologjia greke.
41. Lloj peshku.
43. Emër mashkulli turk (shq.).
45. Moçalet.
47. E poshtë.
49. Element kimik.

51. Komediograf i vjetër romak.
55. Java Script.
57. Figura kishtarë.
59. Legjendë (sh.pashq.).
60. Ajër (ang.).
62. Masë drithërash.
64. Total (shkurt).
65. Sure Kur'ani (Njeriu).
67. Element kimik.
69. Nyje e përparme e mbiemrave në gjuhën shqipe.
70. Yrnek, mostër.
72. Futbollisti francez, Nikolas.
74. Që ka të bëjë me mbretërinë e Teutës.
76. Paraardhës i italianëve.
77. Franca.
78. Grumbujt.
80. Kompozitori klasik, Stravinski (shq.).
82. Jo i shkurtër.
83. Edmond Azemi.
85. Era e keqe.
86. Prefekturë greke (pashq.).
87. Mekanik që ndreq motorë të ndryshëm.

VERTIKALISHT:

1. Këngëtare e njohur shqiptare.
2. Që përbëhet prej gypash të hollë, nëpër të cilët kalon gjaku.
3. Naim Krasniqi.
4. Shkop i biliardos.
5. Kohë pune.
6. Fshat afër Pejës.
7. Shëroj.
8. Rrallësi.
9. Polonia.
10. Kalim i topit jashtë vijës anësore (futb.).
11. Shtresë e ulët resh.
12. Kërçell i bimës së misrit.
13. Radiolokatorët.
14. Tantali.
15. Extinction-Level Event.
16. Njeri që ka fuqi dhe mprehtësi të jashtëzakonshme mendore.
17. Dëshmori i IÇK-së, Cara "Kavaja" (shq.).
20. Sizmologji.
24. Që nuk ka fuqi.
26. Ish-sekretari gjeneral i OKB-së, Kofi.
29. Dëshmori i Kombit, Kodra (shq.).
31. Që s'ka tjetër të tillë.

33. Variant i emrit Eset.
36. Pijaneci.
38. Emër mashkulli shqiptar.
40. Mal në Greqi.
42. I afërm, farefis.
44. Mërita.
46. Kyç.
48. Shkrimtari italian, Umberto (shq.).
50. Që nuk është i trazuar (për detin).
53. Lloj loje gjimnastikore.
56. Shkenca që studion kinezët (pashq.).
58. Futbollisti holandez, Vinter (shq.).
61. Ekstrem.
63. Numër rendor.
66. Vargjet.
68. Që është bërë me ujë.
70. Legjendar.
71. Vegël prej druri si tokmak.
73. Ish-shefi i SHISH-it, Fatos.
75. Përmban.
77. Markë veturash italiane.
79. Teologji.
81. Lloj gjitari i familjes së maceve.
84. Astati.
87. Metri.

Autor:
Agim B.GASHI

REVISTË PËR AKTUALITET, KULTURË, ARSIM, ETIKË

PAQJA



Do të ketë rund të dytë të zgjedhjeve në shumicën e komunave

* * *

Mustafa: E fituam Prishtinën sepse të gjithë besonim në fitore

* * *


Debat rreth këtyre zgjedhjeve

* * *

U prononcuan pas votimit

* * *

Ecuria e fushatës parazgjedhore



Do të ketë rund të dytë të zgjedhjeve në shumicën e komunave

Muhamet JAHIRI

Kryetarja e KQZ-së, Nesrin Lushta, ka prezantuar para gazetarëve disa nga rezultatet preliminare të zgjedhjeve lokale, që u zhvilluan më 15 nëntor. U bë e ditur se në votim morën pjesë mbi 45 për qind e zgjedhësve të regjistruar, ose 709 mijë sish nga 1 milion e 500 votues, që në krahasim me vitin 2007 pati një rritje të numrit të zgjedhësve.

Për komunat e mëdha, KQZ-ja nuk arriti që të sjellë rezultate paraprake.

Rezultatet paraprake, që i publikoi kryetarja e KQZ-së, Nesrine Lushta, tregojnë se:

~ Në komunën e Klinës kryeson kandidati i PDK-së Sokol Bashota, me 6153 vota, i ndjekur nga kandidati i AAK-së, Enver Berisha me 5337 vota dhe ai i LDK-së Fadil Gashi me 3555 vota;

~ Në komunën e Shtimes në krye është kandidati i PDK-së, Naim Ismajli me 5400 vota, i ndjekur nga kandidati i LDK-së Ismail Hasani me 2655 dhe ai i LDD-së Anver Ademi;

~ Në komunën e Obliqit kryeson kandidati i PDK-se Haki Mjekiqi me 2850 vota, i cili ka lënë pas kandidatin e LDK-së Mehmet Krasniqin me 2160 vota dhe atë të AAK-së Enver Gashi me 1965;

~ Në Dragash kryeson Salim Jonuzi i PDK-së, me 4962 vota i ndjekur nga kandidati i LDK-së Halim Shemsedini me 4652 vota dhe Qasip Kushi me 1609 vota;


~ Në Junik kryeson Agron Kuçi i AAK-së me 1.081 vota i ndjekur nga Tahir Isufaj i LDK-se me 622 vota dhe Shpejtim Gacaferri i LDD me 231 vota;

~ Në komunën e Hanit të Elezit, Rufki Suma është në krye me 1.833 vota i ndjekur nga Mehmet Balashi i PDK-së me 1.519 vota dhe Myzaf-er Dernanji i LDK-së me 583 vota;

~ Në Mamushë kryeson Arif Bytyqi i KDTP-së me 1.402 vota, i cili ka lënë pas Berzad Morinën e PDK-së me 333 vota dhe Mehmet Mazrekun e AKR-së me 197 vota;

~ Në Ranillug në krye është Dragimir Mikiq i GIOR-it me 397 vota, i cili ka lënë pas Perica Angjlkoviq të SKMS-së me 167 vota.

Pavarësisht nga kjo, rezultatet qofshin edhe jopreliminare sipas shtabeve zgjedhore të partive politike, mund të shihet se do të shkohet në balotazh në shumicën e komunave.



Prishtinë: Isa Mustafa (LDK-57 %) ka fituar që në rrethin e parë të votimit.

Mitrovicë: Avni Kastrati (PDK 43 %) ka shkuar në balotazh me Nexhmedin Spahiun (AKR-23 %). Në Pejë, Ilmi Berisha (LDD-AKR) në balotazh me Ali Berishën (AAK).

Ferizaj: Bajrush Xhemajli (PDK - 45 %) në balotazh me Naim Feratin (AKR);

Gjilan: Qemajl Mustafa (PDK) balotazh me Fatmir Rexhepin (LDK);

Prizren: Ramadan Muja (PDK) balotazh me Hanefi Muharremin (LDK);

Gjakovë: Pal Lekaj (AAK) balotazh me Mimoza Kusarin (AKR-LDD);

Suharekë: Blerim Kuçi (AAK - 35.59 %) balotazh me Ramë Vatën (PDK-31,80) ose me Sali Asllanin (LDK 31.30 %);

Viti: Sokol Haliti (LDD-AKR) në balotazh me Nexhmedin Arifin (PDK);

Kaçanik: Xhabir Zharku (PDK 48,39) në balotazh me Tahir Çakën (AAK -26,95);

Kamenice: Begzad Sinani (PDK) në balotazh me Shaip Surdullin (LDK);

Sharr: Salim Jenuzi (PDK) në balotazh me Halim Shemsidinin (LDK);

Klinë: Sokol Bashota (PDK) në balotazh me Enver Gashin (AAK);

Skenderaj: Sami Lushtaku (PDK) ka fituar që në rrethin e parë, 90 për qind;

Drenas: Nexhat Demaku (PDK - 93 %), ka fituar që në rrethin e parë;

Podujevë: Agim Veliu (LDK - 51.91 %) ka fituar në rrethin e parë;

Hani i Elezit: Rufki Suma (i pavarur) në balotazh me Mehmet Ballazhin (PDK);

Istog: Fadil Ferati (LDK- 48 %) në balotazh me Naim Imerajn (AAK);

Novobërdë: Bajrush Ymeri (LDK) në balotazh me Radomir Deniqin (SLS);

Mamushë: Arif Bytyq (KDTP) 83 për qind, fiton në rrethin e parë.

Malishevë: Isni Kilaj (PDK - 50.09 %)

Graçanicë: Bojan Stojanoviç (SLS - 57.41 %), ka fituar në rrethin e parë. ■



Kandidati i LDK-së për kryetar të Prishtinës, Isa Mustafa, ka konfirmuar fitoren e tij

Mustafa: E fituam Prishtinën sepse të gjithë besonim në fitore

Muhamet JAHIRI

Pak çaste pasi që Shtabi Zgjedhor i LDK e kishte rishpallur kryetar për një mandat të ri kandidatin e vet Isa Mustafa, një gjë të tillë e ka konfirmuar edhe vetë ai, gjatë një dollie që ka ngritur me ekipin e tij, para shumë të pranishmëve në Sallën e Kuqe të Pallatit të Rinisë.

“Ne fituam sepse të gjithë besonim në fitore. Ne fituam sepse tërë kohën kemi besuar se do të fitojmë. Kjo fitore e imja është përgjegjësi e veçantë që t’ju shërbej qytetarëve të Prishtinës, për ta realizuar atë që u kemi premtuar qytetarëve gjatë këtyre katër javëve”, - ka thënë Mustafa.

Mustafa ka deklaruar se nuk është i gëzuar vetëm me fitoren e tij, por atë e gëzon fakti sepse sipas tij LDK-ja ka shënuar një rikthim.

“Më gëzon fakti se ajo që është përcjellë me fitoren time është fitorja e madhe e LDK-së në mbarë vendin”, - ka theksuar Mustafa, duke shtuar se do të punojë së bashku për qytetarin e Prishtinës dhe të gjithë Kosovës për një jetë më të mirë.



Haziri: Me fitoren në Prishtinë, kemi fituar luftën më të ashpër për 20 vjet

Ndërkaq, nënkryetari i LDK-së, njëkohësisht shef i shtabit zgjedhor Lutfi Haziri, ka thënë se me fitoren e LDK-së në Prishtinë, është fituar lufta më e ashpër në njëzet vitet e fundit.

“Ne sonte fituam luftën me të ashpër që kemi pas këto njëzet vitet e fundit, Prishtinën, edhe për kryetar edhe

për udhëheqje të re të asamblesë”, - ka deklaruar Haziri duke shtuar se LDK ka fituar edhe në disa komuna të tjera, ndërsa do të shkojë në balotazh edhe në qendrat kryesore.

Kemi fituar edhe në disa komuna të tjera, por lufta vazhdon me rivalin tonë PDK-në edhe në shumë komuna të Kosovës. Balotazhi do të zhvillohet në Prizren, Gjilan dhe në shumë komuna të vendit”, - ka bërë të ditur Haziri. ■



Detaje rreth këtyre zgjedhjeve

Për zgjedhjet e sivjetme, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve certifikoi 74 subjekte politike. Brenda kësaj liste u gjendën 37 parti politike, 19 iniciativa qytetare, 16 kandidatë të pavarur dhe 2 koalicione. Nga këto janë 34 subjekte shqiptare, 22 subjekte serbe, 7 subjekte boshnjake, 4 subjekte turke, 2 subjekte ashkali, 2 subjekte malaziasë, 1 subjekt egjiptian, 1 subjekt goran dhe 1 subjekt rom. Në garë për zgjedhjet e sivjetme komunale në 36 komuna ishin 6.787 kandidatë të nacionaliteteve të ndryshme. Prej tyre 205 ishin kandidatë për kryetarë komune dhe 6.582 për deputetë të asambleve komunale. Zgjedhjet lokale që sivjet për herë të parë u organizuan tërësisht nga vendorët u monitoruan nga 21 mijë vëzhgues, ku përfshihen vëzhgues të subjekteve politike, shoqërisë civile, ambasadave dhe Komisionit Evropian, që do të ketë sivjet fjalën kryesore në raportimin rreth ecurisë së zgjedhjeve. Lista e votuesve e certifikuar për zgjedhjet e 15 nëntorit përbënte 1.563.741 votues potencialë. U shtypën rreth 1.7 milionë fletëvotime për asambletë komunale dhe

po aq për kryetarë komunash. U hapën 2.250 vendvotime në tërë Kosovën dhe KQZ bëri edhe listën alternative prej 74 vendvotimesh, kryesisht në vendbanimet me shumicë serbe në rast të ndonjë pengese për hapjen e vendvotimeve të caktuara. Buxheti në dispozicion për këto zgjedhje arriti në 7.7 milionë euro.

Rreth zgjedhjeve

Në vitin 2000, kolona të gjata të shqiptarëve prisnin për të hedhur votën e lirë. Më 28 tetor të atij viti, për herë të parë në historinë e vet, votuesit në Kosovë zgjidhnin përfaqësuesit e tyre, prandaj ata e bënë këtë në mënyrën më dinjitoze. Me një pjesëmarrje rekorde në rajon (79 %), vëzhguesit mbetën të befasuar me rregullsinë e treguar në to. Ish-Shefi i UNMIK'ut, Bernard Kouchner (tash Ministër i Jashtëm i Francës), në ditën e mbajtjes së këtyre zgjedhjeve dukej plot emocion. "Do të kisha dashur që në Kosovë çdo ditë të ketë zgjedhje", kishte deklaruar pas mbylljes së kutive të votimit. Por, votuesit në zgjedhjet e vitit 2002 filluan të lodhen nga zgjedhjet. Në zgjedhjet e dyta lokale, pjesëmarrja në

votime ra në 54 për qind, ndërsa në vitin 2007 kjo përqindje ra në nivel kritik, me vetëm 40 për qind.

Brenda shtatë vjetësh dhe pesë proceseve zgjedhore një herë kishte ndryshime në skenën politike të Kosovës, pasi që deri më 2007, me votat e fituara, LDK-ja mbajti pozitën e parë, por zgjedhjet e atij viti këtij subjekti politik ia zvogëluan shumë votat, kurse subjekti i tashëm më i madh politik në vend, PDK-ja, me ruajtjen e votuesve të vet, arriti të bëhet në një përqindje të thellë partia më e madhe në vend, kurse AAK-ja doli si subjekti i pestë, pasi që me votat e fituara vendin e tretë e mori AKR-ja, kurse të katërtin LDD-ja. Në Republikën e Kosovës që prej pas luftës janë mbajtur pesë palë zgjedhje dhe Agjencia e Pavarur e Lajmeve Kosova-press ka nxjerr me numra dhe përqindje votuesit që kanë pasur partitë gjatë tërë këtyre proceseve. Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) prej 398.872 votuesve në vitin 2000, ka rënë në 129.410 votues në zgjedhjet e vitit 2007. Ndërsa Partia Demokratike e Kosovës (PDK) nuk ka pasur ndonjë ndryshim të madh në





numrin e votuesve, pasi që në vitin 2000 kishte 187.821 votues, kurse në zgjedhjet e vitit 2007 arriti të grumbulloj 196.207 vota. Po ashtu, edhe Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) nga 53.074 votues në vitin 2000 ka arritur të ketë një ngritje të vogël në vitin 2007, duke marrë gjithsej 54.611 vota. Zgjedhjet e para për pushtetin lokal janë mbajtur më 28 tetor të vitit 2000 dhe në këtë proces numri i votuesve ishte 913.179, kurse pjesëmarrja në votime arriti në 79 për qind të atyre që kanë të drejtë vote. Nga këto zgjedhje Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) doli partia më e madhe, ku nga numri i përgjithshëm ky subjekt politik në gjithë Kosovën i mori 398.872 vota, ose 58 për qind. Subjekti i dytë në zgjedhjet e para lokale në nivel të përgjithshëm ka dalë Partia Demokratike e Kosovës (PDK), e cila ka arritur të grumbullojë votat e 187.821 qytetarëve, ose 27.3 për qind. Si parti e tretë është radhitur Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), subjekt politik që u votua nga 53.074 qytetarë, ose 7.7 për qind. Zgjedhjet e dyta në Kosovë ishin ato për Kuvendin e Kosovës dhe u mbajtën më 17 nëntor të vitit 2001. Numri i votuesve në këto zgjedhje ishte 1.249.987, kurse pjesëmarrja

në votime ishte 64 për qind. Edhe nga këto zgjedhje partia më e madhe doli LDK-ja, duke grumbulluar në gjithë territorin gjithsejtë 395.851 vota, kurse PDK-ja u radhit si subjekti i dytë politik, pasi që u votua nga 202.622 qytetarë, ndërsa si parti e tretë është radhitur AAK-ja me 61.688 vota në nivel të Kosovës. Ndërkohë zgjedhjet e treta në Kosovë dhe të dytat për nivelin lokal u mbajtën më 26 tetor të vitit 2002. Numri i votuesve në këto zgjedhje ishte 1.320.481, kurse pjesëmarrja në votime arriti 54 për qind. Nga këto zgjedhje LDK-ja u votua nga 318.916 qytetarë dhe doli partia më e madhe në vend, kurse në vendin e dytë me votat e 207.012 qytetarëve ka dalë PDK-ja, ndërsa AAK-ja është radhitur e treta me gjithsej 61.824 vota. Në procesin zgjedhor të katërt me radhë, të mbajtur më 23 tetor të vitit 2004, janë zgjedhur deputetët për Kuvendin e Kosovës. Numri i votuesve në këto zgjedhje ishte 1.412.680, kurse pjesëmarrja në votime 49.52 për qind. Këto zgjedhje kanë nxjerr si partinë e parë LDK-në me gjithsej 313.437 vota ose 45.42 për qind, ndërsa partia e dytë prapë doli PDK me 199.112 vota ose 28.85 për qind, kurse e treta AAK-ja me 57.931 vota ose 8.39

për qind. Ndërkohë në zgjedhjet e pesta në Kosovë, të mbajtura me 17 nëntor të vitit 2007, kishte 1.454.174 qytetarë me të drejtë vote dhe u mbajtën tri palë zgjedhje, ato për Kuvendin e Kosovës, Kuvendet Komunale dhe kryetarë të komunave. Pjesëmarrja në votime për Kuvendin e Kosovës ishte 54 për qind, për Kuvendet Komunale 39.4 për qind, ndërsa për kryetar të komunave 39.5 për qind, që marrë përgjithësisht kishte një pjesëmarrje prej 39.07 për qind. Këto zgjedhje ndryshuan renditjen e partive, pasi që LDK-ja, prej ndarjes në dysh, pati një rënie të madhe, kurse PDK-ja me ruajtjen e votuesve të saj arriti që të dalë bindshëm fituese e zgjedhje, kurse AAK-ja pati një ngritje të lehtë. Nga këto zgjedhje në nivelin qendror për PDK-në votuan 196.207 qytetarë ose 34.3 për qind, kurse LDK mori vetëm 129.410 vota ose 22.6 për qind. Si subjekti politik i tretë u radhit Aleanca Kosova e Re (AKR) me 70.165 votues ose 12 për qind, ndërsa e katërta u radhit një tjetër subjekt i ri politik i emërtuar si Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), me 57.002 votues ose 10 për qind, ndërsa AAK-ja me 54.611 votues ose 9.6 për qind u radhit si subjekti i pestë politik në Kosovë. ■

Muhamet JAHIRI

Përfaqësuesit më të lartë të institucioneve të Kosovës, presidenti Sejdiu, kryeministri Thaçi dhe kryeparlamentari Krasniqi, por dhe liderët e partive politike si dhe kandidatët për kryetarë të Prishtinës kanë votuar të dielën, si dhe kanë përsëritur qëndrimin e tyre duke bërë thirrje për një pjesëmarrje sa më të madhe në zgjedhje.

Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, i shoqëruar nga zonja e parë, ka votuar të dielën rreth orës 11:00 në qendrën e votimit në gjimnazin "Gjin Gazuli" në Prishtinë. Sejdiu, me këtë rast, ka thënë se kjo është ditë historike për Kosovën dhe popullin e saj pasi që po organizon zgjedhjet e para që nga shpallja e pavarësisë së Kosovës.

"Mund t'ju them se sot është një ditë historike për Kosovën. Janë zgjedhjet e para pas pavarësisë të vendit. Dëshiroj që sikurse që fryma e përgjithshme gjatë fushatës paraelektorale ka qenë e mirë, edhe kjo ditë të përmbillet mirë. Ka qenë një konkurrencë e mirë e kandidatëve, e partive politike dhe ka qenë një dinamikë shumë e gjallë e pjesëmarrjes së qytetarëve në tubimet që ato kanë organizuar", - ka deklaruar Sejdiu duke bërë thirrje për pjesëmarrje sa më të madhe të qytetarëve në zgjedhje.

"Do të dëshiroja që sot Kosova vërtet të jetë në ditë feste, të jetë me një pjesëmarrje masive të të gjithë qytetarëve", - është shprehur i kryetari Sejdiu.

**Krasniqi: Vota është obligim për ata që sakrifikan për pavarësinë**

Kryeparlamentari Jakup Krasniqi, së bashku me bashkëshorten e tij, kanë votuar, rreth orës 9:15, në qendrën e votimit në shkollën fillore në kryeqytet

U prononcuan pa

"Faik Konica". Me këtë rast Krasniqi ka thënë se zgjedhjet e 15 nëntorit janë obligim i çdo qytetari të Kosovës për të gjithë brezat që aspiruan për të pasur një votim të lirë.

"Këto zgjedhje për mua dhe për çdo qytetar të Kosovës janë obligim për të gjithë ata breza që aspiruan për të pasur një votim të lirë. Gjithashtu është obligim për të gjithë ata që ranë që Kosova të jetë shtet i pavarur sovran dhe po ashtu është e drejtë dhe obligim i qytetarit të Kosovës që ta shfrytëzojnë të drejtën e tyre kushtetuese për të votuar për pushtetin lokal", - ka deklaruar Krasniqi, duke vlerësuar se këto zgjedhje janë të rëndësishme për faktin se po mbahen për të parën herë në shtetin e pavarur të Kosovës.

**Thaçi: 15 nëntori, dëshmon se merituar pavarësinë**

Edhe kryeministri i Kosovës Hashim Thaçi, i shoqëruar nga bashkëshortja e tij, ka votuar në orën 9:00 në qendrën e votimit shkollën fillore "Faik Konica", në kryeqytet.

Ai ka vlerësuar se 15 nëntori është datë historike, pasi që për herë të parë mbahen zgjedhje të lira dhe demokratike në shtetin pavarur të Kosovës.

"Kjo është ditë historike, dita e votimit të parë të qytetarëve të Kosovës në shtetin e pavarur, sovran, demokratik dhe multietnik. Të gjithë kemi sakrifikuar shumë për këtë ditë, prandaj është një ngjarje historike dhe besoj fuqishëm se të gjithë do të bëhemi pjesë të kësaj historie të re, të shtet ndërtimit, demokracisë së re, të shoqërisë moderne dhe multietnike", - ka deklaruar Thaçi, duke shtuar se 15 nëntori do të dëshmojë se e kemi merituar pavarësinë.

"Ne sot dëshmuam se vendi dhe qytetarët tanë e kanë merituar pavarësinë, rendin demokratik dhe perspektivën evropiane. Nga sot ne po e fillojmë një etapë të re, etapën e integritimit evropian të shtetit të Kosovës", - ka theksuar Thaçi.

**Pacolli: Qytetarët do të votojnë për herë të parë si të pavarur**

Kryetari i AKR-së, Behgjet Pacolli, ka votuar në orën 10.05 në shkollën fillore "Shkëndija" në Hajvali. Ai ishte i shoqëruar nga vajza dhe njëri nga vëllezërit e tij.

Lideri opozitar Behgjet Pacolli, ka thënë se këto zgjedhje janë shumë më rëndësi, sepse kanë sjellë një freski në rrafshin e lidhjes të ardhshme.

"Sot është një ditë me rëndësi, dita e parë kur qytetarët votojnë në Kosovën e lirë. Këto zgjedhje janë shumë më rëndësi, ngase kanë sjellë freski shumë të madhe, në rrafshin e lidhjes të ardhshme të Kosovës", - ka deklaruar Pacolli.

**Daci: Ditë e rëndësishme për shtetin tonë**

Po ashtu, kryetari i Lidhjes Demokratike të Dardanisë (LDD), Nexhat Daci, pas votimit ka deklaruar se kjo

s votimit

ditë e zgjedhjeve është e rëndësishme për shtetin e Kosovës.

“Është një datë shumë e rëndësishme për shtetësinë tonë. Qytetarët nëpër komuna do të zgjedhin kryetarët dhe njerëzit, të cilëve u besojnë dhe do t'i ftoja të dalin në zgjedhje, sepse porosia më e keqe do të ishte nëse nuk dalin”, - ka thënë Daci.

Ai ka deklaruar se populli i Kosovës do ta paraqesë për herë të parë vetveten dhjetë vjet pas çlirimit.



Haradinaj: Vota e secilit ka vlerë

Ndërsa lideri i Aleançës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj i shoqëruar nga bashkëshortja e tij, nënkryetarët dhe kandidatin për Prishtinë, ka votuar rreth orës 9:30 në qendrën e votimit në shkollën e mesme “Ali Sokoli” në Prishtinë.

Haradinaj, duke ju uruar qytetarëve të Kosovës zgjedhjet lokale, ka thënë se vota e çdo qytetari ka vlerë, pasi që me votën e tyre do të drejtohet e ardhmja e vendit.

“Urime zgjedhjet ju qytetarë të Kosovës. Unë e shfrytëzoj të drejtën time për të votuar, prandaj ju ftoj që edhe ju të gjithë qytetarët e vendit të votoni. Njëkohësisht ju kujtoj se vota e secilit vlen, sepse më këtë votë drejtohet vendi për periudhën që vjen në nivelin komunal. Andaj e ftoj secilin dhe secilën që të dalë e të votojë”, - ka deklaruar lideri opozitar Haradinaj.

Mustafa: Qytetarët kanë çka të votojnë

Edhe kandidati i LDK-së për kryetar të Prishtinës, Isa Mustafa, i shoqëruar nga bashkëshortja e tij, ka hedhur votën e tij rreth orës 09:30, në qendrën e votimit në shkollën fillore “Emin Duraku”.

Mustafa ka thënë me këtë rast se kjo është ditë e veçantë për qytetarët, sepse sipas tij po vendosin për kryeqytetin dhe për demokracinë.



“E konsideroj si shumë të rëndësishme sepse qytetarët po votojnë për vetveten, për fëmijët tanë, për familjet, demokracinë, për Prishtinën dhe për Kosovën, për të mirën e kryeqytetit tonë”, - ka thënë Mustafa, duke shtuar se këto zgjedhje janë shumë të rëndësishme, pasi që po organizohen për herë të parë në Republikën e Kosovës.

Ai ka theksuar se pret rezultate të mira nga këto zgjedhje sepse sipas tij qytetarët e Prishtinës, kanë për çka të votojnë.

Mustafa nuk ka dashur të komentojë se a pret fitore në këto zgjedhje, duke shtuar se për këtë vendosin qytetarët, të cilën në ditën e zgjedhjeve janë sovranë.



Salihu: Ndryshimet janë të nevojshme

Ndërsa kandidati i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), për kryetar të Prishtinës, Astrit Salihu i shoqëruar nga bashkëshortja e tij, ka votuar në orën 11:00 në qendrën e votimit në shkollën fillore “Ismail Qemali, në kryeqytet.

Salihu, duke ju dëshiruar qytetarëve të Prishtinës zgjedhje të lira dhe korrekte, ka thënë se ndryshimet janë të nevojshme.

“Ju dëshiroj të gjithë qytetarëve të Prishtinës zgjedhje fer dhe demokratike.

Unë besoj se Prishtina do t'i votojë ndryshimet, sepse ndryshimet janë të nevojshme dhe unë pres që së bashku me qytetarët e Prishtinës t'i festojmë ndryshimet”, - ka thënë Salihu.



Gashi: Zgjedhjet historike

Edhe Vegim Gashi, kandidat për kryetar të Prishtinës nga koalicioni AKR-LDD, është shprehur i lumtur që për herë të parë votonte në Kosovën e pavarur. Gashi ka thënë se këto zgjedhje janë historike pasi që po mbahen për herë të parë në Republikën e Kosovës.

“Ky është një moment historik ku të marrin pjesë të gjithë në ndërtimin e historisë së Kosovës”, - ka thënë Gashi.



Tahiri: Vota është në të mirën e demokracisë

Kurse kandidati i AAK-së, për kryetar të Prishtinës Besnik Tahiri, i shoqëruar nga bashkëshortja, si dhe nga kryetari Haradinaj ka votuar në orën 10:00, në qendrën e votimit në shkollën fillore “Dardania”.

Ai ka thënë se 15 nëntori është ditë festive për të gjithë qytetarët e Kosovës, ndërsa vota e tyre është në të mirën e demokracisë.

“Sot së bashku me familjen time dhe me kryetarin Haradinaj e përfunduar procesin e votimit. Kjo është një ditë festive, e madhe për të gjithë qytetarët e Kosovës. Ftoj të gjithë qytetarët e Prishtinës që kësaj radhe të mos abstenojnë, por të dalin të votojnë, sepse është për të mirën e demokracisë, për të mirën e vendit dhe për të drejtuar vendin”, - ka deklaruar Tahiri. ■

Partitë politike kanë shpалosur programet e tyre për zgjedhjet lokale të 15 nëntorit

Ecuria e fushatës parazgjedhore

Muhamet JAHIRI

PRISHTINË

Fushata parazgjedhore, për zgjedhjet lokale të 15 nëntorit u përmyll. Partitë politike në forma të ndryshme shpалosën programet e tyre. Në shumicën e rasteve, partive politike në fushatën e tyre iu kishin prirë liderët e partive, përveç presidentit Fatmir Sejdiu, i cili nuk ka mundur të jetë pjesë e fushatës për shkak se e ka të ndaluar një gjë të tillë me kushtetutë.

Beteja kryesore e të gjitha partive politike ishte vendosur për të parin e Prishtinës, kryeqendrës së Kosovës. Kandidatët pretendentë për të parin e kryeqytetit, kryetari i deritanishëm dhe kandidati i LDK-së edhe për një mandat të dytë, Isa Mustafa dhe kandidati i PDK-së, Astrit Salihu, gjatë ditëve të fushatës, përveç orientimit të tyre për ta shpалosur programin e tyre dhe për t'u takuar me elektoratin e tyre, shumë herë edhe e kanë tensionuar situatën, duke shkaktuar lëkundje dhe debate edhe në koalicionin qeverisës. Ndërkaq, kandidatët e tjerë Vegim Gashi nga koalicioni LDD-AKR dhe Besnik Tahiri, nga AAK, gjatë fushatës kanë qenë më të qetë, duke prezantuar programet e tyre për Prishtinën.

PDK: Ne e mbajmë premtimin

Partia Demokratike e Kosovës (PDK) e zhvilloi fushatën duke kritikuar qeverisjen në Prishtinë. Ajo prezantoi objektivat e saj dhe premtoi një qeverisje të mirë për të gjitha komunat.

“Prishtinës i mungon qeverisja e mirë, i mungon vizioni. Prishtinës i duhet një kryetar dhe menaxher i mirë. Kosova ka ecur shumë përpara, por Prishtina jo. Prishtinës i duhet ndryshimi dhe tani ne kemi një kandidat që mund ta ndryshojë. Ai është Astrit Salihu, që do ta ketë përkrahjen tonë të plotë”. – Me këto fjalë e ka filluar fushatën zgjedhore për zgjedhjet lokale të 15 nëntorit, kryetari i PDK-së, njëherësh kryeministër i Kosovës, Hashim Thaçi, duke shtuar se në të gjitha komunat përfaqësojnë vlerat dhe traditat më të mira të shtetit tonë.

“Ata përfaqësojnë të gjitha shtresat e shoqërisë sonë, prindërit, profesorët, mësimdhënësit, mjekët afaristët. Ata sjellin përvojën e nevojshme jetësore që u nevojitet atyre për të qeverisur mirë në nivelin lokal”, - është shprehur ai.

Thaçi ka përmendur të arriturat që janë bërë gjatë dy viteve të shkuara nga qeverisja e tij.

“Ne e mbajmë premtimin. Anembanë vendit tonë mund të shihen përparime. Kemi ndërtuar shkolla, kemi

forcur sistemin arsimor. Ne po ndërtojmë rrugë që do ta lidhin shtetin tonë me pjesë të tjera të Evropës. Ne e shpallëm Kosovën shtet dhe hapëm perspektivë për vendin tonë për integrim në NATO dhe BE”, - ka thënë i pari i PDK-së, duke shtuar se Qeveria e Kosovës, që të jetë më e suksesshme në punën e saj, i duhet të ketë partnerë lokalë, në mënyrë që të avancohen interesat e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

I pari i PDK-së dhe Kryeministri i vendit Hashim Thaçi ka vazhduar fushatën e tij zgjedhore në shumicën e komunave të Kosovës. Ai u ka premtuar banorëve mbështetjen e qeverisë dhe fonde milionëshe, përmes investimeve në komunat e tyre.

Salihu: Me mua Prishtina do të duket ndryshe

Fushatën më aktive të Partisë Demokratike të Kosovës (PDK) e ka zhvilluar kandidati i kësaj partie për kryetar të Prishtinës, Astrit Salihu, i cili ka deklaruar se po e fillon fushatën zgjedhore për kryetar dhe udhëheqje të re të Prishtinës, në mënyrë që ta kthejë në rrugë të mbarë kryeqytetin njëherë e përgjithmonë.

Ai ka thënë se me Prishtinën e lidhin shumëçka.

“Më lidhin kujtimet e fëmijërisë sime, kur rrugët ishin të pastra dhe të qeta. Për mua Prishtina kurrë nuk ka qenë vetëm një vendbanim, për mua Prishtina është shtëpia ime, familja ime, vatra ime. Shtëpia është aty ku rreh zemra dhe zemra i takon Prishtinës”, - është shprehur Salihu, duke shtuar se, si të gjithë qytetarët e tjerë të kryeqytetit, është i zhgënjyer me atë çfarë i ka ndodhur Prishtinës, me mbeturina, me trafikun e bllokuar dhe me mungesën e vendeve të punës.

“Njerëzit tanë duhet të kenë punë dhe të ardhura më të mira. Ne duhet të ofrojmë mundësi për të gjithë qytetarët, sidomos për rininë tonë”, - ka deklaruar Salihu.

Ai u ka premtuar qytetarëve të Prishtinës se tash e tutje nuk do të jenë të harruar.

Salihu e ka akuzuar përsëri kryetarin e deritashëm Isa Mustafën për



gjedhore

mosmbajtjen e premtimeve.

“Ne mund ta përshkruajmë oponentin (Isa Mustafa) me fjalinë e thjeshtë: Ai premtoi..., ai nuk bëri..., dështoi”, - ka thënë Salihu, duke premtuar se Prishtinës, nën qeverisjen e tij, do t’i kthehet dinjiteti.

Në vazhdim Salihu u ka premtuar qytetarëve të Prishtinës një perspektivë brenda Kosovës.

“Ne do të krijojmë vende pune dhe rroga më të mira, duke zbritur taksat dhe duke mundësuar aftësime të nevojshme profesionale, që duhen për shekullin e 21-të. Fëmijët e mi, sikurse fëmijët tuaj duhet ta dinë se do ta kenë një ardhmëri të mirë këtu në qytetin tonë dhe jo në mërgim”, - është shprehur Salihu.

Salihu u ka premtuar qytetarëve të Prishtinës, një qeverisje më të mirë nëse ia japin besimin.

“Do të ndërtoj parkingje, do ta rregulloj problemin e kanalizimit për ato pjesë ku ka vështirësi. Prishtina do të jetë më e pastër dhe do të ndërtoj edhe spitalin e qytetit”, - ka thënë Salihu, duke shfletuar pjesë nga programi i tij. Ai gjithashtu u ka premtuar mësimdhënësve kushte më të mira për t’i ushtruar aktivitetet e tyre, duke iu premtuar të gjithëve nga një “Lloptop”.

LDK: Realizuar ëndrrën e Rugovës, tash ndërtojmë Kosovën

Edhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e nisi fushatën zgjedhore, duke prezantuar të gjithë kandidatët e saj që do të garojnë në të gjitha komunat e Kosovës. Ndërkaq është shprehur se pas realizimit të ëndrrës së ish-presidentit Ibrahim Rugova, për ta bërë Kosovën të pavarur, tash LDK do të punojë për të ardhmen e vendit.

Këto komente, në emër të LDK-së, i ka bërë nënkryetari i kësaj partie Lutfi Haziri, i cili njëherësh është edhe menaxher i fushatës zgjedhore.



“Të gjithë jemi krenarë për realizimin e ëndrrës së pavarësisë së Kosovës dhe realizimin e ëndrrës së presidentit historik Ibrahim Rugova”, - ka deklaruar Haziri, duke shtuar se në këtë ditë të gjithë duhet të përulën dhe t’i falënderojnë të gjithë ata që punuan dhe dhanë jetën e tyre për Kosovën.

Haziri ka deklaruar se LDK-ja ka përgatitur programe, duke u bazuar në kërkesat e qytetarëve dhe se, do të jetë e angazhuar të punojë për përmirësimin e gjendjes sociale të tyre.

“LDK në këtë fushatë elektorale ofron zgjedhje të kërkesave të qytetarëve, ofron zhvillim lokal ekonomik, qeverisje të mirë dhe punësim, përmirësim të infrastrukturës lokale. LDK do ta vazhdojë

përpjekjen në luftën kundër korrupsionit, njëherësh instalimin e qeverisjes së mirë”, - ka thënë Haziri.

Ai i ka bërë thirrje popullit të Kosovës të dalë në zgjedhje më 15 nëntor dhe ta votojë LDK-në, sepse është e vetmja parti që i zgjidh problemet dhe përmirëson jetën e njerëzve.

“Na ndihmoni ta përcjellim këtë vizion. LDK është e vetmja parti që është e përkushtuar për t’i zgjedhur problemet tuaja dhe për të krijuar një Kosovë evropiane. Lirinë e vendit e arritëm”, - është shprehur në fund nënkryetari dhe menaxheri i fushatës së LDK-së, Lutfi Haziri.

Nënkryetari i LDK-së, Lutfi Haziri, gjatë kësaj fushate, ka kritikuar shumë herë partneren e saj në bashkëqeverisje PDK-në dhe liderin e saj Hashim Thaçin.

“Prej se ka filluar fushata zgjedhore, Kosova ka mbetur pa kryeministër të vendit”, - ka deklaruar Haziri, duke shtuar se pavarësisht këtyre deklaratave nuk ka lëkundje të koalicionit në nivelin qendror.

Mustafa: Prishtinën do ta bëjë metropolitane

Ndërkaq, kryetari aktual i Komunës së Prishtinës, njëherësh edhe kandidat për një mandat të dytë, Isa Mustafa, në emër të të gjithë kandidatëve të kësaj partie për kryetarë të





komunave, ka thënë se misionin i tyre është që të punojnë në të gjitha drejtimet për të krijuar një ambient dhe një jetë më të mirë për ta.

“Si kandidatë për komuna ne kemi të qartë punën tonë. Do ta zhvillojmë dhe forcojmë pushtetin lokal e do t'i forcojmë ligjet. Po ashtu, do të krijojmë ambient të përshtatshëm për investime, do ta bëjmë arsimin cilësor në komunat tona”, - është shprehur kandidati i LDK-së për kryetar të Prishtinës, Isa Mustafa, duke shtuar, në këtë kontekst, se LDK-ja është parti e fortë, parti e vlerave dhe do të punojë për perspektivën evropiane të Kosovës.

“Prania juaj këtu tregon se LDK-ja është e fortë, se LDK-ja është vetë demokracia. Ajo është Rugova, është presidenti Sejdiu. Ne gjithë këtu jemi të fortë sepse vizioni ynë sublimon perspektivën më të mirë për të gjithë ne, për ardhmërinë tonë, për perspektivën për Kosovën”, - ka thënë Mustafa.

Ai i ka garantuar qytetarët e Kosovës se me politikat dhe programet e LDK-së standardi i tyre jetësor do të përmirësohet dhe se do të paguajnë më pak taksa dhe do të kenë më shumë të hyra.

“Me politikat e LDK-së do të bëjmë

që qytetarët të paguajnë më pak taksa, të kemi më shumë të hyra dhe buxhet, në mënyrë që të kemi investime dhe ngritje të standardit më të lartë. Këtë ne dimë të bëjmë, ne mund ta bëjmë dhe jemi të aftë ta bëjmë. Ne i kemi përgatitur programet tona dhe fuqimisht qëndrojmë para tyre. Presim fitoren tonë të plotë”, - ka deklaruar Mustafa.

Mustafa gjatë fushatës së tij ka drejtuar shumë herë gishtin në drejtim të qeverisë, duke theksuar se kjo qeveri nuk është jetëgjate.

“Unë dua t'iu them se kjo Qeveri, siç po e shoh unë, nuk e ka jetën e gjatë. Them këtë duke e parë punën që është duke e bërë në terren”, - ka pohuar Mustafa, duke akuzuar Qeverinë edhe për bllokimin e ligjit për kryeqytetin, si dhe për tentimin e saj për ta shitur “Pallatin e Rinisë”.

Mustafa ka siguruar elektoratin e tij se do ta fitojë Prishtinën, pavarësisht reklamave negative, me të cilat e akuzonte rivali i tij nga PDK, Astrit Salihu për dështime.

Mustafa u ka premtuar në programin e tij qytetarëve të Prishtinës kushte më të mira në qeverisjen e ardhshme nëse i fiton zgjedhjet.

“Ju premtoj se brenda dy viteve nuk

do të ketë asnjë rrugë të paasfaltuar në Prishtinë, nuk do të ketë ndërrim të tretë në asnjë shkollë, ndërsa brenda mandatit tim kryeqytetit do t'i siguroj ujë pandërprerë. Unë kam programin që Prishtinën ta bëjë metropolitane”, - është shprehur ai.

LDD-AKR: Ka ardhur koha për ndryshime

Ndërkaq koalicioni Aleanca Kosova e Re (AKR) - Lidhja Demokratike e Dardanisë (LDD), kanë nisur fushatën, duke shpallur programet e tyre në qendër të Prishtinës, para shumë qytetarëve të tubuar, dy liderët, Behgjet Pacolli dhe Nexhat Daci, të cilët prezantuan kandidatët e përbashkët për kryetarë të komunave të Kosovës.

Behgjet Pacolli, në fjalën e tij, ka adresuar menjëherë kritika ndaj udhëheqjes aktuale institucionale.

Ai u ka bërë thirrje qytetarëve që në zgjedhjet e 15 nëntorit të mos mashtrohen.

“Një fjalë e urtë thotë: ‘Më mashtrove një herë, turp të qoftë, po më mashtrove të dytën herë, turpi është i imi, se të besova’. Qytetarë të nderuar, nuk është turp që votuat herën e parë. Herën e dytë

besojuni njerëzve që e meritojnë”, - ka thënë Pacolli.

Gjatë gjithë fushatës Pacolli ka vazhduar me kritika, ndaj qeverisë.

“Njerëzit të cilët i votuat bashkë më mua, janë njerëz, të cilët nuk u interesuan për hallet e juaja, por ata u interesuan më tepër për fëmijët e vet, për para; u interesuan që brenda natës të pasurohen”, - ka theksuar Pacolli.

Më tej, Pacolli ka pasqyruar aktivitetin politik dyvjeçar të AKR-së, duke thënë se gjatë kësaj kohe kjo parti, edhe pse me pak deputetë në Kuvendin e Kosovës, ka arritur ta ngrejë zërin dhe të arrijë suksese me shumë përpjekje.

“Ne kemi ngritur zërin dhe kemi kundërshtuar qeverinë që nga fillimi, e cila punon ‘ad hoc’, pa ndonjë program të dizajnuar.

Kemi ngritur fjalën kundër diplomacisë së MPJ-së, kemi bërë debate dhe mocione në Kuvendin e Kosovës edhe atëherë kur ka qenë në pyetje edukimi i të rinjve tanë. Kemi dalë në pikën kufitare në mënyrë që njëherë e përgjithmonë të ngulet guri në kufijtë tanë. Kemi qenë shumë këmbëngulës që festa e 28 nëntorit të mbetet festë legjitime e gjithë shqiptarëve”, - ka thënë Pacolli, duke shtuar se AKR-ja, po ashtu, ka përkrahur qeverinë në proceset që kanë shkuar në dobi të vendit.

Pacolli nuk ka lënë pa përmendur edhe lobimin që ka bërë në shumë shtete të botës, për ta sensibilizuar opinionin botëror dhe për të përfutur sa më shumë njohje për shtetin e sapokrijuar të Kosovës.

Duke arsyetuar para elektoratit krijimin e koalicionit me LDD-në, Pacolli ka kërkuar nga qytetarët që t’ia japin rastin



ta dëshmojë përkushtimin e tij, për të qeverisur me dinjitet dhe sinjeritet.

“Na jepni lejen e punës dhe unë ju garantoj se me dinjitet do ta kryejmë punën tonë, ashtu siç u ka hije AKR-së e LDD-së. Do të shkojmë në rrugën tonë të sigurt”, - ka premtuar Pacolli.

Ndryshe, koalicioni LDD-AKR ka vazhduar fushatën zgjedhore në shumicën e komunave të Kosovës, ku kanë premtuar ndryshim në qeverisje dhe zhvillim ekonomik.

Daci: Pacolli, njeri i Kosovës, i Ballkanit dhe i botës

Ndërkaq, Nexhat Daci, ka thënë se oferta që prezanton koalicioni LDD - AKR garanton vizion, besim dhe gërshtim të vlerave tradicionale dhe moderne.

Edhe kryetari i LDD-së nuk ka kursyer kritika ndaj qeverisjes së deritanishme në vend. Ai ka sulmuar premtimet që, sipas tij, janë dhënë në fushatën e kaluar, por që nuk janë realizuar deri më tani.

“Kosova është e rraskapitur dhe e molisur nga premtimet për 24 orë rrymë dhe ujë, shërbime të mira shëndetësore, ekonomi të shëndoshë dhe prosperuese, punësim për të rinjtë e shkolluar, zvogëlim ose zhdukje të papunësisë. Është premtuar eliminim i varfërisë së skajshme, e gati çereku i popullatës është në të. Janë premtuar pensione të dinjitetshme, shërbim cilësor dhe efikas civil”, - ka thënë Daci.

Duke vazhduar me kritika dhe identifikim të problemeve që mbizotërojnë në Kosovë, Daci u ka bërë apel të gjithë qytetarëve të vendit, që në zgjedhjet e 15 nëntorit të marrin pjesë sa më masivisht.

“Kosovë, dil në zgjedhjet e 15 nëntorit dhe voto LDD-në e AKR-në. Këtë duhet ta bësh, sepse LDD dhe AKR udhëhiqen nga dy akademi, njëra e shkencës dhe e dijes, tjetra e biznesit”, - ka theksuar Daci, duke shtuar se LDD dhe AKR janë parti të fjalës dhe vizionit, kanë lidhshëm të dëshmuar e profesional.

“LDD dhe AKR kanë lidhshëm të dëshmuar, profesional dhe politik. Është alternativë që mund ta transformojë për të mirë çdo komunë, edhe Kosovën në tërësi”, - ka thënë Daci.

Gashi: Me mua Prishtina do të duket ndryshe

Kandidati i koalicionit LDD-AKR, Vegim Gashi ka thënë se populli i Kosovës, veçanërisht qytetarët e Prishtinës, tash e tutje meritojnë një qeverisje më të mirë.

“Ky popull meriton një qeveri për popullin, me popullin”, - ka thënë Gashi, duke u garantuar qytetarëve sukses më 15 nëntor.



Gashi ka premtuar se nëse i jepet besimi për ta udhëhequr Prishtinën, ai do të punojë për përmirësimin e kushteve të qytetarëve.

“Në programin tim do të ketë premisa të mira, kurse modeli ose thelbi i programit të ri të Prishtinës do të jetë i bazuar në aleancën me qytetarët, në partneritet me ta. Kjo sepse do të jetë shumë vështirë të realizohet çfarëdo programi nëse nuk arrin ta animosh qytetarin dhe ta kesh aleat në proceset që do të zhvillohen në qytet. Ky është një prej komponentëve kryesorë të programit tonë”, - ka thënë Gashi.

Ai u ka premtuar banorëve të Prishtinës: zbutje të varfërisë përmes zhvillimit ekonomik, zhvillim të blektorisë, si edhe ndërtimin e një fabrike uji.

Gashi gjithashtu u ka premtuar përmirësim të kushteve edhe personave me aftësi të kufizuara.

“Ne do të bëjmë përpjekje maksimale që të rritet ndërgjegjësimi qytetar për gjendjen dhe për kërkesat dhe të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Ne do të krijojmë kushte për një jetë normale për këta persona, do të vendosim standarde të ndërtimit, posaçërisht ambiente publike, të cilat do të duhet të kenë infrastrukturë të nevojshme, sinjalizim të duhur, për personat me aftësi të kufizuara” - është shprehur kandidati për kryetar të Prishtinës i koalicionit LDD-AKR, Vegim Gashi.

Gashi ka premtuar se do t'i përmirësojë edhe kushtet e administratës së Prishtinës, duke e reformuar atë.

“Reforma e përgjithshme e administratës komunale do të jetë një prej prioriteteve të mia, gjatë qeverisjes së komunës dhe në kuadër të kësaj reforme do të bëhet ndërtimi ose funksionalizmi i zyrave komunale”, - ka theksuar ai.

AAK: Qeveria Thaçi ka dështuar

Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) e ka nisur fushatën zgjedhore për zgjedhjet lokale të 15 nëntorit, duke drejtuar akuza në adresë të qeverisë Thaçi.

Haradinaj ka ftuar qytetarët që ta votojnë numrin 46, të cilin e mban AAK-ja, nëse dëshirojnë të kenë një shtet të zhvilluar dhe me integrim në strukturat euroatlantike.

“Nuk mund të jemi mirë, kur shteti i Kosovës është keq. Gjithashtu, nuk mund të jetë shteti i Kosovës stabil me gjithë këto ngecje. Nuk mund të jetë

shteti ynë me perspektivë me gjithë këta qytetarë të papunë, të mërzitur dhe të zhgënjyer. Në krye të tij janë politikanët që nuk ia dinë vlerën shtetit, që nuk çmojnë qytetarët, e që me gabimet e mëdha po e bëjnë të ardhmen tonë peng të dështimeve të tyre”, - ka thënë Haradinaj.

Ai i ka bërë thirrje elektoratit që ta votojë AAK-në, “sepse ju garanton jetë më të mirë”. “Ju thërras ta votoni AAK-në, sepse ju garantoj punë, përpjekje të pareshtura që jeta juaj të ndryshojë për të mirë, që Kosova të ecë më mbarë dhe shpejt”, - është shprehur Haradinaj.

Ai ka thënë se do ta mbajë fjalën për të gjitha premtimet.

“Unë e mbaj fjalën. Qytetarë të ndërruar, pak minuta të votimit tuaj, më 15 nëntor, do ta ndryshojnë Kosovën shumë. Fati i Kosovës është në duart tuaja”, - ka theksuar Haradinaj. Në vazhdim, ai ka prezantuar kandidatët e AAK-së për kryetarë të komunave të Kosovës.

Tahiri: Do ta bëjë Prishtinën që të funksionojë

Kandidati i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), për kryetar të Prishtinës, Besnik Tahiri gjatë fushatës zgjedhore është përqendruar kryesisht në shpalosjen e programit të tij për Prishtinën.

“Një nga sektorët e rëndësishëm në programin tim, për qeverisjen katërvjeçare të Prishtinës, është administrata publike. Duke qenë i vetëdi-

jshëm se kjo është pika nga ku kalohet çdo procedurë dhe shërbim, nga ku qytetari fiton përshtypjen për mënyrën e qeverisjes, atëherë unë kam vendosur që gjatë qeverisjes sime administrata komunale të marrë një pamje dhe formë tjetër, nga sa e ka tani”, - ka thënë Tahiri.

Tahiri, gjithashtu, ka premtuar se brenda mandatit të tij do të krijojë në Prishtinë një decentralizim, duke iu mundësuar qytetarëve që të pajisen me dokumente pa u torturuar.

“Unë do të marr vendim që në lagjet dhe fshatrat e mëdha të Prishtinës të hapen zyra komunale, të cilat do të lëshojnë dokumente, të cilat mund të lëshohen, pa e torturuar qytetarin që të vij të presë në ambientet e Komunës për orë të tëra për një dokument”, është shprehur ai.

Ai ka premtuar se me fitoren e tij do të kenë tretman të veçantë invalidët, veteranët dhe familjet e dëshmorëve të UÇK-së.

“Shumë prishtinas nuk kemi pasur fatin të jemi pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Por, me rastin e fitores sime, unë do të kujdesem që veteranët, invalidët e luftës së UÇK-së dhe familjet e dëshmorëve të kenë një tretman të veçantë dhe një përkujdesje institucionale edhe nga pushteti lokal”, - ka premtuar Tahiri.

Tahiri, ka vizituar edhe fshatrat e Komunës së Prishtinës, ku banorëve atje u ka premtuar kushte më të mira për zhvillimin e bujqësisë dhe blektorisë. ■

